



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Plani i Veprimit për Biodiversitet 2016 - 2020

**Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet
2011 - 2020**

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit

Prishtinë

“Njerëzit janë pjesë e diverzitetit të pasur të natyrës dhe kanë fuqi që ta mbrojnë ose shkatërrojnë atë”

Mesazhi kryesor i Sekretariatit të Konventës së Biodiversitetit në vitin 2010 për vendimmarrësit botëror

FALËNDERIME

Strategjia e parë dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin (SPVB) 2011 - 2020 e Republikës së Kosovës ishte rezultat i punës 16 (gjashtëmbëdhjetë) mujore e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e mbështetur nga Komisioni Evropian përmes instrumentit TAIEX-it (Technical Assistance and Information Exchange Instrument of the European Commission).

Dokumenti u përgatitë me një qasje gjithëpërfshirëse, me involvimin e një rrethi të gjerë të "hisenikëve" dhe është bazuar në Raportet e gjendjes së natyrës 2006 - 2007, 2008 - 2009, përgatitur nga Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) si dhe raportet nga sektorët tjerë me ndikim në biodiversitet.

Kuvendi i Kosovës zyrtarisht e ka miratuar SPVB 2011 - 2020 me 7 Tetor 2011.

Zbatimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin duhet të jetë një proces përsëritës dhe ciklik, gjendja dhe tendencat e biodiversitetit, kërcënimet ndaj të natyrës dhe shërbimeve të ekosistemit, vlerat ekonomike dhe sociale, si dhe korniza politike mund të ndryshojnë gjatë viteve. Prandaj, ka nevojë për rishikimin dhe përshtatjen e këtij instrumenti të politikave, që është në pajtim me Nenin 141 paragrafi 5 i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Ligji Nr. 03/L-233.

Nga mesi i marsit deri qershor 2016, një "Vlerësim Afatmesëm për Shqyrtimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin 2016-2020" është kryer, kjo detyrë është udhëhequr nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, përsëri me mbështetjen e TAIEX. Bazuar në një vendim të Sekretarit të Përgjithshëm, të MMPH-së, Nr. 31/2016 lëshuar më 24. 02. 2016, Grupi Punues (GP) për zbatimin e kësaj detyre është themeluar. MMPH ka udhëhequr procesin dhe stafi i Divizionit për Mbrojtjen e Natyrës ka bërë koordinimin dhe komunikimin me anëtarët e GP. Kontributet e të gjithë anëtarëve ishin thelbësore gjatë rishikimit dhe përditësimin e këtij dokumenti strategjik, ne shprehim mirënjohjen tonë dhe sinjerisht i falënderojmë për angazhimin e tyre.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, falënderon edhe Drejtorinë e Përgjithshme për Fqinjësi dhe Negociatat e Zgjerimit (DG NEAR) për mbështetjen e misionëve të ekspertes.

Prishtinë, Qershor 2016

SHKURTESA dhe AKRONIME

VP	Vlerësimi i Pranueshmerisë (sipas Direktivës së Habitave)
AEWA	Marrëveshja për Ruajtjen e Zogjve Migrator Afrikano-Euro-Aziatik
UA	Udhëzim Administrativ
KBD	Konventa për Biodiversitetin
CITES	Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Kërcënuara të Florës dhe faunës së Egër
CMS	Konventa për Ruajtjen e Llojeve Migratore të kafshëve të egra
DMM	Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit
DG NEAR	Drejtoria e Përgjithshme për Fqinjësi dhe Negociatat e Zgjerimit
KE	Komisioni Evropian
ECNC	Qendra Evropiane për Ruajtjen e Natyrës
TKE	Traktati i Komunitetit të Energjisë
PVPE	Plani i Veprimit për Partneritet Evropian
SEK	Strategjia e Energjisë e Kosovës 2009 - 2018
VNM	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
BE	Bashkimi Evropian
FLEGT	Zbatimi i Ligjit të Pyjeve, Qeverisja dhe Tregtia
FSHMN	Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore
FSC	Këshilli i Certifikimit të Pyjeve
BPV	Bruto Produkti Vendor
GIS	Sistemi Informativ Gjeografik
GIZ	Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim (Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit)
OMGJ	Organizmat e Modifikuar Gjenetiksht
GW	Gigawatt
ha	Hektar
HC	Hidro-Central
IHMK	Instituti Hidro Meteorologjik i Kosovës
IBAs	Zonat e Rëndësishme të Zogjve
IPAs	Zonat e Rëndësishme të Bimëve
IPH	Instituti për Planifikim Hapësinor
IUCN	Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës
PKVM	Plani i Kosovës për Veprim në Mjedis
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
AMMK	Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
APK	Agjencia Pyjore e Kosovës
IKMN	Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës
km	Kilometër
M	Masat
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MKRS	Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit
DKA	Drejtoritë Komunale për Arsim
OZhM	Objektivat e Zhvillimit të Mijvjeçarit
MZhE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave

MIE	Ministria e Integrimi Evropiane
MEM	Ministria e Energjisë dhe Minierave
MEST	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MF	Ministria e Financave
MI	Ministria e Infrastrukturës
mm	Milimetër
ShA	Shteti Anëtar
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MM	Memorandum Mirëkuptimi
MW	Megavat
SPVB	Strategjia dhe Plani i Veprimit për Biodiversitet
IKP	Inventari Kombëtar i Pyjeve
OJQ	Organizata Jo Qeveritare
PK	Park Kombëtar
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit
ZKM	Zyra e Kryeministrit
ZPS	Zyra për Planifikim Strategjik
ZM	Zonat e mbrojtura
PMQP	Projekti për Menaxhimin e Qëndrueshëm të Pyjeve
REC	Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore
SCI	Zonat e rëndësishme për Komunitetin
VSM	Vlerësimi Strategjik Mjedisor
SIDA	Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim
'SMART'	Specifike, të Matshme, të Arritshme, Reale dhe të Afatizuara
OS	Objektivat Strategjike
ZVM	Zonë e Veçantë e Mbrojtur
t	Ton
TAIEX	Instrument Teknik për Shkëmbimin e Informacionit dhe Asistencës që menaxhohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Komisionit Evropian për Zgjerim
KB	Kombet e Bashkuara
UNECE	Komisioni Ekonomik i Kombeve të Bashkuara për Evropën
UNEP	Programi i Mjedisit i Kombeve të Bashkuara
UP	Universiteti i Prishtinës
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar
BB	Banka Botërore
WCWC	Qendra Botërore për Monitorimin dhe Ruajtjen
DKU	Direktiva Kornizë e Ujërave 2000/60 / EC
GP	Grupi Punues

PËRMBAJTJA

Pozita Gjeografike e Kosovës.....	Error! Bookmark not defined.
1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	10
2 HYRJE	Error! Bookmark not defined.
2.1 Baza ligjore për nxjerrjen e SPVB	11
2.2 Kërkesatë sipas Konventës së Biodiversitetit dhe Traktateve tjera Ndërkombëtare	Error! Bookmark not defined.
2.2.1 Konventa e Biodiversitetit	11
2.2.2 Konventa për Tregëtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Kërcënuara të Flores dhe faune12	
2.2.3 Konventa për Ruajtjen e llojeve migratore të kafshëve të egra	12
2.2.4 Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore Kulturore dhe Natyrore.....	Error! Bookmark not defined.
2.2.5 Konventa për ligatinat me rëndësi ndërkombëtare, veçanërisht si habitat i Shpendëve13	
2.2.6 Konventa për Ruajtjen e Botës së egër dhe Habiteteve Natyrore Evropiane	13
2.2.7 Konventa e Peizazheve	13
2.2.8 Konventa mbi Qasjen në Informata, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Qasje në Drejtësi për Çështjet Mjedisore	Error! Bookmark not defined.
2.3 Integrimi në Bashkimin Evropian	14
3 PËRGATITJA DHE METODOLOGJIA PËR PERDITËSIMIN E STRATEGJISË	Error! Bookmark not defined.
4 ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË STRATEGJISË	18
4.1 Për të pasur një fokus të qartë.....	18
4.2 Të vazhdohet me informatatë të cilat janë në dispozicion	18
4.3 Të jenë të afatizuara	18
4.4 Të ndalet humbja e mëtejme e biodiversitetit.....	18
4.5 Të kemi qasje të integruar dhe shpërndarje të përgjegjësive	18
4.6 Të ndiqen parimet strategjike	19
5 VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE	19
5.1 Vizioni.....	19
5.2 Objektivat Strategjike.....	Error! Bookmark not defined.
6 RAPORTET E GRUPEVE PUNUESE.....	20
6.1 Llojet, vendbanimet, peizazhet, mineralet, fosilet dhe zonatë e mbrojtura ..	Error! Bookmark not defined.
6.1.1 Biodiversiteti i Kosovës.....	20
6.1.2 Flora dhe vegjetacioni i Kosovës	20

6.1.3	Fauna e Kosovës.....	21
6.1.4	Sistemi i Zonave të Mbrojtura në Kosovë.....	22
6.1.5	Menaxhimi i Zonave të Mbrojtura.....	Error! Bookmark not defined.
6.1.6	Ruajtja ‘Ex - situ’ e Biodiversitetit.....	23
6.1.7	Shpallja e Zonave Potenciale NATURA 2000 në Kosovë.....	23
6.1.8	Iniciativa e Parkut Ndërkufitar të Paqes (Kosova – Shqipëri – Mali i Zi).....	24
6.1.9	Mbrojtja e Peizazheve.....	Error! Bookmark not defined.
6.1.10	Mineralet dhe Fosilet.....	25
6.1.11	Indikatorët e Biodiversitetit.....	25
6.2	Edukimi, komunikimi, informimi dhe pjesëmarrja e publikut.....	26
6.2.1	Edukimi.....	26
6.2.2	Komunikimi, informimi dhe pjesëmarrja e publikut.....	20
6.3	Bujqësia, pylltaria, gjuetia, peshkataria dhe turizmi.....	Error! Bookmark not defined.
6.3.1	Bujqësia.....	Error! Bookmark not defined.
6.3.2	Pyjet dhe sektori pyjor.....	Error! Bookmark not defined.
6.3.3	Gjuetia.....	Error! Bookmark not defined.
6.3.4	Peshkataria.....	Error! Bookmark not defined.
6.3.5	Turizmi.....	Error! Bookmark not defined.
6.4	Ujërat, transporti, minierat dhe energjia.....	42
6.4.1	Ujërat.....	Error! Bookmark not defined.
6.4.2	Transporti.....	Error! Bookmark not defined.
6.4.3	Minierat.....	Error! Bookmark not defined.
6.4.4	Energjia.....	Error! Bookmark not defined.
6.5	Planifikimi Hapësinor dhe Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis.....	Error! Bookmark not defined.
6.5.1	Planifikimi Hapësinor.....	Error! Bookmark not defined.
6.5.2	Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis.....	Error! Bookmark not defined.
6.6	Korniza ligjore dhe Institucionale.....	Error! Bookmark not defined.
6.6.1	Korniza Ligjore.....	Error! Bookmark not defined.
6.6.2	Korniza Institucionale.....	Error! Bookmark not defined.
7	PLANI I VEPRIMIT PËR BIODIVERSITET 2016-2020.	Error! Bookmark not defined.
7.1	Objektivat strategjike dhe masat përkatëse.....	Error! Bookmark not defined.
7.2	Veprimet për zbatimin e Strategjisë së Biodiversitetit të Republikës së Kosovës 2016 – 2020	Error! Bookmark not defined.
8	MONITORIMI DHE RAPORTIMI	70
9	SHTOJCAT	71

Figurat

- Figura 1: Harta Gjeografike e Kosovës
- Figura 2: Harta e Zonave të Rëndësishme të Bimëve
- Figura 3: Mbulueshmëria me Pyje në Kosovë
- Figura 4: Prerja e Trungjeve në Rugovë
- Figura 5: Harta e shtrirjes së pesë regjioneve turistike në Kosovë
- Figura 6: Hidrografia e Kosovës
- Figura 7: Pellgjet lumore kryesore në Kosovë

Tabelat

- Tabela 1: Zonat e Mbrojtura sipas kategorive
- Tabela 2: Prodhimtaria e kulturave kryesore bujqësore
- Tabela 3: Pasqyrë e fermave blegtorale në Kosovë në 2014
- Tabela 4: Gjendja dhe numrat e shtazëve të egra në Kosovë

Pozita Gjeografike e Kosovës

Kosova është një shtet i vogël në qendër të Gadishullit ballkanik dhe shtrihet ndërmjet paraleles 42° e 44° të hemisferës veriore të Tokës dhe mes meridianit 20° e 22°. Kosova kufizohet me Serbinë në veri dhe lindje (351,6 km) Malin e Zi në veri perëndim (78,6 km), Shqipërinë në perëndim (111,8 km) dhe Maqedoninë në jug (158,7 km), gjatësia e gjithmbarshme e vijës kufitare është 700,7 km.

Sipërfaqja e përgjithshme:	10.908 km ²
Popullata:	1,9 milion
Dendësia e popullsisë:	rreth 175 për km ²
Bruto Prodhimi Vendor:	për banor 3.407 €
Numri i vendbanimeve:	rreth 1466
Kryeqytet:	Prishtina rreth 200,000 banor
Valuta:	EURO
Maja më e lartë:	Gjeravica - 2656 mlm.
Lumi më i gjatë:	Drini i Bardhë (122 km)
Tokë e punueshme:	585.000 ha
Tokë pyjore:	464.800 ha



Figura 1: Harta Gjeografike e Kosovës

1 PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit në Biodiversitet është dokument themelor për mbrojtjen e natyrës, e cila përcakton objektivat afatgjata dhe afatmesme për ruajtjen e biodiversitetit. Në këtë strategji kombëtare është pasqyruar se si Kosova ka për qëllim që të përmbushë objektivat e Konventës për Diversitetin Biologjik (KBD), në dritën e rrethanave specifike kombëtare ndërsa plani i veprimit përbënë sekuenca të hapave që duhet të ndërmerren për të përmbushur këto qëllime. Kërkesat për të pasur në konsideratë integrimin e ruajtjes dhe përdorimit të qëndrueshëm të burimeve biologjike në vendimmarrje dhe rrjedhat kryesore në të gjithë sektorët e ekonomisë kombëtare dhe kornizën e politikë bërjes, janë sfida komplekse për Qeverinë e Kosovës.

Qëllimi i kësaj strategjie nuk është për të numëruar të gjitha çështjet e hapura, të cilat kanë të bëjnë me biodiversitetin në Kosovë, por për të krijuar një kuadër të qëllimeve dhe aktiviteteve dhe një koordinim më të mirë. Veprimet e rekomanduara në këtë Strategji nuk paraqesin një "listë dëshirash" në fushën e legjislacionit dhe politikave, planeve dhe programeve të nevojshme, por duhet të jenë realiste dhe në përputhje me qëllimet e KBD dhe objektivat relevante të Aichi për Biodiversitetin si dhe Strategjinë e Biodiversitetit të BE-së 2011 - 2020.

Përgatitjet për hartimin e SPVB të parë kanë filluar në vitin 2009. MMPH ka udhëhequr procesin duke përfshirë palët e interesit nga sektorë të ndryshëm. SPVB 2011 - 2020 u finalizua në vitin 2010 dhe u miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në tetor të vitit 2011. Procesi i rishikimit u zhvillua në pranverën e vitit 2016, përsëri duke përdorur një qasje gjithëpërfshirëse. Vlerësimi i arritjeve të përcaktuara në Planin e Veprimit 2011 - 2015 qiti në pah pengesa të mëdha, konkretisht kapacitete të pamjaftueshme (burimet njerëzore, teknike, financiare), shpërndarjen e paqartë e përgjegjësi, komunikimi i dobët ose të kufizuar në koordinim dhe bashkëpunim. Të gjithë këta faktorë paraqesin rreziqet potenciale për zbatimin e Strategjisë dhe për këtë nevojitet ndihmë ndërkombëtare, por edhe e shoqëruar me një buxhet në rritje të shtetit.

Kapitujt kryesor të dokumentit janë:

- Vizioni dhe Objektivat Strategjike
- Përshkrimi i gjendjes në sektorë e veçantë, problemet kryesore të identifikuar dhe veprimet e propozuara:
 - o Biodiversiteti (llojet, habitatet, peizazhet, mineralet, fosilet dhe zonat e mbrojtura)
 - o Edukimi, komunikimi, informimi dhe pjesëmarrja e publikut
 - o Bujqësia, pylltaria, gjuetia, peshkimi dhe turizmi
 - o Ujërat, transporti, minierat dhe energjia
 - o Planifikimi hapësinor dhe Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis
 - o Korniza ligjore dhe Institucionale
- Plani i Veprimit për zbatimin e Strategjisë
- Monitorimi

2 HYRJE

2.1 Baza ligjore për nxjerrjen e SPVB

Baza ligjore për nxjerrjen e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin 2011 – 2020 në Republikën e Kosovës (në tekstin e mëtejme Strategjia) rrjedh nga neni 140 i Ligjit për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233, dhe i botuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 85 të datës 09. Nëntor. 2010.

Bazuar në Nenin 141 paragrafi 2 të Ligjit për mbrojtjen e natyrës, Strategjia përcakton objektivat afatgjata dhe qëllimet për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore dhe vlerave të mbrojtura natyrore, si dhe metodat për zbatimin e tyre, në përputhje me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, social dhe kulturor të Republikës së Kosovës. Për më tepër, Strategjia hartohet në bazë të Raportit të fundit të Gjendjes së Natyrës dhe duhet të përfshijë temat e mëposhtme:

- ↳ qëllimet e përgjithshme strategjike;
- ↳ synimet për ruajtjen e peizazheve, ekosistemeve, tipave të vendbanimit, llojeve të egra dhe llojeve vendore të zbutura;
- ↳ synimet për vlerat e mbrojtura të natyrës;
- ↳ synimet për hulumtimet dhe përcjelljen e gjendjes të natyrës;
- ↳ synimet për përfshirjen e mbrojtjes së natyrës në sektorët tjerë;
- ↳ synimet për kornizën legjislative dhe institucionale;
- ↳ synimet për edukim dhe arsimim me qëllim të promovimit dhe ruajtjes së larmisë biologjike dhe peizazhore;
- ↳ synimet për informimin e publikut dhe pjesëmarrjen e publikut në vendim marrje për natyrën;
- ↳ planet e veprimit për zbatimin e synimeve, me theksimin e prioriteteve dhe burimet e mundshme financiare;
- ↳ mënyrën e përmbushjes të detyrimeve ndërkombëtare në mbrojtjen e natyrës;
- ↳ shtojcën hartografike e cila në hapësirë tregon masat e mbrojtjes të larmisë biologjike dhe peizazhore dhe mbrojtjen e vlerave të natyrës.

Strategjinë e parë për Biodiversitetin dhe Planin e Veprimit e ka aprovua Kuvendi i Republikës së Kosovës me 07 Tetor 2011.

2.2 Kërkesat e Konventës së Biodiversitetit dhe Traktateve tjera ndërkombëtare

Kosova si shtet i ri nuk është palë nënshkruese e asnjë konvente apo palë në ndonjë marrëveshje në fushën e mbrojtjes së natyrës, e cila do ta detyronte për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej tyre. Ka shpresa se Kosova së shpejti do të bëhet palë nënshkruese e Konventës për Diversitetin Biologjik dhe do të jetë i detyruar të ketë SPVB. Kjo strategji synon të përmbushë detyrimet ndaj konventave të tjera, të tilla si Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara, Konventën mbi Llojet Migratore, Konventën për Trashëgiminë Natyrore dhe Kulturore, Konventën për Ligatinat dhe tjerat.

2.2.1 Konventa për Biodiversitetin

Konventa për Biodiversitetin (KBD) është negociuar që nga viti 1988 dhe ka përfunduar dhe nënshkruar nga udhëheqësit e 150 qeverive në Konferencën e vitit 1992 mbi Mjedisin dhe Zhvillimin

(Rio Samiti i Tokës). Objektivat kryesore janë për të siguruar ruajtjen e biodiversitetit, si dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve biologjike dhe qasje në dhe të përfitojnë ndarjen e burimeve gjenetike. Konceptuar si një mjet praktik për përkthimin e parimeve të Agjendës 21 në realitet, Konventa njih se diversiteti biologjik është më shumë se bimëve, kafshëve dhe mikroorganizmave dhe ekosistemet e tyre - kjo është në lidhje me njerëzit dhe nevojat e tyre. Ajo hyri në fuqi më 29 dhjetor 1993 dhe ka pjesëmarrje aktualisht virtuale universale. Siç u miratua në formën e një "kornizë konventë", KBD në masë të madhe e lë atë të shteteve individuale për të përcaktuar mënyrën më të mirë për të zbatuar dispozitat e saj ligjore.

Gjatë takimit të 10^{te} - KBD, Konferenca e Palëve ka miratuar një Plan Strategjik për Biodiversitetin të rishikuar dhe përditësuar, duke përfshirë edhe të ashtuquajturat **Objektivat Aichi**, për periudhën 2011 - 2020 (konferenca u mbajt në Nagoya, në prefekturën Aichi, në Japoni në Tetor 2010). Strategjia Globale e Biodiversitetit përfshin 5 Objektiva strategjike të ndarë në 20 Caqet Aichi.

2.2.2 Konventa për Tregtinë Ndërkombëtare në Specie të Rrezikuara të Faunës dhe Florës

E ashtuquajtura **Konventa CITES** është një marrëveshje ndërkombëtare ndërmjet qeverive, me qëllim që të sigurojë se gjatë tregtisë ndërkombëtare të ekzemplarëve të kafshëve dhe bimëve të egra mos të kërcënohet mbijetesa e tyre. Konventa u nënshkrua në Uashington, D.C. (Mars 1973), duke siguruar një kornizë e cila do të respektohet nga çdo Palë, të cilat do të miratojnë legjislacionin e vetë të brendshëm për të siguruar që CITES është zbatuar në nivel kombëtar. Sekretariati i CITES administrohet nga UNEP (Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin) dhe është i vendosur në Gjenevë, Zvicër. Aktualisht, 181 vende janë Palë të Konventës dhe instrumenti zbatohet për rreth 30.000 lloje të kafshëve dhe bimëve në mbarë botën.

Në këtë kontekst vlen të përmendet se Konventa CITES është zbatuar në kornizën ligjore të BE-së që nga viti 1984 me një grup të rregulloreve, të ashtuquajturit **Rregulloret e Tregtisë Botës së Egër** të BE-së. Rregullorja e Këshillit (EC) Nr. 338/97 e datës 9 Dhjetor 1996 mbi mbrojtjen e llojeve të faunës dhe florës së egër, duke rregulluar tregtinë e tyre; dhe një numër i rregulloreve të Komisionit mbi ndryshimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 338/97, veçanërisht në lidhje me ndryshimet në llojet e mbuluara nga legjislacioni. Amandamenti fundit ka nxjerrë Rregulloren e Komisionit (BE) Nr. 75/2013 të 29 Korrikut 2013 e cila plotëson Rregulloren e Këshillit (EC) Nr. 338/97 për mbrojtjen e llojeve të faunës dhe florës së egër duke rregulluar tregtinë e tyre.

2.2.3 Konventa për Ruajtjen e Llojeve Migratore të Kafshëve të Egra

Konventa e RLIM ose e Bonit është një traktat global me qëllim të ruajtjes së llojeve aviane migratore tokësore, detare në të gjithë gamën e tyre. RLIM është një organizatë globale e KB - e themeluar si organizatë ndërqeveritare dhe ndërkufitare dhe llojet e rrezikuara migratore janë në fokus të veçantë të Konventës. KRLIM mbulon një larmi të madhe të llojeve migratore, të listuara në anekset e Konventës.

2.2.3.1 *Marrëveshja për Ruajtjen e zogjve Migrator të ujit afrikano-euro aziatik*

Marrëveshja AEWA - është zhvilluar në kuadër të Konventës mbi Llojet Migratore dhe paraqet një traktat ndërqeveritar i dedikuar për ruajtjen e shpendëve migratorë të ujit dhe habitateve të tyre në Afrikë, Evropë, Lindjen e Mesme, Azinë Qendrore, Grenlandë dhe Arqipelagun Kanadez. Marrëveshja AEWA administrohet nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe bashkon vendet dhe komunitetin e gjerë ndërkombëtar të ruajtjes me qëllim të sigurimit të një ruajtje të koordinuar dhe menaxhimit të shpendëve migratorë të ujit gjatë gjithë rrugës së tyre migratore.

2.2.4 **Konventa për Mbrojtjen e Trashëgimisë Botërore Kulturore dhe Natyrore**

Qëllimi i **Konventës së Trashëgimisë Botërore** është përcaktuar për të mbrojtur zonat kulturore dhe natyrore nga shkatërrimi, cenimi dhe shfrytëzimi. Konventa kërkon që të "*krijohet një sistem efektiv i mbrojtjes kolektive të trashëgimisë kulturore dhe natyrore me vlerë të jashtëzakonshme universale, i organizuar në mënyrë të përhershme dhe në përputhje me metodat moderne shkencore*". Konventa nuk mbron lloje të veçanta bimore ose shtazore, por Palët e Konventës duhet ruajtur zonat e listuara brenda territorit të tyre, të ndërmerren masat për mbrojtjen e trashëgimisë së tyre kombëtare dhe janë të inkurajuar për të integruar ato zona në programet e planifikimit rajonal.

2.2.5 **Konventa për Ligatinat e Rëndësisë Ndërkombëtare, veçanrishtë si vendbanime të shpendëve**

Konventa Ramsar - është nënshkruar në Ramsar, Iran, në vitin 1971 para se të hyjnë në fuqi në 1975 - është një traktat ndërkombëtar i përgatitur për të adresuar shqetësimet globale në lidhje me humbjen dhe degradimin e Ligatinave. Ajo siguron kornizën për veprim kombëtar dhe bashkëpunim ndërkombëtar për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshem të ligatinave dhe burimeve të tyre.

2.2.6 **Konventa për Ruajtjen e Botes së Egër Evropiane dhe Vendbanimeve Natyrore**

Si një traktat i nënshkruar në Bernë (**Konventa e Bernës**) dhe i hapur për nënshkrime nga 19 Shtator 1979, Konventa synon të sigurojë ruajtjen e florës dhe faunës dhe vendbanimeve të tyre, duke mbuluar pjesën më të madhe të trashëgimisë natyrore të kontinentit evropian dhe që shtrihet në disa shtete të Afrikë. Vëmendje e veçantë i është dhënë llojeve të rrezikuara dhe në nevojë, përfshirë llojet e rrezikuara dhe të kërcënuara migratore të specifikuar në shtojcat.

Një nga mjetet kryesore për Palët Kontraktuese gjatë përmbushjes së detyrimeve të tyre sipas Konventës së Bernës është themelimi i Rrjetit Emerald në nivel kombëtar - një rrjeti ekologjik përbërë nga Zonat me Interes të Veçantë të Ruajtjes. Rrjeti Emerald është përdorur shpesh nga Komisioni Evropian si hapi i parë në rrugën për identifikimin e zonave NATURA 2000 (në fakt, qëllimi i tij është që t'i familjarizojë vendet kandidate me format përkatëse dhe të lejojë ata që të mbledhin të dhënat bazë për llojet e synuara të vendbanimeve dhe llojeve).

2.2.7 **Konventa e Peizazheve**

Konventa e Firences promovon mbrojtjen, menaxhimin dhe planifikimin e peizazheve Evropiane dhe organizon bashkëpunimin Evropian për çështjet e peizazhit. Konventa u miratua më 20 Tetor të

vitit 2000 në Firenze (Itali) dhe hyri në fuqi më 1 Mars 2004 (Këshilli i Evropës Numri serik i Traktatit 176). Traktati është i hapur për nënshkrim nga shtetet anëtare të Këshillit të Evropës dhe për aderim nga ana e Komunitetit Evropian dhe shteteve jo-anëtare evropiane. Ky është traktati i parë ndërkombëtar që ekskluzivisht merret me të gjitha dimensionet e peizazhit Evropian.

2.2.8 Konventa mbi Qasjen në Informata, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Qasje në Drejtësi për Çështjet Mjedisore

Konventa e Aarhus-it- nën mbështetjen e Komisionit Ekonomik të Kombeve të Bashkuara për Evropën (UNECE) - u miratua më 25 Qershor 1998 në qytetin danez Aarhus (Århus) dhe ka hyrë në fuqi më 30 Tetor 2001. Konventa përcakton një sërë të drejtash për publikun (individët dhe shoqatat e tyre) në lidhje me mjedisin. Palët e Konventës janë të detyruara që të krijojnë dispozitat e nevojshme në mënyrë që autoritetet publike (në nivel kombëtar, rajonal ose lokal) të kontribuojnë që këto të drejta të hyjë në fuqi. Konventa siguron:

- të drejtën e secilit për të marrë informacionin mjedisor që mbahet nga autoritetet publike ('**qasje në informacionin mjedisor**'). Kjo mund të përfshijë informacion mbi gjendjen e mjedisit, por edhe për politikën ose masat e ndërmarra, ose për gjendjen e shëndetit dhe sigurisë së njeriut kur kjo mund të ndikohet nga gjendja e mjedisit. Aplikantët kanë të drejtë të marrin këtë informacion brenda një muaji nga dita e kërkesës pa pasur nevojë për të deklaruar pse e kërkojnë atë.
- të drejtën për të marrë pjesë në vendimmarrjen mjedisore. Marrëveshjet që bëhen nga autoritetet publike duhet mundësuar publikun e ndikuar dhe organizatat mjedisore joqeveritare për të komentuar mbi, për shembull, propozimet për projekte që ndikojnë në mjedis, apo planet dhe programet që kanë të bëjnë me mjedisin, këto komente do të merren në konsideratë të duhur gjatë vendimmarrjes, dhe informacioni do të ofrohet për vendimet përfundimtare dhe arsyet për to ('**pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore**');)
- të drejtën për të shqyrtuar procedurat për të kundërshtuar vendimet publike që janë bërë pa respektuar të dy të drejtat e lartpërmendura apo ligjin e mjedisit në përgjithësi ('**qasjen në drejtësi**').

2.3 Integrimi në Bashkimin Evropian

Synimi afatmesëm i Kosovës është integrimi në Bashkimin Evropian andaj nevoja e krijimit të një kornize ligjore dhe institucionale adekuate do të jetë përparësi. Bazuar në *Programin Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit* (PKZMSA, Mars.2016) një spektër i gjerë i legjislacionit për mbrojtjen e natyrës tanimë është transpozuar gjatë viteve të kaluara, në mes tjerash, Direktiva e Habitaveve (1992) dhe Direktivën e Zogjive (1979), Direktiva e Kopshteve zoologjike, Rregullorja CITES, Rregullorja për kurthet gjymtyrë mbajtëse, Rregullorja FLEGT për skemat e licencimit për tregti të trungjeve, etj. Dispozitat tjera të mbetura do të transpozohen gradualisht, në vijë me progresin e Kosovës drejtë anëtarësimit në BE.

Direktivat më të rëndësishme për biodiversitetin dhe mbrojtjen e natyrës të cilat do të zbatohen gjatë viteve në vijim janë:

- Direktiva e Këshillit 92/43/EEC e 21 Maj 1992 për ruajtjen e vendbanimeve natyrore të florës dhe faunës së egër (**Direktiva e Habitaveve**)
- Direktiva 79/409/EEC (e amenduar me Direktivën 2009/147/EC) të Parlamentit Evropian për ruajtjen e zogjve të egër (**Direktiva e Zogjve**)

Të dy Direktivat e Habitaveve dhe e Zogjve paraqesin dy pjesët kyçe ligjore për mbrojtjen e natyrës dhe ruajtjen e biodiversitetit në Evropë. Direktiva për Habitatet kërkon Shteteve Anëtare (SHA) të hartojnë një listë të zonave me rëndësi të Komunitetit (SCIs) në territorin e vetë nga data e pranimit, të cilat në mënyrë të konsiderueshme kontribuojnë në ruajtjen tipave të habitaveve të Evropës. Sipas Direktivës së Zogjve, SHA janë të obliguara që të përcaktojnë zona të përshtatshme të Mbrojtjes së Veçantë (ZMV) për ruajtjen e zogjve të egër. Caktimi i ZMV duhet të bazohet në kritere objektive, shkencore dhe të verifikuara. Zonat të caktuara në bazë të dy Direktivave do të formojnë Rrjetin kombëtar të Natura 2000 - duke kontribuar në instrumentin më të rëndësishëm të Evropës për mbrojtjen e biodiversitetit.

Sipas PKZMSA, Direktiva e Zogjve është pothuajse tërësisht e transpozuar (97%) me anë të Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, Ligjit për gjuetinë, si dhe Udhëzimit Administrativ (UA) mbi shpalljen nën mbrojtjen e llojeve të egra si dhe Vendimit për shpalljen nën mbrojtje të Ligatinës së Hencit/Radevës si Zonë e Veçantë e mbrojtur për zogjtë. Për më tepër, PKZMSA konstaton se Direktiva e Habitaveve është transpozuar plotësisht (100%), me Ligjin për mbrojtjen e natyrës dhe Udhëzimin Administrativ për llojet e vendbanimeve natyrore, hartat e vendbanimeve natyrore, tipat e vendbanimeve natyrore të rralla dhe të kërcënuara si dhe masat për mbrojtjen dhe ruajtjen e tipave të vendbanimeve natyrore.

Harmonizimi dhe zbatimi i traktateve ndërkombëtare dhe legjislacionit Evropian do të jetë një nga objektivat strategjike, të planifikuara gjithashtu në kuadër të kësaj Strategjie. Me qëllim të zbatimit të legjislacionit të zbatueshëm për mbrojtjen e natyrës, disa dokumente të tjera kombëtare strategjike janë të rëndësishme, ndër më të rëndësishmet:

- Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA), Mars 2016;
- Politikat dhe Strategjia për Zhvillimin e Sektorit pylltarisë 2010 - 2020;
- Strategjia Kornizë për Ndryshimet Klimatike (2014 - 2024);
- Strategjia e Kosovës për Mjedisin (draft);
- Strategjia Kombëtare për Zhvillim (SKZH) (2016 - 2021)

3. PËRGATITJA DHE METODOLOGJIA E RISHIQIMIT TË STRATEGJISË

Strategjia e parë dhe Plani i Veprimit për Biodiversitetin (SPVB) 2011 - 2020 u përgatitë me një qasje transparente dhe gjithëpërfshirëse në vitin 2010 dhe u miratua nga Kuvendi i Kosovës në 2011. Bazuar në gjendjen e biodiversitetit kërcënimet ndaj të mirave të natyrës dhe shërbimeve të ekosistemit, vlerat ekonomike dhe sociale, si dhe korniza politike mund të ndryshojnë gjatë viteve. Prandaj, ka nevojë për rishikimin dhe përshtatjen e këtij instrumenti të politikave, që është në pajtim me Nenin 141 paragrafi 5 i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës Ligji Nr. 03/L-233. ("Analiza e objektivave dhe udhëzimet e përcaktuara nga Strategjia do të rishikohen çdo pesë (5) analizën e zbatimit të planit të veprimit, si dhe rishikimi i Strategjisë do të kryhet ashtu siç kërkohet").

Autoriteti kompetent - Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor- ka kërkuar mbështetje nga Komisioni Evropian përmes instrumentit TAIEX ka aprovuar një **"Vlerësim Afatmesëm për rishikimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin 2016-2020"** i cili u realizua në mes të Marsit dhe Qershorit. 2016.

Bazuar në Vendimin e Sekretarit të Përgjithshëm MMPH Nr. 31/2016 nxjerrë më 24.02.2016, një Grup Punues u themelua; Vendimi me emrat e anëtarëve të GP, është bashkangjitur në (Shtojcën III). Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës bëri koordinimin dhe komunikimin me GP. Anëtarët e GP janë ndarë në 6 nëngrupe, sipas sektorëve të ndryshëm dhe çështjeve të ndërlidhura:

- GP 1 - llojet, habitatet, peizazhet, mineralet, fosilet dhe zonat e mbrojtura
- GP 2 - edukimi, komunikimi, informimi dhe pjesëmarrja e publikut
- GP 3 - bujqësia, pylltaria, gjuetia, peshkimi dhe turizmi
- GP 4 - ujërat, transporti, minierat dhe energjia
- GP 5 - planifikimi hapësinor dhe Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM)
- GP 6 - korniza ligjore dhe institucionale

Involvimi i ekspertëve nga sektorët dhe profesionet e ndryshme, garantojnë qasje të integruar për mbrojtjen e natyrës dhe futjen e qëllimeve të mbrojtjes së biodiversitetit tek sektorët tjerë.

Për vlerësimin ekspertja e TAIEX-it ka përgatitur dy pyetësorë gjatë misionit të saj të parë (7 - 11, Mars 2016). Pjesa I për të vlerësuar arritjet e objektivave dhe masave dhe Pjesa e II për të vlerësuar sfidat kryesore dhe pengesat. Pyetësorët janë përkthyer dhe dërguar tek anëtarët e të gjitha nën GP. "Raporti i vlerësimit të arritjeve të objektivave të përcaktuara në Strategjinë e Biodiversitetit dhe veprimeve të përcaktuara në Planin e Veprimit 2011 - 2015" tregon disa zhvillime pozitive, por zbulon pengesa të mëdha të cilat kanë pamundësuar zbatimin e veprimeve të propozuara.

Përveç vlerësimit, anëtarët e GP-ve ranë dakord për të siguruar pjesë të rishikuara të tekstit të sektorëve të tyre përkatës. Dokumentet janë mbledhur dhe shqyrtuar nga stafi i Divizionit të Mbrojtjes së Natyrës dhe pjesë të rishikuara të tekstit janë përfshirë në dokument.

Gjatë misionit të dytë (18 - 22, Prill 2016) Objektivat ekzistuese Strategjike (OS) janë rishqyrtuar - por duke mos ndryshuar përmbajtjen, por me qëllim të bërjes 'SMART' (specifike, të matshme, të arritshme, realiste dhe të afatizuara) dhe janë mbajtur diskutime lidhur me treguesit e monitorimit. Shumica e kohës ju ka përkushtuar zhvillimit të Planit të Veprimit 2016 - 2020. Anëtarët e GP kanë diskutuar dhe kanë rënë dakord që veprimet, pjesërisht të vazhdojnë me rishikimin e veprimeve ekzistuese, pjesërisht duke përfshirë veprime ose iniciativa të reja. Të gjitha veprimet e propozuara

kanë një lidhje të qartë me strategjinë globale të biodiversitetit nën KBD me objektivat e sajë Aichi, Strategjinë e Biodiversitetit të BE-së dhe të dokumenteve të politikave kombëtare. Anëtarët e GP-ve kanë propozuar gjithashtu projekte, të cilat mbështesin ë institucionet për të arritur veprimet e propozuara.

Në misionin e fundit (13 - 17 Qershor 2016) ekspertja e TAIEX-it ka bërë së bashku të gjitha pjesët e përditësuara të tekstit dhe ka diskutuar dhe rënë dakord me përfituesit për Objektivat përditësuara Strategjike dhe masat përkatëse, duke përfshirë treguesit. Drafti i përditësuar dhe i rishikuar i SPVB ju prezantuan anëtarëve të grupeve të punës dhe komentet përfundimtare si dhe in putet janë mbledhur. Kurdo që ishte e nevojshme, diskutimet janë zhvilluar me stafin e MMPH-së për të sqaruar pjesët tekstit dhe jemi rënë dakord për shtojcat. Të gjitha komentet e fundit u përfshinë dhe ekspertja ka përgatitur versionin përfundimtar të SPVB në gjuhën angleze. Dokumenti duhet të përkthehen nga shërbimet profesionale për të siguruar që versioni në gjuhën shqipe, anglisht dhe serbisht të jetë në përputhje.

4. ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË STRATEGJISË

4.1 Të ketë një fokus të qartë

Duke analizuar informacionin ekzistues nga burime të ndryshme të publikuara gjatë procesit përgatitor të Strategjisë në vitin 2010, u bë e qartë se Kosova do të përballë me vështirësi të vazhdueshme sociale dhe ekonomike gjatë zbatimit të Strategjisë. Identifikimi i çështjeve, problemeve dhe mundësive për të trajtuar dhe për t'u marrë me ruajtjen e biodiversitetit në SPVB 2011 - 2020, përkatësisht Objektivat Strategjike (OS) dhe masat e ndërlidhura (M), duken disi vizionare. Prandaj, në versionin e rishikuar u përpoqëm të jemi më realist dhe edhe pse përcaktuam masa afatgjata, u fokusuam në aktivitete të cilat kanë një potencial më të lartë për tu financuar dhe kanë mundësi të jenë të suksesshme. Është e rëndësishme që veprimet që janë ndërmarrë në nivel lokal kanë mundësi për të fituar mbështetjen dhe angazhimin e banorëve lokalë.

4.2 Të vazhdohet me informacionet të cilat janë në dispozicion

Është e qartë që inventarizimi i bimëve dhe kafshëve është i vjetër dhe i pa kompletuar. Prandaj, të dhënat për biodiversitetin në Kosovë janë të pamjaftueshme për të filluar një proces gjithëpërfshirës, në shkallë vendi dhe në mënyrë strategjike të planifikohet ruajtja e biodiversitetit. Megjithatë, të pritët për të zbatuar masat e duhura deri sa të bëhet inventarizimi i plotë; kjo thjesht çon në humbjen e mëtejme të biodiversitetit. Kosova ka për të zhvilloj SPVB me atë që është tashmë në dispozicion, të përpiqet për të hyrë dhe me efikasitet të përdorë fondet ndërkombëtare, dhe të përfitojnë nga sinergjitë, sidomos kur bëhet fjalë për bashkëpunimin me palët e interesuara.

4.3 Të jetë e afatizuar

Edhe pse afati parashikon 10 vjet, Strategjia është një "dokument i gjallë", që do të thotë se ajo duhet të përditësohen rregullisht për shkak të ndryshimit të parametrave. Këta përditësime të sigurt se veprimet mund të jenë prioritet për shkak të nevojave dhe burimeve financiare.

4.4 Të ndalet humbja e mëtejme e biodiversitetit

Arritjet për të ndaluar humbjen e mëtejme të biodiversitetit është e vështirë të përcaktohen dhe maten. Gjithsesi, përmes procesit të analizës së problemeve dhe përshtatjes së veprimeve përkatëse çdo disa vjet, krijohet një potencial i lartë që në mënyrë efektive të mbrohen dhe menaxhohen burimet natyrore të Kosovës duke shmangur humbjen e mëtejme të biodiversitetit.

4.5 Të ketë qasje të integruar dhe ndarje të përgjegjësive

Roli kryesor dhe përgjegjësitë për çështjet që kanë të bëjnë me biodiversitetin janë të MMPH-së, por edhe autoritetet e tjera publike kanë përgjegjësi brenda mandatit të tyre, kur është fjala për biodiversitetin, të tilla si ministritë tjera, komunat, etj.; dialogu me dhe ndërmjet këtyre organeve duhet të sigurohet dhe problemet e biodiversitetit duhet të përfshihen në të gjithë sektorët. Përveç kësaj, është e nevojshme që edhe pronarët e tokave private, komuniteti i biznesit dhe publiku i gjerë të kuptojnë përgjegjësitë e tyre në ruajtjen e trashëgimisë natyrore të Kosovës. Plani i Veprimit tregon qartë përgjegjësitë për secilin intervenim dhe përmes zbatimit të suksesshëm të gjithë aktorët, institucione apo individë, do të jenë përfitues, dhe në fund natyra vetvetiu.

4.6 Të ndiqen parimet strategjike

Bazuar në kërkesat e KBD dhe dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës, parimet themelore e mëposhtme janë përcaktuar si pikë fillestare e Strategjisë:

- Biodiversiteti paraqet vlerat unike, të cilat Kosova duhet ti përdorë si burim për zhvillimin e mëtejshëm duke ndërmarrë masat e nevojshme për inventarizimin, ruajtjen dhe përmirësimin e këtyre vlerave;
- Ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i biodiversitetit duhet të bëhet pjesë e politikave dhe legjislacionit të sektorëve tjerë të cilat i përdorin ose kanë ndikim në këto burime natyrore;
- Harmonizimi i aktiviteteve në nivel lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar dhe duke qenë të vetëdijshëm se këto vlera janë pjesë përbërëse e ruajtjes së biodiversitetit.

5. VIZIONI DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

5.1 Vizioni

Vizioni ynë për biodiversitetin është të sigurohet begatia unike e bimëve, shtazëve dhe peizazheve e cila do të kontribuojë në rritjen e mirëqenies për popullin e Kosovës.

5.2 Objektivat Strategjike

Gjatë procesit të rishikimit të SPVB – së bashku me palët e interesuara janë bërë përpjekje që Objektivat Strategjike të SPVB të mbesin të njëjta por të njëjtat të bëhen “SMART” (specifike, të matshme, të arritshme, reali stike dhe të afatizuara).

Objektiva Strategjike 1:

Deri me 2020, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka ndërmarrë masat të zhvillojë dhe zbatojë një kornizë ligjore dhe institucionale në harmoni me standardet e BE-së.

Objektiva Strategjike 2:

Deri me 2020, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të iniciojë dhe mbështesë projekte të cilat kontribuojnë në mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e gjendjes së llojeve të bimëve dhe shtazëve, vendbanimeve natyrore dhe peizazheve reprezentative.

Objektiva Strategjike 3:

Deri më 2020, mbrojtja e natyrës është inkorporuar në politikat sektoriale përmes bashkëpunimit të Ministrisë me palët e rëndësishme të interesit duke siguruar politika të integruara sektoriale, menaxhim efektiv dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të biodiversitetit.

Objektiva Strategjike 4:

Deri me 2020, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të mbështesë dhe bashkëpunojë ngushtë me komunat, OJQ-të dhe universitetin të zbatojnë projekte në sektorin e edukimit dhe komunikimit dhe do të ndërmarrë hapa për promovimin e biodiversitetit dhe mbrojtjen e natyrës në shoqëri përmes aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes.

6. RAPORTET E GRUPEVE PUNUESE

6.1 Llojet, habitatet, peizazhet, mineralet, fosilet dhe zonat e mbrojtura

6.1.1 Biodiversiteti i Kosovës

Kosova edhe pse është një shtet me sipërfaqe të vogël (10.908 km²) është mjaftë e pasur në aspektin e shumëllojshmërisë bimore. Pozita gjeografike, faktorët gjeologjik, pedologjik, hidrologjik, relievi dhe klima, janë disa prej faktorëve që kanë mundësuar që Kosova të ketë një diversitet të pasur biologjik dhe peizazhor. Veçanërisht vendi është i pasur me bimë dhe lloje bimore, i pasuruar edhe nga prania e llojeve të shtrira në jug gjatë periudhave të kohës së akullnajave. Trembëdhjetë lloje bimore janë identifikuar që rriten vetëm në Kosovë (lloje endemike) dhe rreth 200 lloje që rriten vetëm në Ballkan. Biodiversiteti i bimëve të Kosovës është rezultat i ndërveprimeve komplekse të faktorëve fizikë, duke krijuar kushte të favorshme për lloje bimore dhe një shumëllojshmëri të gjerë të kushteve të vendbanimeve. Këta faktorë gjithashtu shpjegojnë nivelin e lartë të diversitetit të kafshëve në këtë territor relativisht të vogël. Ka rreth 46 lloje gjitarësh në Kosovë, shumica prej tyre me rëndësi rajonale dhe globale. Pjesa më e madhe e diversitetit të Kosovës gjendet në malet e larta në rajonet jugore dhe perëndimore të vendit.

Shumë faktorë, siç është degradimi i habitateve dhe ndryshimet klimatike në nivel global kanë ndikim të drejtpërdrejtë në uljen dhe pjesërisht zhdukjen e llojeve të ndryshme të bimëve dhe kafshëve. Vendbanime të rëndësishme janë dëmtuar dhe degraduar, si dhe ekosistemet janë destabilizuar si pasojë e ndërhyrjes së njeriut, veçanërisht në ekosistemet pranë vendbanimeve. Shkaktuar nga praktikatat e paqëndrueshme, të prerjes së paligjshme të pyjeve dhe zjarret, lloje të ndryshme përballen me rrezikun e humbjes së vendbanimit të tyre dhe futja e llojeve pushtuese të cilat shpesh ndryshojnë strukturën floristike e ekosistemeve.

Një tjetër fakt i cili kontribuon në humbjen e biodiversitetit të bimëve është si pasojë që njerëzit lokalë e përdorin fito-diversitetin për shekuj me radhë, mbledhja aktuale e pakontrolluar e bimëve mjekësore dhe aromatike, manaferrave dhe kërpudhave çon në dëme të mëdha dhe humbje alarmante, të cilat mund të kenë pasoja të pa parashikueshme në të ardhmen.

Ekosistemet e ujit janë shkatërruar në vazhdimësi; ndotja nga burimet e amvisërive dhe industriale si dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i rërës dhe zhavorrit, minierat në shtretërit e lumenjve rezultojnë me degradimin e ligatinave dhe lumenjve si rezultat i kësaj edhe në humbjen e llojeve ujore bimore dhe peshqve. Kjo ka ndikime specifike tejet negative në shpendët e ujit; disa lloje të shpendëve tashmë janë humbur.

Shumica e llojeve të kafshëve në vend janë të kërcënuara nga shkatërrimi i vendbanimeve pyjore. Edhe pse ndikimet në biodiversitet për shkak të gjuetisë janë ulur, ende ka aktivitete të paligjshme të raportuara, sidomos gjatë fundjavës në kuadër të zonave të mbrojtura, duke çuar në rënie të popullacioneve të kafshëve.

6.1.2 Flora dhe Vegjetacioni i Kosovës

Disa shkencëtarë vendor dhe ndërkombëtar kanë kryer kërkime mbi florën dhe bimësinë gjatë dekadës së fundit; megjithatë, ende nuk ka inventarizim të plotë të florës të Kosovës dhe numrin e saktë i nënlojeve vegjetative në vend nuk është i njohur. Sipas Librit të Kuq të Florës Vaskulare të Republikës së Kosovës, të publikuar në vitin 2013 me mbështetjen e GIZ-it Gjerman dhe MMPH, ka

rreth 2.800 - 3.000 lloje të florës vaskulare. Bazuar në njohuritë aktuale, vegjetacioni i Kosovës është i përfaqësuar me 139 asociacione bimore të grupuara në 63 aleanca, 35 rende dhe 20 klasa. Qendrat e biodiversitetit floristik në Kosovë konsiderohen të jenë: Malet e Sharrit, Bjeshkët e Nemuna, Koritniku dhe Pashtriku të cilat strehojnë veçanërisht llojet endemike, sub-endemike dhe relikte bimore, pa lënë mënjanë disa zona bimore e rëndësishme në pjesët veriore dhe qendrore të Kosovës. Figura 2 paraqet hartën e Zonave të Rëndësishme të Bimëve.




Figura 2: Harta e Zonave të Rëndësishme të Bimëve

6.1.3 Fauna e Kosovës

Fauna e Kosovës karakterizohet me diversitet të madh të llojeve edhe pse hulumtimet ende nuk kanë përfunduar, vlerësohet se në Kosovë jetojnë rreth 250 lloje të kurrizorëve, 200 lloje të fluturave dhe rreth 500 nënlloje të makrozoobentosit. Numri i saktë i llojeve të kafshëve ende nuk është i njohur, kurse Libri i Kuq për faunën akoma nuk ekziston. Zonat më të pasura me faunë janë të gjitha masivet malore të Kosovës, vlen për tu veçuar Malet e Sharrit dhe Bjeshkët e Nemuna. Pyjet dhe ekosistemet malore ofrojnë kushte të përshtatshme jetese për popullacionet e gjitarëve të mëdhenj, si ariu i murrmë (*Ursus arctos*), rrëqebulli (*Lynx lynx*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), dhe një numër shumë i madh i shpendëve të ndryshme grabitqare dhe - të mos harrojmë - këngëtarë shumë të rëndësishme të ornito-faunës së Kosovës, Ballkanit dhe Evropës. Në përgjithësi, liqenet dhe kënetat në Kosovë janë shumë të rëndësishme, si vende për ushqyerjen dhe pushimin e shumë shpendëve gjatë rrugëve migratore.

Ekzistojnë dy zona të mbrojtura, të cilat janë shpallur në vitin 1955 vetëm për të mbrojtur dy lloje të kafshëve dhe vendbanimet e tyre: Kozhnjari për mbrojtjen e Dhisë së egër (*Rupicapra rupicapra* L.) në komunën e Deçanit dhe ai i Rusenicës për Rrëqebullin (*Lynx lynx* L.) në komunën e Suharekës. Këto zona janë shpallur në bazë të legjislacionit të asaj kohe dhe që të dyja janë Zona Strikt të Mbrojtura për këto lloje të cilat janë të kërcënuara dhe të rralla edhe në nivel Evropian.

Gjithashtu duhet të përmendet se si lloje të rrezikuara në nivel ndërkombëtar, janë Shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), Fajkoj thonjë bardhë (*Falco naummani*) dhe Pulegra (*Tetrao urogallus*).

6.1.4 Sistemi i Zonave të Mbrojtura në Kosovë

Klasifikimi i zonave të mbrojtura në Kosovë është i përcaktuar me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës (Nr. 03/L -233), të dt. 09 Nëntor 2010. Zonat e mbrojtura shpallen me qëllim të mbrojtjes dhe përkujdesjes së biodiversitetit, peizazhit, karakteristikave natyrore dhe trashëgimisë kulturore si dhe ofrimin e menaxhimit efektiv përmes mjeteve juridike dhe të tjera. Klasifikimi i zonave të mbrojtura në Kosovë ka për qëllim që të jetë në përputhje me atë të Unionit Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës IUCN¹, por kjo ende nuk është në përputhje të plotë me të. Shpërndarja e zonave të mbrojtura në Kosovë mund të gjendet në Shtojcën I.

Aktualisht numri i zonave të mbrojtura (vlerave natyrore) në Kosovë është 175 që përfshin një sipërfaqe prej 118.370,5 hektarë (rreth 11% e territorit të Kosovës). Këto zona janë përcaktuar si: 19 Rezervate Strikte Natyrore ('Rezervati i Arnenit', 'Mali i Kozhnjerit dhe Maja Ropsit', 'Rusenica', 'Kamilla', etj), 2 Parqe Kombëtare (PK "Sharri" dhe PK "Bjeshkët e Nemuna"), 147 Monumente të natyrës (p.sh. "Drini i Bardhë dhe Shpella e Radavcit ", "Gryka e Rugovës", "Kanjoni i Drinit të Bardhë dhe Ura e Fshajtë", "Trungu i Rrapit në Marash" etj), 1 Park Regjional Natyror ("Gërmia"), 1 Zonë e Mbrojtur e Veçantë për zogjt ("Ligatina e Hencit - Radevës"), dhe Peizazhi i mbrojtur "Shkugëza".

Zonat më të mëdha nën mbrojtje mund të gjenden në dy Parqet Kombëtar me 115.957 hektarë. Lista e të gjitha zonave të mbrojtura është i përfshirë në Shtojcën II. Në bazë të Ligjit të ri për Mbrojtjen e Natyrës, ka filluar harmonizimi i klasifikimit të ZM-ve, por procesi ende nuk është përfunduar dhe puna në lidhje me regjistrin qendror të zonave të mbrojtura është e vazhdueshme.

Kategoria IUCN	E shpallur si	Nr.	Sipërfaqja/ha
I	Rezervat Strikt Natyror	19	9.775,25
II	Park Kombëtar	2	115.957,00
III	Monumente natyrore	147	6.004,45
V	Park Regjional Natyror	1	1.126,00
V	Peizazh i Mbrojtur	4	124,00
V	Zonë e Veçantë e Mbrojtur	1	109,50
Gjithsejtë:		175	118.370.50²

Tabela 1: Zonat e Mbrojtura sipas kategorive
Burimi: IKMN, të dhëna aktuale

¹ IUCN (Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës është një Organizatë Jo Qeveritare

² Shpjegim: disa nga Rezervatet Strikte Natyrore janë Brenda Parqeve Kombëtare; si rrjedhojë e kësaj shifrat matematikisht nuk janë korrekte.

6.1.5 Menaxhimi i Zonave të Mbrojtura

Aktualisht, vetëm disa zona të mbrojtura në Kosovë kanë organe menaxhuese, shumica nuk kanë asnjë strukturë menaxhuese. Menaxhimi i Parkut Kombëtar "Sharri" bëhet nga Drejtoria e Parkut e cila gjendet në Prizren, ndërsa për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" Drejtoria e është në Pejë. Parku Regjional "Gërmia" menaxhohet nga ndërmarrja publike "Hortikultura". "Shpella e Gadimës" menaxhohet nga Drejtoria në Gadime të krijuar nga MMPH. "Maja e Ropsit" dhe të gjitha rezervatet strikte të natyrës, "Gubavci", "Kozhnjeri në Deçan", "Malet e Prilepit" "Rusenica", "Maja e Arnenit" janë brenda PK "Sharri" dhe PK "Bjeshkët e Nemuna" dhe janë nën menaxhimin e drejtorive të parkut. Monumentet tjera të natyrës menaxhohen nga autoritetet komunale. Vetëm PK Sharri ka Plan Hapësinor miratuar dhe gjithashtu Plani të menaxhimit, plani hapësinor për PN "Bjeshkët e Nemuna" është në përgatitje e sipër dhe të gjitha zonat e tjera të mbrojtura nuk kanë plan të menaxhimit.

6.1.6 Ruajtja 'Ex - situ' e Biodiversitetit

Ruajtja "ex-situ" është një teknikë e ruajtjes së të gjitha niveleve të diversitetit biologjik jashtë vendbanimeve të tyre natyrore, nëpërmjet teknikave të ndryshme si kopshte zoologjike, mbajtje në robëri, aquariume, kopshte botanike, dhe banka gjenetike. Në Kosovë ende nuk ka kopsht botanik, arboretum por nuk ka as kopsht zoologjik ose ndonjë program për kultivimin (mbarështimin), mbajtjen e llojeve të rralla dhe të rrezikuara jashtë vendbanimeve të tyre natyrore. Ka disa përpjekje për të krijuar një Bankë të Gjeneve për llojet bimore në kuadër të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë në Universitetin e Prishtinës.

Deri më tani nuk ka praktika të institucionalizuara për të ruajtjen "ex - situ" të llojeve; ekzistojnë disa nisma private për mbajtjen e disa llojeve të faunës së egër nëpër të ashtuquajturat "mini kopshte -kopshte zoologjike". Një projekt që vlen të përmendet është "Pylli i Arinjve" Prishtina. Ideja e këtij projekti ishte që të mblidhen të gjithë 13 arinjtë e murrme të mbaheshin në mini-kopshtet zoologjike në afërsi të restoranteve të ndryshme në kushte ekstreme të këqija në tërë Kosovën dhe transferimin e tyre në "Pyllin e Arinjve" duke ju ofruar kushte më të natyrshme dhe miqësore këtyre kafshëve. Projekti zbatohet nga Fondacioni për mbrojtjen e kafshëve Vier Pforten Kosova në bashkëpunim me MMPH-në, Komunën e Prishtinës dhe me mbështetjen e Fondacionit për mirëqenien e kafshëve VIER Pforten International, me seli në Vjenë, Austri. Të gjithë arinjtë janë vendosur aktualisht në shtatë sektorë me një sipërfaqe totale prej rreth 2 ha. Gjendja e përgjithshme e arinjve në momentin e mbërritjes së tyre në Pyllin e arinjve ishte shumë e vështirë pasi ata ishin të stresuar dhe ishte vështirë për ti mësuar për të përdorur lirinë dhe kushtet që ju ofrohen atyre.

6.1.7 Shpallja e Zonave Potenciale për Natura 2000 në Kosovë

Kosova nuk është anëtare e Bashkimit Evropian (BE) dhe për këtë arsye nuk është i detyruar të caktojë zonat e Natura 2000. Megjithatë, Kosova ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me Komisionin Evropian në korrik të vitit 2014, që do të thotë se vendi tashmë është i fokusuar në përafrimin e legjislacionit të tij kombëtar me *acquis communautaire* në përgjithësi. Shpallja e zonave NATURA 2000 - kërkon një kohë dhe burime për tu zbatuar - është në përputhje të plotë me angazhimin dhe do të jetë një hap i pa evitueshëm në procesin e përgatitjes për anëtarësim.

Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA) , Mars 2016 deklaroi se transpozimi i Direktivave të BE-së për fushën e mbrojtjes së natyrës në legjislacionin kombëtar pothuajse është arritur dhe dispozitat tjera, p.sh. legjislacioni dytësor, do të transpozohet gradualisht. Dokumenti gjithashtu përfshin disa aktivitete përgatitore për krijimin e rrjetit të Natura

2000 të cilat janë prioritete afatshkurtra dhe afatmesme, si ajo për përcaktimin e kufijve të qartë në mes të regjioneve bio-geografike, krijimi i hartave të terrenit, inventarizimi i llojeve, etj.

Kosova nuk është palë në Konventën e Bernës, që do të thotë se Rrjeti Emerald nuk është zhvilluar në vend. Rrjeti Emerald është përdorur shpesh nga Komisioni Evropian si hapi i parë në rrugën për identifikimin e zonave të ardhshme NATURA 2000. Tashmë në vitin 2008, një Raport paraprak i zonave në Kosovë është hartuar në kuadër të "Projektit të Menaxhimit të Qëndrueshëm të Pyjeve".

Ekziston Udhëzimi Administrativ Nr. 03/156 mbi shpalljen e Rrjetit Ekologjik i nënshkruar nga Kryeministri në vitin 2013, me qëllim të krijimit të rrjetit ekologjik kombëtar. NATURA 2000 nuk përmendet direkt në dokument në tekst, por është e qartë se rrjeti ekologjik mbulon detyrimisht edhe llojet e habitateve dhe llojeve me interes për Komunitetin, si karakteristika të synuara të ruajtjes, për të cilat do të zhvillohen objektivat e duhura të ruajtjes. IKMN është përgjegjëse për ngritjen e rrjetit ekologjik, përkatësisht rrjetin e NATURA 2000. Menaxhimi i këtyre zonave do të kryhet nga administratat përkatëse të ZM-ve apo ato të komunave jashtë ZM të mëdha. Marrëveshjet për menaxhimin e zonave NATURA 2000 jashtë zonave të mbrojtura duhet dakordohet, sepse Direktivat nuk kërkojnë posaçërisht planet e menaxhimit, marrëveshjet kontraktuale me pronarët e tokës/menaxherët mund të jenë një alternativë.

6.1.8 Iniciativa e Parkut Ndërkufitar të Paqes (Kosovë - Shqipëri - Mali i Zi)

Me qëllim të fuqizimit të mbrojtjes së natyrës në nivel regional, Kosova ka qenë pjesë aktive e disa iniciativave, projekteve dhe hulumtimeve në rajonin e Ballkanit Perëndimor, apo edhe pjesë e nismave ndërkufitare me vendet fqinje.

Bjeshkët dhe luginat e Kosovës, Shqipërisë së Veriut dhe Mali i Zi ndajnë një peizazh me bukuri të egër, florë dhe faunë të jashtëzakonshme, si dhe një mënyrë jetese tradicionale, që është pothuajse unike në Evropë dhe relativisht i paprishur nga zhvillimi modern. Megjithatë, është një peizazh i kërcënuar depopullimi, prerjet e paligjshme të pyjeve dhe shkatërrimet tjera mjedisore. Krijimi i Parkut Ballkanik të Paqes do të bashkojë komunitetet ekzistuese të të tre vendeve në ruajtjen e biodiversitetit duke u mundësuar njerëzve lokalë të vazhdojnë të jetojnë në lugina, të mbështetur nga turizmi të qëndrueshëm.

Iniciativa për shpalljen e Parkut Ndërkufitar ka rrjedhë nga shoqëria civile, nga Organizatat Joqeveritare: OJQ "Aquila" Pejë - Kosovë, OJQ "Intelektualët e Rinjë Shpresë" Shkodër - Shqipëri, dhe OJQ "Hali" Rozhajë - Mali i Zi të cilat kanë bërë hapat e parë në këtë drejtim, dhe kanë gjetur mbështetjen e një numri të aktivistëve nga Universiteti Colgate në SHBA dhe Bradford në Mbretërinë e Bashkuar. Qëllimi i kësaj iniciative është ruajtja e trashëgimisë natyrore të ndryshme, kulturore, promovimi i paqes dhe harmonisë mes njerëzve dhe natyrës dhe për të mundësuar lëvizjen e lirë përtej kufijve politikë duke bërë të mundur zhvillimin e qëndrueshëm.

Deri më tani, ky Park ndërkufitar nuk është themeluar; Megjithatë, zonat përkatëse në vendet përkatëse janë nën mbrojtje: Kosova e ka shpallur Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" (Ligji Nr.04/L-086 Dhjetor 2012), Mali i Zi ka shpallur Parkun Kombëtar "Prokletije", dhe Qeveria Shqiptare është në proces për shpalljen e Parkut Kombëtar Alpet (shpallja parashikohet në 2016).

6.1.9 Mbrojtja e Peizazheve

Nga pikëpamja gjeologjike, Kosova është e vendosur në një territor shumë interesant, duke shfaqur një llojllojshmëri të shtresave të ndryshme gjeologjike. Duke filluar nga kristale të vjetra shkëmbore të Proterozoikut, deri në shkëmbinj të moshës Quaternare, që përfshijnë lloje të ndryshme sedimentare, magmatike dhe metamorfike shkëmbore që kanë shtrirje më të vogël. Në të kaluarën, dhe në bazë të të dhënave në dispozicion, disa peizazhe janë vënë nën mbrojtje ligjore, disa prej tyre janë konsideruar më të rëndësishme, të tilla si "Mirusha", "Gërmia", monumente natyrore me rëndësi gjeologjike, hidrologjike, peizazhore, speleologjike dhe botanike janë Gryka e Rugovës, Gryka e Lumëbardhit, etj.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mbrojtjes së peizazheve të tilla nga aktivitetet minerare, Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis për aktivitetet e planifikuara është i detyrueshëm (shih gjithashtu 6.4.3). Kosova ende nuk është nënshkruese e Konventës Evropiane Peizazhet (Firence 2000). Megjithatë, krijimi i një baze të dhënash për gjendjen e peizazheve në përgjithësi, do të ndërmerret.

6.1.10 Minerale dhe Fosilet

Kosova karakterizohet me një përbërje të komplikuar gjeologjike duke formuar bazën e një spektri të gjerë të burimeve minerale metalike dhe jo-metalike, të burimeve energjetike, materialeve inerte dhe ujërave nëntokësore të ndryshme. Burimet natyrore në Kosovë ishin dikur "shtylla kurrizore e industrisë". Megjithatë, prodhimi aktualisht është i ulët për shkak të investimeve të pamjaftueshme në pajisje. Në mesin e burimeve natyrore që ishin më parë të rëndësishme për ekonominë e Kosovës ishin mineralet dhe metalet, mes tjerash, linjiti, alumini, kromi, magnezi, nikeli, plumbi, zinku, mangani, boksiti dhe disa materiale të ndryshme të ndërtimit. Për më tepër, burime jo-metalike dhe minerale inerte si mermer, dunitë, gëlqere, kuarc, rërë kuarci, talk, asbest, diabaz, rërë balte, etj.

6.1.11 Indikatorët e Biodiversitetit

Shumë vende kanë bërë angazhime për të përmbushur objektivat globale për ruajtjen e biodiversitetit dhe zhvillimin e qëndrueshëm, të tilla si ato të parashikuara në objektivat e Aichi për Biodiversitetin nën ombrellën e KBD, Objektivat Zhvillimore të Mijëvjeçarit (OZHM), si dhe objektivat e marrëveshjet tjera shumëpalëshe mjedisore. Më qëllim të vlerësimit të progresit drejt këtyre qëllimeve, indikatorë të matshëm të ndryshimeve në statusin e biodiversitetit nevojiten, të dhëna dhe informata si dhe ekspertizë për të interpretuar dhe përdorë njohuritë që ata ofrojnë.

Kosovës i mungojnë indikatorët e tillë zyrtar kombëtar të biodiversitetit, kjo krijon pengesa për përdorimin e të dhënave dhe adresimin e çështjeve me prioritet kombëtar. Këta indikatorë do të shërbenin si vegla për të vlerësuar gjendjen e biodiversitetit dhe kërcënimeve të tij. Për zhvillimin e indikatorëve të biodiversitetit, dokumente udhëzuese janë në dispozicion, p.sh. nga UNEP/WCMC.

Problemet kryesore të identifikuara:

- Mungesa e inventarizimit të plotë për florën, faunën dhe vendbanimet (përveç Librit të Kuq të Florës Vaskulare);
- Mungesa e Librit të Kuq për Faunën;
- Mungesa e kapaciteteve njerëzore për hulumtimin e biodiversitetit;
- Mungesa e Indikatorëve Kombëtar të Biodiversitetit;
- Jo të gjitha ZM kanë trupa menaxhuese, plane hapësinore dhe menaxhuese;
- Buxhet i pamjaftueshëm për mbrojtjen e natyrës;
- Mungesa e kapaciteteve për qasje në fondet ndërkombëtare dhe gjetjen e fondeve.

Prioritetet – Veprimet Strategjike:

- Hulumtime, inventarizim dhe paraqitje hartografike e llojeve, vendbanimeve dhe peizazheve;
- Krijimi i bazës së të dhënave dhe Sistemit Informativ Qendror;
- Shpallja e Zonave të Veçanta të Mbrojtura të zogjve si IBA (Zona të Rëndësishme për Zogjtë);
- Fillimi i procesit dhe ndërmarrja e hapave për shpalljen e zonave NATURA 2000;
- Përgatitja dhe miratimi i planeve hapësinore dhe menaxhuese për zonat e tjera të mëdha të mbrojtura duke respektuar kushtet për mbrojtjen e natyrës;
- Zhvillimi i Indikatorëve Kombëtar të Biodiversitetit;
- Zhvillimi i projekt ideve që do të paraqiten tek donatorë të ndryshëm (BE, bilateral, etj.).

6.2 Edukimi, komunikimi, informimi dhe pjesëmarrja e publikut

6.2.1 Edukimi

Nevoja për ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e biodiversitetit është një proces i arsyeshëm, përfitimet dhe kërkesat e të gjitha palëve të përfshira, të cilat kanë shkallë të ndryshme edukimi shton nevojën e edukimit dhe komunikimit. Mbrojtja dhe ruajtja e natyrës shpesh nuk kuptohet drejtë nga sektori privat, se cilat janë efektet e ndërhyrjeve të tyre në biodiversitet dhe si të menaxhohen ato. Prandaj është me rëndësi vitale që të trajnohen të gjitha palët e interesuara për një komunikim efektiv për çështjet e menaxhimit të biodiversitetit.

Qëllimi i edukimit, informimit dhe pjesëmarrjes së publikut bëhet gjithashtu për të ndihmuar autoritetet publike në arritjen e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Biodiversitetit. Andaj nevojitet inkurajimi i popullatës së gjerë dhe për të zhvilluar forma të arsimit në të gjitha nivelet institucionale dhe jo-institucionale për të gjitha grupet e qytetarëve për mbrojtjen e biodiversitetit dhe larmisë peizazhore.

Vendi ynë ende po përballlet me probleme socio-ekonomike, dhe si pasojë edukimi për biodiversitetin konsiderohet si problem dytësor në procesin e edukimit të përgjithshëm. Janë bërë disa hapa në edukimin për Mjedisin dhe Biodiversitetin, dhe po përmirësohet në mënyrë të vazhdueshme, sepse kemi detyrim që brezave të ardhshëm t'iu lëmë një diversitet biologjik dhe peizazhor po aq të pasur sa kemi trashëguar ne. Andaj Edukimi i brezave të ardhshëm për rëndësinë e biodiversitetit është prioritet i MMPH-së.

Përmirësimi i edukimit, informimit dhe komunikimit janë hapat e parë në procesin e ndryshimeve sociale. Nëse konteksti për rëndësinë e biodiversitetit kuptohet më mirë, kjo mund të kontribuojë për të ndryshuar qëndrimin publik ndaj mjedisit dhe pranimin e përgjegjësisë me më shumë përfshirje në mbrojtjen dhe menaxhimin e natyrës. Për të rritur interesin për mbrojtjen e natyrës, për të kuptuar rëndësinë e vlerave të natyrës dhe nevojën për ruajtjen e saj, programet ekzistuese të shkollave kërkojnë përmbajtje të përmirësuara edukative duke përfshirë edhe punën praktike në terren. Shumë iniciativa ekzistojnë në këtë drejtim, por duhet të jenë të mbështetura në mënyrë të vazhdueshme:

- Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC) ka lansuar një program për edukimin për zhvillimin e qëndrueshëm. Kjo përfshin zhvillimin dhe futjen e një pakoje inovative të arsimit multimedia, si “Pako e Gjelbër”, për mësuesit e shkollave dhe nxënësit e tyre në Evropën Qendrore dhe Lindore. Në Kosovë mësuesit e shkollave në disa nivele janë

trajnuar dhe pajisur me materialet, e të ashtuquajturës "Paketa e Gjelbër". Përveç kësaj, një program është hartuar dhe licencuar për trajnimin e mësuesve për mbrojtjen e mjedisit. Në kuadër të këtij trajnimi, Klubet e gjelbra janë themeluar në nivel shkollë. Rreth 110 shkolla kanë përfituar nga ky program nga klasa e parë deri në klasën e 11-të.

- Përveç kësaj, MMPH ka bërë hapa pozitivë në sektorin e edukimit dhe ngritjen e ndërgjegjes së publikut për mjedisin. Përmbajtje të reja janë përfshirë në materialet shkollore, këto materiale didaktike janë publikuar, orë mësimore të arsimit mjedisor janë futur, ky është një proces i vazhdueshëm në Kosovë. Bazuar në një kornizë të re të kurrikulës së Kosovës duke filluar nga niveli parashkollor, ajo ofron informacionin e parë për mjedisin dhe biodiversitetin dhe informacionet janë të përshtatura për moshën e nxënësve. Nga këto njohuri përfitojnë të gjithë nxënësit përmes kurseve dhe moduleve, si aktivitete ndër-kurrikulare.
- Universiteti i Prishtinës për çdo vit organizon seminare verore me pjesëmarrës vendorë dhe ndërkombëtar duke shpërndarë materiale të ndryshme për nxënësit dhe stafin arsimor.
- Ka disa përmirësime në praktikë, disa qasje tërheqëse për pedagoget dhe aktivizimin e nxënësve dhe të rinjve në aktivitetet mjedisore janë futur në shkolla dhe komunitete. Për fat të keq, ka mungesë të vullnetarëve dhe shoqëria civile është e papërvajë për veprime të forta në komunitetet.

Përveç këtyre zhvillimeve pozitive, ka ende shumë për tu bërë në këtë sektor. Hartimi i programeve të edukimit projekteve dhe përfshirja e publikut të gjerë në procesin e planifikimit dhe menaxhimit biodiversitetit duhet të zhvillohen, inkurajohen dhe zbatohen në të ardhmen. Shoqëria civile duhet të jetë e informuar në lidhje me Konventën e Aarhusit (shih gjithashtu 2.2.8 dhe 6.2.2), e cili përcakton një numër të drejtave të publikut (individëve dhe shoqatave të tyre), në lidhje me mjedisin.

Programet edukative duhet të jenë të përshtatura për grup moshat e ndryshme, profesionet dhe interesat publike. Edukimi për biodiversitetin duhet të fillojë nga mosha parashkollore dhe përparësi duhet t'i jepet punës me fëmijët dhe nxënësit e shkollave paraprake. Bashkëpunimi me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA), dhe shkolla duhet të forcohet. Prodhimi i materialeve didaktike shtesë, me cilësi të lartë për të gjitha nivelet e qytetarëve është me rëndësi të madhe. Krijimi i grupeve mjedisore dhe shoqatave duhet të bëhet në të gjitha shkollat dhe në të gjitha nivelet e edukimit në Kosovë. Për përmirësimin e gjendjes së biodiversitetit në vijim do të konsiderohen:

- ↳ Aktivitete më specifike që kontribuojnë në mbrojtjen e biodiversitetit;
- ↳ Edukimi do të thotë krijimin e një qëndrimi pozitiv, mendim kritik ndaj mjedisit dhe në veçanti të biodiversitetit, e cila duhet të zbatohet;
- ↳ Edukimi për biodiversiteti është mjaft kompleks; ngritja e vetëdijes me qëllim të mbrojtjes, ruajtjes, menaxhimit dhe të përfitimit nga diversiteti biologjik dhe peisazhor është i nevojshëm;
- ↳ Format e edukimit jashtë shkollës për fushën e biodiversitetit dhe sidomos të disa grupeve të interesit (bujqësia, pylltaria, gjuetia, peshkimi, menaxhimi i ujërave, transporti, energjia, turizmi, etj.), pothuajse nuk ekziston;
- ↳ Bashkëpunimi me komunat është i rëndësishëm në sektorin e arsimit dhe koordinimi duhet të realizohet..

Problemet kryesore të identifikuara:

- Qëndrimi pasiv i qytetarëve ndaj biodiversitetit;
- Mungesa e fondeve për edukim mjedisor;
- Mos-përfshirja e mësimeve në të gjitha nivelet e trajnimit për çështjet e biodiversitetit;
- Programe të pamjaftueshme dhe materiale tjera lidhur me edukimin për biodiversitetin;
- Mungesa e bashkëpunimit ndër-institucional dhe OJQ-ve për lëmin e edukimit për mbrojtjen e mjedisit.

Prioritetet – Veprimet Strategjike:

- Ndryshimi i qëndrimit të popullatës ndaj biodiversitetit përmes veprimeve të përshtatura, p.sh. promovimi i rëndësisë për ruajtjen e llojeve të rrezikuara;
- Përdorimi i mjeteve financiare në forma më efikase dhe kërkimi i fondeve nga burimet tjera;
- Programe tjera trajnuese për mësuesit;
- Zbatimi i kurrikulës në të gjitha nivelet, bazuar në kornizën e kurrikulës së re;
- Shtimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe OJQ-ve për edukimin mjedisor.

6.2.2 Komunikimi, Informimi dhe pjesëmarrja e publikut

Niveli i ndërgjegjësimit në lidhje me mjedisin dhe konkretisht biodiversitetin dhe mbrojtjen e natyrës është tepër i ulët në Kosovë. Ekziston një nevojë e qartë për përmirësimin e komunikimit dhe informimit në lidhje me vlerat e biodiversitetit, si dhe ndikimet e humbjes së biodiversitetit në mjedis dhe tek njerëzit.

Menaxhimi i informimit në fushën e biodiversitetit vlerësohet si i një rëndësie të veçantë për Kosovën. Duke marrë parasysh shkëmbimin efektiv dhe përdorimin e informacionit ekzistues do të kursejmë kohë, para dhe energji, vëmendje jo e mjaftueshme i është dhënë për këtë fakt në të kaluarën.

Janë bërë hapa pozitivë në lidhje me ndarjen e informacionit, janë organizuar fushata nga ana e MMPH-së për festat e njohura ndërkombëtare, si për shembull Dita Botërore e Ujit, Dita Botërore e Tokës, Dita Ndërkombëtare e Biodiversitetit, Dita Botërore e Mjedisit, etj, të cilat janë instrumente të rëndësishme për të përmirësuar komunikimin dhe informacionin. Për fat të keq, vetëm disa aktivitete të tjera të zhvillohen gjatë vitit, të cilat konsiderohen të pamjaftueshme.

Përveç publikimit të materialeve informative dhe broshura, sektori ka marrë pjesë në programet e stacioneve radiofonike dhe televizive kombëtare dhe lokale. Por, shtypi dhe media elektronike nuk kanë programe të rregullta informuese mbi mjedisin dhe biodiversitetin. Kryesisht, informacioni transmetohet vetëm në rastet e aksidenteve ekologjike (fatkeqësitë natyrore, të tilla si zjarret, vërshimet, etj.), por jo në formën e informacionit të rregullt dhe parandalues. Një pjesë e informacionit është bërë nga MMPH-ja nëpërmjet in puteve shkrim në formë të Komunikatave për shtyp, broshura, gazeta, etj.

Pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje do të rriste cilësinë dhe zbatimin e vendimeve për mjedisin. Në këtë fushë, Konventa e Arhus-it (shih gjithashtu 2.2.8) luan një rol të madh. Duke vlerësuar rolin e qytetarëve, organizatave joqeveritare dhe sektorit privat, legjislacioni kombëtar rregullon të drejtën e qytetarëve. Dispozitat ligjore të sigurojnë:

- të drejtën për qasje në informata mjedisore;
- procedurat të cilat i mundësojnë publikut të paraqesë komentet dhe mendimet (në shkrim apo në formë verbale gjatë takimeve të organizuara në mënyrë të veçantë, ose në formë të kërkesave nga aplikantët) dhe në këtë formë marrin pjesë në procesin e vendim-marrjes;
- të drejtën për shqyrtimin e procedurave për të kundërshtuar vendimet publike që janë bërë pa respektuar dy të drejtat e lartpërmendura apo ligjin e mjedisit në përgjithësi (qasja në drejtësi).

Në bashkëpunim me OJQ-të, komunat dhe aktoret tjerë janë organizuar takime dhe diskutime me publikun për sa i përket ligjeve të reja, strategjive, planeve hapësinore - dhe planeve tjera, si dhe projektet e planifikuara. Megjithatë, përmirësimet në përdorimin e këtij instrumenti për pjesëmarrjen e publikut janë të nevojshme dhe informatat për qytetarët në lidhje me të drejtat e tyre duhet të fuqizohen.

Problemet kryesore të identifikuara:

- Mungesa e komunikimit dhe informimit profesional dhe informacion jo i mjaftueshëm i publikut në lidhje me biodiversitetin;
- Mungesa e vetëdijes dhe pjesëmarrjes së ulët të publikut;
- Mungesa e koordinimit dhe bashkëpunimit në mes të institucioneve që kanë të bëjnë me biodiversitetin;
- Mungesa e ekspertizës profesionale në fushën e komunikimit dhe informimit.

Prioritetet - Veprimet Strategjike:

- Zhvillimi i fushatave të veçanta në lidhje me ndërgjegjësimin për biodiversitetin të përshtatura për grupet e synuara, me një theks mbi fëmijët dhe të rinjtë;
- Fushata Kombëtare të Ndërgjegjësimit;
- Bashkëpunimi me mediat, botimet me probleme tematike (fletëpalosje, broshura, postera, etj.);
- Krijimi i programeve për komunikim dhe informim mbi biodiversitetin në institucionet përkatëse;
- Ndërtimi i ekspertizës profesionale në fushën e komunikimit dhe menaxhimit të informacionit në institucionet përkatëse.

SHFRYTËZIMI I QËNDRUESHËM I BIODIVERSITETIT - RESURSEVE NATYRORE

Biodiversiteti paraqet bazën e jetës në Planetin tonë, por ai është degraduar në masë alarmuese nga presionet e njeriut, përmes shfrytëzimit të resurseve natyrore, ky degradim kyç paraqet një kërcënim serioz për njerëzimin. Aktivitetet ekonomike janë shtytësit kryesor që qojnë në humbjen e biodiversitetit por në të njëjtën kohë shumë aktivitete të biznesit varen nga biodiversiteti. Në parim, të gjitha bizneset kanë ndikim direkt ose indirekt në biodivesitet.

6.3. Bujqësia, pylltaria, gjuetia, peshkataria dhe turizmi

6.3.1 Bujqësia

Sektori i bujqësisë konsiderohet momentalisht sektor mjaftë i rëndësishëm për arsye të mbështetjes në zhvillim nga institucionet qeveritare, duke ditur që ky sektor kryesisht mbështetet në resurse natyrore që mund të kanë ndikime të dukshme për biodiversitetin. Kjo mund të arrihet përmes aplikimit të metodave të menaxhimit të qëndrueshëm dhe aplikimin e teknologjive dhe praktikave miqësore për mjedisin, respektivisht natyrën. Zakonisht, kjo parashikohet që të realizohet me krijimin e rezervateve biologjike brenda fermave, zhvillimit të rrjetit të vendbanimeve natyrore për rreth dhe ndërmjet fermave, zvogëlimin e ndryshimit të vendbanimeve të egra natyrore në tokë bujqësore duke lënë një pjesë të tokës bujqësore jashtë prodhimit, me qëllim të ripërtëritjes së vendbanimeve natyrore, dhe përdorimi i praktikave të qëndrueshme në blegtori dhe shfrytëzimin e kullotave.

Në përgjithësi, toka në Kosovë është shumë pjellore dhe e përshtatshme për prodhimtari bujqësore për shkak të kushteve klimatike dhe faktorë tjerë. Territori i vendit është i ndarë në dy regjione: Rrafshi i Kosovës, i cili karakterizohet nga një klimë kontinentale me pak ndikim të klimës mesdhetare me reshje vjetore prej rreth 600 mm, dhe Rrafshi i Dukagjinit i cili karakterizohet nga klima mesdhetare me reshje vjetore prej 770 mm. Reshjet dhe pjelloria e tokës i plotësojnë kushtet për një prodhimtari të qëndrueshme të ushqimit për nevojat e popullatës lokale, por edhe për eksportin e disa produkteve bujqësore.

Në Kosovë rreth 61% e popullsisë jeton në viset rurale, ndërsa 38%³ e sipërfaqes së përgjithshme të tokës në Kosovë është tokë bujqësore e strukturuar në numër të madh të fermave me madhësi të vogël që paraqet brengën kryesore të industrisë bujqësore. Toka kryesisht është pjellore, por shumë e degraduar nga aktivitetet minerare të KEK- ut, Trepçës dhe Feronikelit dhe deponitë industriale të tyre. Këto deponi përbëjnë një element mjaftë kërcënues për biodiversitetin dhe zhvillimin e bujqësisë në afërsi të tyre, si shkak i përmbajtjes të mbetjeve të metaleve të rënda, e cila është dëshmuar nga analizat në kultura të ndryshme bujqësore. Përveç deponive industriale, deponitë urbane si dhe hedhja e mbeturinave jashtë tyre (fusha, pyje, përgjatë rrugëve, lumenjve, përrenjve, ndërtime të egra etj.) janë duke paraqitur kërcënim të madh për ruajtjen e tokave bujqësore dhe biodiversitetit në përgjithësi. Humbja e biodiversitetit si pasojë e shfrytëzimit të plehrave dhe pesticideve gjatë zhvillimi i aktiviteteve bujqësore janë relativisht të ulëta shpesh për shkak të çmimeve të pa përballueshme për fermerin kanë zvogëluar aplikimin e tyre.

Në Republikën e Kosovës bujqësia konsiderohet një nga degët e cila ka ndikime direkt dhe indirekte në ruajtjen e biodiversitetit. Bujqësia në vendin tonë ka pjesëmarrje mjaftë të lartë në

³ Raporti i Gjelbër 2015, Dhjetor 2015

Prodhimin e Përgjithshëm Vjetor/PPV me rreth 11.9%⁴. Gjatë viteve të 50-ta deri 70-ta të shekullit të kaluar ka ekzistuar një mendim për shtimin e sipërfaqeve bujqësore në kurriz të sipërfaqeve apo vendbanimeve të ndryshme natyrore. Natyrisht, që me këtë masë kanë pasur ndikim negativ në pyje dhe toka pyjore, e sigurisht edhe një ndikim negativ në ruajtjen e biodiversitetit në përgjithësi. Në Kosovë sipërfaqja e tokës që shfrytëzohet është 512,000 ha tokë (në pronësi dhe e marrë me qira nga të tjerët), me mesatare prej 3.9 ha tokë për ekonomi bujqësore. Sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës për prodhimi bujqësore në vitin 2014 ishte 413,635 ha, ose 80% të gjithëj sipërfaqes së tokës të shfrytëzuar nga 129,884 ekonomi bujqësore me një mesatare të sipërfaqes së tokës së shfrytëzuar bujqësore prej 3.2 ha⁵.

Livadhet dhe kullosat përfaqësojnë 54% të sipërfaqes së shfrytëzuar të tokës bujqësore në ekonominë bujqësore. Gjithëj sipërfaqja e livadheve dhe kullosave (duke përfshirë tokën e përbashkët) është 224,411 ha, nga të cilët 71% janë kullosa. Mesatarja e sipërfaqes së livadheve dhe kullosave për një ekonomi bujqësore është rreth 2.8 ha⁶. Shfrytëzimi ekstensiv i kullotave dhe livadheve ka pasur ndikim pozitiv në pasurimin e biodiversitetit. Ndikim të madha pozitive kanë rrjedhur sidomos nga shfrytëzimi i kullosave të cilat në natyrë konsiderohen si vendbanimet më të përafërta natyrore.

Të dhënat e më sipërme tregojnë se Kosova ka mundësi shumë të mira për ruajtjen e biodiversitetit, duke u mbështetur në rezultatet se rreth 54 % e tokave të shfrytëzueshme bujqësore janë të klasifikuara si livadhe dhe kullosa, si dhe kur dihet se mbi 44.7% e sipërfaqes së tokës janë pyje dhe toka tjera pyjore (shih 6.3.2).

Livadhet dhe kullosat zënë përqindje më të madhe të tokës së shfrytëzuar bujqësore, ndërsa kategoria e tokës së punueshme – arat kanë një pjesëmarrje prej 35%. Në këtë kategori të tokës, kultivohen kryesisht drithërat, që shfrytëzojnë 73% të sipërfaqes, bimët foragjere dhe rrënjore 15.5%, perimet 3.7%, bishtajoret për kokërr 2.4%, patatja 2.0%, si dhe kultura tjera. Kulturat shumëvjeçare marrin pjesë me 1.88% ose tokë të kultivuar 7,788 ha, nga të cilat pemët përbëjnë 1.06% respektivisht 4,390 ha, vreshtat kanë pjesëmarrje prej 0.78% ose 3,215 ha dhe fidanishtet me vetëm 0.04% që zënë sipërfaqen prej 183 ha⁷. Tabela 2 paraqet ndarjen e kulturave kryesore bujqësore.

Vitet/ Kultura	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Grurë	293,064	271,373	294,540	300,203	345,027	391,727	331,296
Misër	126,919	125,864	120,461	119,693	86,304	136,633	116,209
Elb	7,241	5,363	3,642	2,608	1,808	4,415	4,716
Thekër	1,410	834	1,371	1,457	740	571	1,521
Tërshërë	8,865	7,774	10,510	11,072	4,913	6,790	9,840
Patate	103,958	58,687	87,354	87,036	33,407	50,847	64,027
Domate	20,587	15,107	60,318	62,358	13,693	17,291	17,386
Spec	51,274	46,669	93,924	96,322	50,744	72,928	57,921
Molla	12,612	11,742	12,545	13,523	8,120	16,786	13,519
Dardha	2,867	1,748	2,495	2,510	1,562	4,259	1,363
Ftoni	425	165	275	265	506	977	224
Kumbulla	10,901	8,084	6,957	6,957	17,514	24,433	7,525
Qershia	362	161	257	256	167	354	211
Vishnja	419	301	255	255	1,175	381	793
Arra	465	300	314	371	234	483	229
Dredhëza	439	180	294	270	275	465	965
Mjedra	3	4	2	1	1	105	529
Manaferra	8	124	73	73	73	-	107
Rrush - verës	22,961	20,570	22,536	12,048	22,656	20,473	15,101
Rrush – tryeze	6,250	5,733	6,042	4,536	7,026	7,137	4,869

⁴ Po aty

⁵ Raporti i gjelber 2015

⁶ Raporti i gjelber 2015

⁷ ASK-Regjistrimi i Bujqësisë 2014

Tabela 2: Prodhimi i kulturave kryesore bujqësore për 7 vitet e fundit, e shprehur në ton (t)
Burimi: Anketa e Ekonomive Shtëpiake ASK ('08 -13); Regjistrimi i bujqësisë ('14).

Në Kosovë vitet e fundit është rritur trendi për kultivimin e bimëve foragjere me drithëra të kositura të gjelbra të cilat gjatë vitit 2014 kanë përfshirë një sipërfaqe deri në 26,554 ha, me një prodhimtari deri në 151,095 t⁸.

Bimët aromatike dhe mjekësore përbëjnë kulturat që përdoren për qëllime farmaceutike dhe konsum njerëzor, p.sh. kamomili, borziloku, kopra, livanda, mendra, sherbela, etj. Në kulturat e tjera industriale hyjnë kulturat tjera, si: soja, ricini, etj. Në vitin 2014 sipërfaqja e kultivuar me kultura industriale është 595 ha, ku pjesa më e madhe apo rreth 60% është e kultivuar me luledielli, duke u pasuar nga bimët aromatike dhe mjekuese (35%), kulturat e tjera industriale (4%) dhe duhani me vetëm 1%, e që në të kaluarën ishte një kulturë e kultivuar në një sipërfaqe shumë më të madhe (diku mbi 3,000 ha)⁹.

Blegtoria, është një nga sektorët tjerë të bujqësisë përmes së cilës shumë ekonomi shtëpiake vjelin të ardhura për familjet e tyre. Ky sektor i bujqësisë është në zhvillim e sipër dhe vazhdimisht është duke dhënë rezultate të mira në zhvillimin bujqësisë komerciale në vend. Trendët në blegtori dhe bujqësi intensive në ambiente të mbyllura janë në rritje. Natyrisht, kjo do të ketë ndikim të madh në biodiversitet dhe në kullosat e lëna djerrë.

Tabela 3 ofron një pasqyrë të mbarështimit të blegtorisë në vitin 2014.

Nr.	Lloji i kafshëve	Njësia	Numri/krerë	Pjesëmarrja %
1.	Gjedhe	Krerë	261,689	0,52
2.	Dele	//	183,584	0,36
3.	Dhitë	//	28,430	0,055
4.	Derra	//	34,188	0,057
5.	Kuaj, gomarë, mushka	//	2,980	0,007
Gjithsejtë;			510,871	100
Kategori tjera				
1.	Shpezë	Copë	2,692	100
2.	Peshk nga hurdhat	t	610	100
3.	Bletë	koshere	116,172	100

Tabela 3: Pasqyrë e blegtorisë në vitin 2014
Burimi: ASK- Regjistrimi i bujqësisë 2014

Sipërfaqja e tokës prej 4,729 ha ose 2.6% është identifikuar si e degraduar. Në pjesën mbetur prej 3% bimë të tjera të kultivuara, të cilat përfshijnë bimët industriale dhe aromatike, bimët dekorative, bimë për prodhimin e farave dhe fidanëve për shitje, etj E njëjta përqindje është e mbuluar nga dy kategoritë e tjera të tokës, të klasifikuara si toka jo-bujqësore (3%) dhe tokë e bujqësore jashtë shfrytëzimit 3%¹⁰.

Gjatë njëzet viteve të fundit, një lëvizje e fuqishme e popullatës lokale nga zonat e thella në qendrat urbane mund të vërehet. Në këtë kontekst, vegjetacioni pyjor është zgjeruar në fushat e

⁸ ASK- Regjistrimi i bujqësisë 2014

⁹ Po aty

¹⁰ Raporti i Gjelbert] 2015, Dhjetor 2015

mëparshme të kullotjes, natyrisht, me ndikime negative në biodiversitetin sepse numri i shumë llojeve bimore dhe shtazore është zvogëluar dhe disa janë zhdukur me zvogëlimin e vendbanimit të tyre natyror të kullosave.

Në Kosovë toka bujqësore është në procesin e privatizimit. Nga ajo, 88% është privatizuar kurse rreth 12%, e tokës publike mbetet e pa privatizuar, siç ishte në fillim të viteve të 90'-ta. Privatizimi është përcjellë me shumë kontradikta dhe probleme. Procesi ka filluar në vitin 2003, me privatizimin e Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH), e cila tani është në fazën përfundimtare.

6.3.1.1 Agrobiodiversiteti

Siç është përcaktuar nga Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë e Kombeve të Bashkuara (FAO), agrobiodiversiteti (i njohur edhe si biodiversiteti bujqësor) është rezultat i proceseve natyrore të përzgjedhjes dhe zgjedhjes së kujdesshme dhe zhvillimeve krijuese të fermerëve, barinjve dhe peshkatarëve gjatë mijëvjeçarëve. Agrobiodiversiteti është një nën-grup vital i biodiversitetit. Agrobiodiversiteti përfaqëson diversitetin midis kafshëve, bimëve dhe mikroorganizmave të rëndësishme për prodhimin bujqësor. Kjo fushë është e rëndësishme, sepse ka lloje bimore të panumërta që përdoren për ushqimin e njeriut dhe kafshëve dhe për këtë arsye, ushqimin e shumë njerëzve dhe sigurinë e jetesës varen nga menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve të ndryshme biologjike që janë të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi.

Për plotësimin e nevojave bazike, njeriu ka realizuar kryqëzimin e llojeve (varieteteve) të bimëve dhe kafshëve të ndryshme si dhe të racave për të rritur produktivitetin e tyre. Kjo çështje ka rezultuar me marginalizimin e llojeve të bimëve dhe racave autoktone të bagëtive me produktivitet të ulët ose, me fjalë të tjera, këto lloje janë zhdukur. Në Kosovë, autoritetet publike duhet t'i kushtojnë rëndësi më të madhe për ruajtjen e llojeve autoktone dhe ruajtjen e germoplasmës kombëtare për kërkime shkencore. Është e njohur se shumë lloje të 'vjetra të' grurit, misrit dhe pemëve me produktivitet të ulët janë lënë mënjanë ose janë të nën përfaqësuar; kafshët indigjene si Busha (lopë), Bardhoka (dele) Buallica etj., ato janë shumë më pak të pranishme në numër në blegtorin e vendit. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet Qenit të Sharrit (Pastorit Ilir) si racë autoktone e qenit të deleve me vlerë të veçantë.

Një degë tjetër e rëndësishme e bujqësisë aktualisht është në fazat e sajë fillestare, zhvillimi i bujqësisë organike. *"Bujqësisë Organike është një sistem i prodhimit që mban shëndetin e tokave, ekosistemeve dhe njerëzve. Ajo mbështetet në proceset ekologjike, biodiversitetin dhe ciklet e përshtatura me kushtet lokale, në vend të përdorimit të in puteve me efekte anësore. Bujqësisë Organike kombinon traditën, inovacionet dhe shkencën në dobi të mjedisit të përbashkët dhe për të promovuar marrëdhënie të ndershme dhe cilësi të mirë të jetës për të gjithë përfshirët¹¹.*

Topografia, peizazhi, gjeologjia dhe pedologjia dhe kushtet klimatike kanë krijuar kushte për bimësi të pasur edhe të bimëve mjekësore dhe aromatike shumë interesante dhe pemë frutore të egra. Ekziston një potencial i madh për zhvillimin e suksesshëm të këtyre llojeve të produkteve për të përmbushur kërkesën e brendshme dhe të eksportit në tregjet e huaja dhe për të ndihmuar në përdorimin e qëndrueshëm të këtyre bimëve dhe ruajtjen e vendbanimeve të tyre natyrore.

6.3.1.2 Organizmate e Modifikuar Gjenetikut / OMGJ-të

¹¹ Definicioni nga IFOAM - Organics International

Në Kosovë, nuk ka të dhëna të plota ose të përditësuara në lidhje me praninë e OMGJ-ve, as për bimët dhe as për kafshët. Deri më tani, Kosova nuk ka kornizë ligjore që do të rregullonte fushën e OMGJ-ve. MBPZHR-ja si institucion përgjegjës ka hartuar një projekt-ligj që do të rregullonte fushën e OMGJ-ve, por ligji nuk është miratuar ende. Pra, këto lloje të organizmave të përfaqësojnë një kërcënim të madh për zhvillimin e bujqësisë organike e cila është duke u promovuar. Pa të dhëna në lidhje me rreziqet e mundshme dhe ndikimet negative në mjedis dhe njerëzë, përdorimi i tyre nuk është i këshillueshëm. Sigurisht, mundësia e futjes së OMGJ përmes rrugëve ilegale nuk mund të përjashtohet. Për më tepër, Kosova ende nuk ka një laborator për testimin dhe zhvillimin e OMGJ-ve, e cila padyshim komplikon dhe rrit rrezikun "e kontaminimit" të bujqësisë, dhe të cilët mund të kenë efekte negative për biodiversitetin.

Problemet kryesore të identifikuara

- Humbja dhe fragmentimi i tokës bujqësore, rreth 800 - 1000 ha humben çdo vit, shndërrimi nga toka bujqësore në tokë ndërtimore ka ndikim negativ në ruajtjen e biodiversitetit;
- Nivel i lartë i ndotjes aktuale dhe të trashëguar e tokës bujqësore nga deponitë e mbeturinave, deponitë e ish minierave dhe hedhja e mbeturinave jashtë këtyre deponive;
- Mos organizimi dhe mos bashkëpunimi i ekonomive bujqësore ndërmjet veti dhe themelimi i kooperativave;
- Mungesa e trajnimeve përkatëse për fermerët në mirëmbajtjen e biodiversitetit, gjatë zhvillimit të aktiviteteve në bujqësi etj.

Prioritetet - Veprimet Strategjike

- Të zvogëlohet trendi i humbjes së biodiversitetit dhe tokës bujqësore;
- Të ruhen zonat me karakteristika reprezentative të vendbanimeve natyrore duke aplikuar bujqësinë tradicionale;
- Të fuqizohet bashkëpunimi ndërmjet fermerëve dhe të mbështesin prodhimtarinë bujqësore dhe biodiversitetin;
- Fermerët të përfshihen në edukim joformal fermerët për rëndësin e ruajtjes së biodiversitetit, posaçërisht lidhur me ndikimin e përdorimit të plehrave kimike dhe pesticideve.

6.3.2 Pyjet dhe sektori pyjor

Pyjet ndikojnë në jetën tonë të përditshme në mënyra më shumë se ne mund ta imagjinojmë. Pyjet ofrojnë vendbanime të llojeve të ndryshme të kafshëve dhe bimëve, ato formojnë burimin e jetesës për njerëzit; ato ofrojnë mbrojtje të pellgut ujëmbledhës, drurit dhe prodhimeve jo drusore, si dhe mundësitë e ndryshme rekreative; ato parandalojnë erozionin e tokës, ndihmojnë mbajtjen e ciklit të ujit duke zvogëluar rrezikun e përmytjeve dhe shkretëtirizimit, si dhe kontrollonin e ngrohjen globale duke përdorur dyoksidit të karbonit gjatë fotosintezës.

Inventarizimi i dytë i Pyjeve të Kosovës (NFI) është kryer në 2012/2013, dhjetë vjet pas të parit. Për herë të parë e gjithë sipërfaqja pyjore është vlerësuar. Qëllimi i NFI ishte të sigurojë informacion për qeverinë për ta ndihmuar zhvillimin e sektorit pyjor, për të vlerësuar qëndrueshmërinë e menaxhimit të pyjeve dhe për të përmbushur detyrimet e mundshme të raportimeve ndërkombëtare në sektorët e përdorimit të tokës, ndryshimeve në shfrytëzimin e tokave dhe sektorin e pylltarisë.

Sipërfaqet pyjore në Kosovë janë të qëndrueshme në përafërsisht janë rreth 481,000 ha (44,7% të sipërfaqes së përgjithshme). Të dhënat tregojnë se sipërfaqja pyjore është rritur me 5% (20.000 ha), supozohet se vendbanimet pyjore janë rritur në llogari të tokës bujqësore. Figura 3 tregon mbulushmerinë e pyjeve në Kosovë dhe Figura 4 prerjet e trungjeve në Rugovë.



Figura 3: Mbulushmeria e pyjeve në Kosovë
Burimi: AMMK Raporti i Natyrës 2006/2007



Figura 4 prerjet e trungjeve në Rugovë

Rreth 38% e sipërfaqes pyjore është në pronësi private, ndërsa 62% e pyjeve është publike. Cungishtat dominojnë zonat pyjore me rreth 84%. Pyjet e pastra gjethegjerë mbulojnë pothuajse 83% të sipërfaqes pyjore; lloji dominues është ah, pyjet halore mbulojnë 7% të sipërfaqeve pyjore dhe aty dominon bredhi dhe pisha.

Vëllimi në këmbë i drurëve me diametër në lartësi të gjoksit ≥ 7 cm mbetet në 40.5 milion m^3 përafërsisht njëjtë me dhjetë vite më parë. Në mesin e drurëve, llojet e Ahut kontribuojnë me 46% të vëllimit, ndërsa llojet e Qarrit përfaqësojnë 23%. Mesatarja e vëllimit në këmbë në Kosovë është 84 m^3/ha^{12} .

Nga analizat e dokumenteve dhe raporteve të ndryshme rezulton se çdo vit bëhet një prerje mesatare e vëllimit drusor deri në 950.000 m^3 /vit. Rrjedhimisht, prerjet vjetore mund të vlerësohen në afërsisht 1.6 milion m^3 , prej tyre vetëm një pjesë e vogël e prerjeve (7%) është kryer në përputhje me legjislacionin pyjor. Në nivel kombëtar rezulton se largimi vjetor dhe humbjet natyrore të drurit janë disi të balancuara me rritjen vjetore bruto. Bazuar në pjesën e pyjeve të larta të degraduara dhe rezultatet nga planifikimi fundit të menaxhimit të pyjeve, në fusha të caktuara ka pasur mbi-shfrytëzim. Që nga viti 2006, zhvillimi i Planeve të reja të Menaxhimit të Pyjeve (PMP) me kosto-efektive është një prioritet për qeverinë e Kosovës.

Pyjet e Kosovës janë të pasura me lloje të drunjëve prej 132.000 ha (27.5%) e sipërfaqes pyjore është e përbërë nga katër ose më shumë lloje. Pothuajse të gjitha sipërfaqet pyjore (rreth 99%) janë

¹² Po aty

nën presionin e ndikimit njerëzor. Më shumë se 90% të vëllimit në këmbë të pyjeve halore dhe pyje halore/fletorë të përziera shtrihen brenda parkut kombëtar “Sharri” dhe “Bjeshkët e Nemuna”.

Zjarri paraqet shqetësim potencial për grumbuj pyjor. Një sipërfaqe prej 12.200 ha, ose 2.5% e sipërfaqes pyjore totale është prekur seriozisht nga zjarri që ka ndikim në biodiversitet.

Përveç kësaj, aktivitetet e pakontrolluara apo aktivitetet e paligjshme kanë ndikime në biodiversitetin e pyjeve. Situata është kritike sidomos në pyjet halore, ku e tërë ekzistenca e pyjeve është në rrezik, nëse menjëherë nuk ndërmerren masat. Rezultatet e inventarizimit gjithashtu konfirmojnë se pyjet e ulëta, posaçërisht ato publike i nënshtrohen përdorimit të tepruar nga popullata lokale. Për më tepër, rezultatet tregojnë se ekziston një nevojë urgjente për ndërhyrje silvikulturore në pyje shumë të reja dhe atyre me moshë të mesme.

Grumbullimi i bimëve mjekësore dhe aromatike, frutave të egra të malit si dhe kërpudhave bëhet shpesh pa kritere dhe standarde të menaxhimit të qëndrueshëm, kjo natyrisht që shkakton një lloj presioni mbi biodiversitetin. Bimët mjekësore që më së shumti vilen janë si; Sherbela (*Salvia officinalis*), Dëllinja e zezë (*Juniperus communis* L.), Akësi (*Helichrysum italicum* L.), Aguliça (*Primula veris* L.) Shtogu (*Sambucus negra*), Rrush arushe (*Arctostaphylos uva ursi* L), Bliri (*Tilia cordata* Mill.), Trëndafili i egër (*Rosa canina* L.), ndërsa si fruta të egër vilen; Boronicat (*Vaccinium myrtillus*), mjedrat, luleshtrydhet, Kërpudhat si Vrganji (*Boletus edulis*) dhe Dhëlpërushja (*Cantharellus cibarius*) etj. Për sa i përket sasive që janë mbledhur, nuk ka të dhëna të sakta. Ka nevojë urgjente për të krijuar një bazë ligjore sa më shpejt të jetë e mundur me qëllim të zvogëlimit të ndikimeve negative nga mbledhja e bimëve mjekësore dhe aromatike në biodiversitet.

Problemet kryesore të identifikuara:

- Fuqizimi i dobët i legjislacionit mbi pyjet;
- Menaxhim jo i qëndrueshëm, i dobët dhe jashtë standardeve profesionale të pyjeve;
- Përgjegjësitë e paqarta për menaxhim me pyje dhe zbatimin e tyre;
- Prania e madhe e veprimeve ilegale në pyje;
- Mungesa e planeve menaxhuese për qeverisje të pyjeve gjetherënëse;
- Mos zbatim i certifikimit të pyjeve si shkak i prezencës së prerjeve të pa ligjshme.

Prioritetet - Veprimet Strategjike:

- Të fuqizohet zbatimin e Ligjit të pyjeve;
- Të realizohet menaxhimi i pyjeve sipas standardeve të menaxhimit të qëndrueshëm;
- Të sqarohen kompetencat për menaxhimin e pyjeve;
- Të ndërmerren masa për zvogëlimin e aktiviteteve ilegale në pylltari;
- Të hartohen Planet e Menaxhimit për pyjet e ulëta;
- Të ndërmerren masa për certifikimin e pyjeve sipas standardeve ndërkombëtare FSC/ Forest Stewardship Council).

6.3.3 Gjuetia

Gjuetia është një ndër mënyrat më të vjetra se si njeriu i ka shfrytëzuar resurset natyrore dhe si ka ndikuar në llojet e kafshëve dhe bimëve e gjithashtu në ekosistemet. Gjuetia e është një nga

sektorët mjaftë të rëndësishëm pyjor, përmes të cilit mund të konstatohen në aspekti pozitiv (i ballancuar) dhe aspekti negativ (humbjet) e biodiversitetit. Ajo mund të jetë edhe burim potencial për konflikt me format tjera të shfrytëzimit të burimeve natyrore (p.sh. Bujqësia, pylltaria, rekreacioni) në këtë kontekst çështja e qëndrueshmërisë së gjuetisë ngrihet si çështje.

Gjuetia e qëndrueshme nënkupton që shfrytëzimi i burimeve natyrore (llojet shtazore dhe vendbanimet e tyre) do të sigurohen jo vetëm për gjeneratat e tanishme por edhe ato të ardhshme. Kur gjuetia është e organizuar në mënyrë të qëndrueshme ndikimi në popullacionet e egra do të jetë pozitiv.

Kosova është e pasur me lloje të kafshëve të egra dhe kushte të përshtatshme të vendbanimeve të tyre. Kësaj i kontribuojnë kushtet e mjedisit, pozita gjeografike dhe ruajtja relativisht e mirë e mjedisit. Për shkak të veprimit të faktorit njeri disa lloje të kafshëve të egra janë në numër të vogël dhe të kërcënuara nga zhdukja. Mbrojtja e tyre është obligim, ligjor dhe ndërkombëtar për të gjitha institucionet me të cilat ndërlidhet çështja e kujdesit për mjedisin, respektivisht vendbanimet ku kafshët e egra jetojnë.

Duke i analizuar të dhënat mbi llojet dhe numrin e kafshëve të egra në Kosovë, mund të konstatohet se shumica e llojeve shtazore, janë në numër të ulët e disa janë në numër mesatar vetëm të popullatave të derrave të egër, i cili konsiderohet në rritje. Mbi këtë bazë kemi një prishje të ekuilibrit biologjik për i cili ka vënë në diskutim ekzistimin e disa llojeve dhe mjedisit të vendbanimeve të jetës së tyre, prandaj institucionet duhet të ndërmarrin masa ruajtjen dhe mbajtjen e ekuilibrit biologjik për gjithë llojet e kërcënuara nga faktorë të ndryshëm dhe sidomos nga ia njeri. Për të arritur deri tek të dhëna të sakta dhe reprezentuese për Kosovën është e nevojshme që të realizohet inventarizimi i kafshëve të egra të cilat jetojnë në mjediset e vendit tonë dhe ato që janë migruese. Një vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet llojeve që janë në kërcënim dhe atyre të kërcënuara si; dhia e egër, rrëqebulli, ujku, ariu, pula e madhe e egër, shqiponja, etj. Tabela 4 Paraqet vlerësimin e gjendjes dhe numrit të kafshëve të egra në Kosovë

Lloji i shtazëve të egra	Gjendja 1 - 2 - 3	Numri
Dreri (<i>Cervus elaphus</i>)	1	300 - 400
Drenusha (<i>Dama dama</i>)	Rezervat i Veçantë i Gjuetisë	160
Kaprolli (<i>Capreolus capreolus</i>)	1 - 2	5.000 - 6.000
Dhe e egër (<i>Rupicapra rupicapra</i>)	1	400 - 500
Derri i egër (<i>Sus strofa</i>)	3	6.000 - 10.000
Ariu i murrëm (<i>Ursus arctos</i>)	1 - 2	80 - 100
Ujku (<i>Canis lupus</i>)	1 - 2	Up to 100
Rrëqebulli (<i>Lynx lynx</i>)	1	20 - 25
Lepuri (<i>Lepus europaeus</i>)	1 - 2	5.000 - 10 000
Tetrao urogallus	1	?
Fazani i rëndomt (<i>Phasianus sp.</i>)	2	5.000 - 10 000
Fëllenxa e fushave (<i>Perdixperdix</i>)	1 - 2	5.000
Patat (<i>Anatidae</i>)	1	?

Tabela 4 Gjendja dhe numri i shtazëve të egra në Kosovë

Vlerësimi i gjendjes: 1= Numër i vogël; 2= Gjendje e mirë; 3 = Gjendje shumë e mirë.

Burimi: MBPZhR, Departamenti i Pylltarisë

Kosova ka potenciale hapësinore dhe mjedisore për kafshë për gjueti, prandaj edhe për caktimin e vend gjuetive dhe për menaxhimin e tyre. Nëse i përjashtojmë afro 200.000 ha, në të cilat ka vendbanime, rrugë dhe objekte, ku nuk është i mundur ushtrimi i gjuetisë, mbesin afro 900.000 ha

mjedise për lloje të kafshëve dhe për kafshë për gjueti. Në territorin e Kosovës, gjenden katër vend gjueti të ndara si vend gjueti të interesit të posaçëm për Kosovë, në sipërfaqe të përgjithshme prej 73.300 ha, që është afro 8% të sipërfaqes së përgjithshme, të përshtatshme për menaxhim të gjuetisë.

Nga sipërfaqja për menaxhim të gjuetisë, duhet të përjashtohen 116,300 ha sipërfaqe të parqeve kombëtare (Sharri dhe Bjeshkët e Nemuna). Zonat e mbrojtura të natyrës siç janë parqet kombëtare krijohen me qëllim të ruajtjes të florës dhe faunës, prandaj në këto parqe nuk lejohet ligjërisht krijimi i vend gjuetive.

Mbështetur në Ligjin për gjueti, në Kosovë mund të themelohen vend gjueti të përbashkëta, vend gjueti të veçanta dhe vend gjueti private. Në vend gjueti të përbashkëta gjuetia e kafshëve të egra mund të zhvillohet për qëllime shkencore, turistike, rekreative-sportive dhe ekonomike. Me pëlqimin e komunave dhe me pëlqimin e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Kosovë janë themeluar 29 vend gjueti të përbashkëta në 23 komuna. Prej tyre 8 komuna kanë ndërmarr hapa për dhënien në menaxhim të vend gjuetive të përbashkëta dhe rezultojnë gjithsej 12 vend gjueti të dhëna në menaxhim për 10 vite.¹³ Gjithashtu, në vendin tonë ekzistojnë dy vend gjueti të veçanta; Dubočak dhe Blinaja të cilat vend gjueti administrohen dhe menaxhohen nga institucionet shtetërore. Deri më tani asnjë kompani apo person fizik nuk ka ndërmarr hapa për të aplikuar për themelimin e vend gjuetisë private.

Problemet kryesore të identifikuara:

- Mungesa e inventarizimit të kafshëve të gjahut dhe planeve menaxhuese për vend gjuetitë,
- Prani e gjuetisë së pa ligjshme,
- Mungesa e kuadrit profesional për gjueti dhe ekzistimi i një numri të madh të “gjuetarëve” pa njohuri elementare për rëndësinë e gjahut apo kafshëve të egra,
- Ekzistimi i numrit të madh të armëve të gjahut me leje dhe pa leje të MPB-së;
- Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të ndryshme që kanë ndikim në përkujdesje dhe mbrojtje të kafshëve të egra.

Prioritetet – Veprimet strategjike:

- Hartimi i planeve të menaxhimit për vend gjuetitë e themeluara, i cili bazohet në inventarin e kafshëve të gjahut,
- Fuqizimi i zbatimit të normave ligjore në gjueti dhe mbajtje të armëve të gjuetisë,
- Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe ndërgjegjësimi për gjuetarët,
- Vendosja e një rregulli strikt lidhur me bartjen dhe shfrytëzimin e armëve të gjahut,
- Forcimi i bashkëpunimit ndër-institucional në sektorin e gjuetisë.

6.3.4 Peshkataria

Kosova ka një potencial të konsiderueshëm të ujërave të ëmbla. Në shumicën e ujërave zhvillohet peshkimi rekreativ-sportiv pa ndonjë përfitim të madh ekonomik. Gjendja e lumenjve nuk është e kënaqshme për arsye të ndotjes së mjedisit për rreth, si dhe dëmtimeve të mëdha në shtretërit e lumenjve si pasojë e nxjerrjes së rërës dhe ngritjes së pajisjeve për pastrim dhe përpunim të zallit përgjatë rrjedhës së lumenjve.

Zhvillimi i akua-kulturës në Kosovë daton që nga vitet e ‘60-ta. Sasia e prodhimit të peshkut në 30 hurdhata e peshkut është shumë e vogël, e cila për vitin 2014 ka shkuar deri në 610 t/ vit¹⁴. Në

¹³Shenime- Departamenti i pylltarisë

¹⁴ Raporti i gjelbër 2015

Kosovë prodhimtaria e troftës konsumohet kryesisht në hoteleri, ndërsa në treg gjendet shumë pak si i freskët. Prodhimi i Troftës vitet e fundit ka shënuar një ngritje të dukshme por kjo nuk mund të ketë ndikim të madh tek zogjtë e egër peshk ngrënës, sepse organizohen në basene artificiale e shumë pak në kushte natyrore.

Sipas analizave të bëra nga Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural duke pasur parasysh prodhimtarinë vendore të peshkut në hurdhat ekzistuese si dhe importin e peshkut të freskët dhe të ngrirë, konsumi i mishit të peshkut është 0.8 kg/banor, krahasuar me vendet e rajonit dhe më gjerë është nën çdo mesatare të konsumit.

Menaxhimi i fondit të peshqve nuk bazohet në ndonjë plan menaxhues të hartuar nga institucione hulumtuese shkencore.

Problemet kryesore të identifikuara:

- Mungesë e inventarizimit të saktë të stoqeve të peshkut,
- Mungesë e zbatimit të ligjit dhe rregullave të aplikueshme për peshkim;
- Vazhdon varfërimi i lumenjve me peshk për shkak të ndotjes së lumenjve dhe liqeneve.

Prioritetet - Veprimet strategjike:

- Futja e kushteve të ruajtjes së biodiversitetit në ligjet dhe dokumentet për lëmin e peshkatarisë,
- Përmirësimi i kontrollit dhe ndërprerja e peshkimit ilegal, rritja e bashkëpunimit më të ngushtë mes MBPZHR-së dhe MMPH-së, Shoqatave të peshkatarëve,
- Shfrytëzimi maksimal i hapësirës ujore me shfrytëzim sa më të mirë të mbarështimit natyral dhe ruajtjes së llojeve të peshkut,
- Ndalja e shfrytëzimit të inerteve nga shtretërit e lumenjve.

6.3.5 Turizmi

Turizmi i bazuar në natyrë mund të ofrojë mundësi të mëdha për zhvillim dhe është sektori i dytë më i rëndësishëm me ndikim në zhvillim, pas bujqësisë. Shpesh turizmi konsiderohet si një alternativë e suksesshme karshi bujqësisë intensive, pylltarisë ose peshkatarisë. Zakonisht bizneset nuk i kushtojnë rëndësi ruajtjes së natyrës dhe biodiversitetit, por veçanërisht iniciativat për ekoturizëm janë shumë të ndërlidhura me shëndetin e ekosistemeve që i rrethojnë. Ekzistojnë disa shembuj ku mbrojtja e biodiversitetit është i ndërlidhur me rritjen e të hyrave për operatorët turistik, si individ ose kompani biznesi.

Gjatë dekadave të fundit, turizmi në Kosovë nuk ka qenë në rritje si sektor ekonomik, edhe pse zhvillimi ekonomik është një nga qëllimet kryesore të Qeverisë së Kosovës. Studimet tregojnë se turizmi ka një potencial të lartë për zhvillim, veçanërisht në lidhje me promovimin e zonave të mbrojtura dhe vlerave të trashëgimisë natyrore të tyre. Sektori i turizmit ka potencialin për të sjellë rritjen ekonomike dhe krijimin e punësimit, në qoftë se planifikohet me kujdes.

Ekziston nevoja për një strategji kombëtare të turizmit që do të siguronte një plan strategjik kornizë me një plan veprimi me të cilin do të udhëheqë Divizioni i Turizmit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe aktorët tjerë në zhvillimin e sektorit të turizmit në të ardhmen. Ajo duhet të japë një pasqyrë të gjendjes aktuale, përfitimet për shoqërinë por edhe kërcënime për biodiversitetin dhe të çojë Kosovën drejtë ofrimit të, pakove turistike konkurruese në regjion.

Kosova është e ndarë në pesë regjione turistike:

- Rajoni qendror i Prishtinës;
- Rajoni turistik i Alpeve Shqiptare;
- Rajoni turistik i Sharrit;
- Rajoni turistik i Anamoravës;
- Rajoni turistik i Mitrovicës.



Figura 5: Harta e pesë regjioneve turistike të Kosovës
Burimi: Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Divizioni i Turizmit

Zhvillimi i turizmit dhe kapaciteteve turistike, grumbullimi i një numri të madh të njerëzve në zonat e mbrojtura të natyrës shpesh i kërcënon ekosistemet e ndjeshme dhe vendbanimet e vlefshme natyrore e me këtë bimët dhe shtazët. Për këtë arsye duhet të bëhet një analizë detale lidhur me ndikimet e turizmit në këto zona si dhe në llojet konkrete të bimëve dhe shtazëve.

Turizmi i qëndrueshëm dhe eko-turizmi paraqesin kornizën ideale për zhvillimin e turizmit në përgjithësi. Eko-turizmi është një formë e turizmit që përfshinë vizitat në zonat e brishta, të paprekura, dhe relativisht të pa shqetësuara natyrore, të karakterizuara me ndikim të ulët dhe shpesh ndryshe nga turizmi masivë komercial. Qëllimi mund të jetë edukimi udhëtarëve, për të siguruar fonde për ruajtjen ekologjike, për të përfituar drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe

fuqizimin politik të komuniteteve lokale, ose për të nxitur respektin për kulturat e ndryshme dhe për të drejtat e njeriut. Kosova ka potenciale për zhvillimin e eko-turizmit por gjithçka është në fazën fillestare.

Bazuar në studimet e deritanishme, ekzistojnë kushte shumë të mira për ngritje të qendrave turistike për turizmin dimëror-sportiv. Dy regjionet turistike “Bjeshkët e Nemuna” dhe “Sharri” janë dy regjione që kanë mundësit të mira për zhvillimin e këtij lloj turizmit në zonën e tretë. Studimet vlerësojnë se e para mundë të pranojë deri në 129.000 vizitorë në vit ndërsa regjioni turistik i Sharrit 113.000 vizitor në vit. Duke pas parasysh se këto dy regjione janë njëkohësisht edhe qendrat më të mëdha floristike dhe faunistike në Kosovë, ndikimi i zhvillimit të turizmit në këto dy zona do të jetë negativ në ruajtjen e biodiversitetit. Kurse ana pozitive e krejt kësaj është se do të krijohen të hyra të cilat mund të orientohen në veprimtarit e mbrojtjes së natyrës si dhe për ndërtim të infrastrukturës, monitorim dhe hulumtime shkencore.

Problemet kryesore të identifikuara:

- Mungesa e Strategjisë për zhvillimin e turizmit në Kosovë;
- Mungesa e studimeve mbi ndikimet negative të turizmit në biodiversitet;
- Ndërtimi i infrastrukturës turistike pa respektuar rregullat mjedisore;
- Infrastrukturë e pamjaftueshme turistike – mungesa e rrugëve në disa zona, mungon shenjëzimi turistik, hartat, qendrat informative turistike, menaxhimi i mbeturinave dhe kontrollimi i ndotjes;
- Mungesë e stafit me trajnim adekuat për ZM dhe sistemi i arsimit nuk është i përshtatur nevojave të tregut;
- Mungesa e bashkëpunimit ndër-institucional ndërmjet sektorit publik dhe privat;
- Mungesa e eko standardeve dhe standardeve miqësore me natyrën.

Prioritetet – Veprimet Strategjike:

- Zhvillimi i një strategjie për turizmin e qëndrueshëm dhe promovon një turizëm miqësor me mjedisin dhe trashëgiminë natyrore dhe peizazhin si vlera unike;
- Studimet dhe analizat e kapaciteteve pranuese të zonave të mbrojtura;
- Zhvillimi i standardeve dhe kritereve për eko-turizmin në zonat e mbrojtura;
- Investimet në infrastrukturën turistike, duke përfshirë rrugët, për ecje në këmbë dhe me biçikletë, shenjat informative, qendra informative, duke përcaktuar/bërjen e kufijve të PK të dukshme, etj.;
- Gjatë ndërtimit të infrastrukturës turistike, procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis duhet të zbatohen dhe kapaciteti pranues duhet të merret në konsideratë;
- Rishikimi i sistemit arsimor dhe organizimin e trajnimeve profesionale në bazë të nevojave të tregut dhe duke marrë mbrojtjen e natyrës në konsideratë;
- Përmirësimi i bashkëpunimit ndër-institucional dhe bashkëpunimit ndër-institucional, rritjen e bashkëpunimit me sektorin privat, organizimin e fushatave informuese me njerëzit që jetojnë në ose pranë ZM.

6.4 Ujërat, transporti, minierat dhe energjia

6.4.1 Ujërat

Menaxhimi i mirë me ujërat mund të ketë ndikim të rëndësishëm në ruajtjen e biodiversitetit. Njëri nga problemet kryesore në Kosovë është degradimi i shtretërve të lumenjve nga nxjerrja e zhavorrit si dhe nga ndotjet në përgjithësi të cilat paraqesin njërin ndër problemet dhe sfidat mjedisore kryesore në Kosovë.

Kosova ka rezerva të pamjaftueshme të ujit, kjo në të ardhmen do të jetë faktor kufizues për zhvillim ekonomik. Vlerësohet se Kosova përafërsisht ka vetëm rreth 1600 m³ ujë/kokë banori/vit, kurse kërkesat për ujë po shtohen çdo ditë e më shumë. Ky shtim i kërkesave të ujit lidhet direkt me shtimin demografik, kushtet e jetesës, kapacitetin industrial dhe nevojat bujqësore. Zhvillimi i mëtejshëm ekonomik dhe rritja e standardit jetësor shton edhe kërkesën për ujë. Në këtë aspekt, është shumë e rëndësishme që uji të përdoret në mënyrë racionale dhe për të marrë masat e nevojshme për të arritur këtë. Prandaj, kjo mbetet një çështje kyçe për zhvillimin ekonomik dhe social të shtetit si dhe për biodiversitetin.

Sipërfaqja topografike ujëmbledhëse e Kosovës është 11.645 km² prej të cilave 10.908 km² janë në territorin e Kosovës, ndërsa sipërfaqja prej 758 km², është jashtë territorit të vendit tonë. Kosova ndahet në katër pellgje ujëmbledhëse¹⁵, të cilat shkarkojnë ujërat në të tri dete: Detin Adriatik (pellgu i Drinit të Bardhë), Detin e Zi (pellgu i Ibrit dhe Moravës së Binçës) dhe Detin Egje (pellgu i Lepencit). Lumenjtë kryesor janë: Drini i Bardhë (122 km), Sitnica (90), Lumbardhi i Pejës (62), Morava e Binçës (60), Lepenci (53), Ereniku (51) Ibri (42), Lumbardhi i Prizrenit (31).

Mesatarja vjetore e reshjeve sillet rreth 600 mm në ultësira dhe rreth 1400 mm në viset malore. Rezervat e ujërave nëntokësore janë të kufizuara gjinden kryesisht në pjesën perëndimore të Kosovës.

Kosova ka disa liqejë artificial si: Batllava, Ujëmani, Radoniqi, Perlepnica dhe Badovci.

Nga pendat ekzistuese në Kosovë, Ujëmani dhe Radoniqi janë penda të cilat kanë destinime të shumëfishta, ndërsa Graçanka, Përlepnica dhe Batllava shfrytëzohen për furnizim me ujë të pijes, industri, bujqësi etj. Kosova ka burime të rëndësishme të ujërave termale të cilat përdoren për qëllime shëndetësore dhe rekreative. Për shkak të sipërfaqeve të vogla të ligatinave në Kosovë ato nuk paraqesin prioritet, edhe pse ligatinat si vendbanimet paraqesin vende të rëndësishme ku zogjtë gjejnë ushqimin dhe mbarështimin, ato janë posaçërisht të rëndësishme për zogjtë migratorë. Figura 6 paraqet hidrografinë kurse Figura 7 Pellgjet kryesore lumore në Kosovë.

¹⁵ Shfrytëzimi i qëndrueshëm i burimeve ujore bazuar në Direktivën Kornizë për Ujëra (DKU 2000/60EC)




Figura 6: Hidrografia e Kosovës
Burimi: Raporti gjendja e Natyrës, 2015




Figura 7: Pellgjet kryesore lumore në Kosovë
Burimi: IPH Plani Hapësinor i Kosovës 2010 – 2020+

Në Kosovë , ekzistojnë katër penda më të larta se 40 metra (Ujëmani, Batllava, Radonoqi dhe Badovci). Prej tyre Ujëmani dhe Radonoqi janë penda me shfrytëzim të shumë qëllimshëm ndërsa Graçanka, Përlepnica dhe Batllava shfrytëzohen vetë për ujë të pijes. Kërkesat për hidrocentrale të mëdha e të vogla në zonat malore kohëve të fundit janë rritur në mënyrë ekstreme. Në përgjithësi MMPH-ja është kundër këtyre zhvillimeve dhe ka ndaluar këto zhvillime të reja në zonat e mbrojtura.

Kosova është në fazën finale të miratimit të Strategjisë Kombëtare të Ujërave 2015 - 2034, e cila është hartuar në bazë të nenit 31 të Ligjit për Ujërat e Kosovës.

Ende ka pak informacione lidhur me kapacitetin ekzistues dhe atë nxjerrës pasi nuk janë bërë studime përveç atyre në lidhje me monitorimin e pasqyrës së ujërave nëntokësorë. Sipas të dhënave të fundit, vetëm 31% e popullsisë është e kyçur në rrjetin e kanalizimit. Ujërat e ndotura shkarkohen në mjedis pa u trajtuar. Pra, nuk kemi pajisje (impiante) për trajtimin e ujërave të ndotura. Si pasojë shumica e lumenjve janë të ndotur përtej mase kështu që biodiversiteti në lumenj është shumë i ultë. Përveç ujërave të ndotur dhe shfrytëzimit të plehrave minerale dhe pesticideve në bujqësi ekziston edhe një problem tjetër ndotja industriale e trashëguar nga e kaluara të gjitha këto paraqesin ndikime serioze negative në biodiversitetin e vendit.

Aktivitetet e shfrytëzimit të zhavorrit nga shtretërit e lumenjve ka shkaktuar erozion dhe ka ndikim negativ në biodiversitetin përmes shkatërrimit të vendbanimeve natyrore. Gjatë planifikimit të infrastrukturës ujore duhet të merren në konsideratë procedurat e VNM-së dhe të Pranushmerisë së ndërhyrjes për natyrën sipas Direktivës së Vendbanimeve sepse kjo mund të jetë problem me ndikim në ruajtjen e biodiversitetit.

Problemet kryesore të identifikuara:

- Ka humbje të biodiversitetit të florës dhe faunës ujore si shkak i ndotjes së ujërave nga ndotja urbane, bujqësia dhe industria;
- Sasi e pamjaftueshme e ujit, veçanërisht gjatë periudhave të thata;
- Ekziston një bashkëpunim i dobët dhe i kufizuar ndërmjet palëve;
- Siguria e pendave është një problem potencial me efekte të mundshme negative në biodiversitet;
- Ndërtimet për nevoja të prodhimit të hidro-energjisë si dhe
- Nxjerrja e zhavorrit nga shtretërit e lumenjve po paraqesin kërcënim për biodiversitetin ujor.

Prioritetet – Veprimet Strategjike:

- Ndërtimi i impianteve për trajtimin e ujërave;
- Të ndalohen aktivitetet të cilat kontribuojnë në shkatërrimin i ekosistemeve lumore;
- Zhvillimi i Planeve Menaxhuese të Pellgjeve lumore;
- Ngritja e sigurisë së pendave dhe zvogëlimi i ndikimeve të tyre në ekosisteme;
- Të shtohet bashkëpunimi ndërmjet inspektorateve të ujërave dhe të natyrës;
- Zbatimi korrekt i procedurave mjedisore VSM dhe VNM e posaçërisht kur aktivitetet planifikohen të ndërmerren në zonat ujore dhe ligatina.

6.4.2 Transporti

Brenda territorit të Republikës së Kosovës kemi mbi 2000 km rrugë të rendit magjstral dhe rajonal, gjithashtu kemi mbi 5000 km rrugë të rendit lokal. Kjo infrastrukturë rrugore vlerësohet si pjesërisht e dëmtuar, joadekuate dhe si e pamjaftueshme karshi kërkesave. Ndërtimi i rrugëve të reja e veçanërisht auto udha do të ketë ndikim negativ në fragmentimin e vendbanimeve natyrore dhe uljen e cilësisë së tyre për shkak të zhurmës dhe dritës. Një numër i konsiderueshëm i shtazëve të egra akcidentohen nga komunikacioni me çka vjen deri te humbja e biodiversitetit. Vitet e fundit në Kosovë janë ndërtuar një numër i madh i rrugëve dhe si pasojë është shtuar rreziku për shtazët e egra.

Ministria e Transportit dhe Post Telekomunikacionit (MTPT) përgjegjëse për komunikacionin në vend synon të krijojë një sistem të integruar të transportit për të gjithë kosovarët duke ju mundësuar atyre të zgjedhin transportin e tyre efikas që i përmbushë kërkesat e tyre, si dhe çështjeve mjedisore nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me sektorët tjerë.

Planet për transportin paraqesin bazën e përzgjedhjes dhe zhvillimit të projekteve të transportit. Sidoqoftë, ato projekte shpesh janë zhvilluar pa ndonjë shqyrtim të detajuar siq kërkohet me Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe Vlerësimin Strategjik Mjedisor. Kjo krijon probleme të rënda në realizimin e disa projekteve të rëndësishme, nëse jo pamundësimin e tyre për shkak të pasojave mjedisore që mund të identifikohe.

Mbrojtja e mjedisit tani është njeri prej synimeve të Ministrisë së Infrastrukturës dhe zbatimit të procedurave të përcaktuara me ligjin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) dhe Ligjit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) të cilat kërkojnë hartimin e një raporti të vlerësimit për të gjitha projektet e reja duke pasur për qëllim harmonizimin e zhvillimit ekonomik dhe mirëqenien shoqërore me parimet bazë për mbrojtje të mjedisit përfshirë këtu edhe aspektet e biodiversitetit

sipas konceptit për zhvillim të qëndrueshëm. Rëndësi e veçantë do t'i kushtohet sidomos zonave të mbrojtura të natyrës të cilat janë me rëndësi për ruajtjen e biodiversitetit, ekosistemeve, llojeve, varieteteve gjenetike dhe rrjetit ekologjik.

Problemet kryesore të identifikuara:

- Humbja ose fragmentimi i vendbanimeve natyrore me rezultat degradimin e cilësisë së vendbanimeve (në Kosovë nuk ka asnjë mbikalim për kafshët e egra);
- Shkatërrimet e peizazhit nga ndërtimi i rrugëve pa përmbushjen e standardeve mjedisore (pa raporte të VSM dhe VNM);
- Mungesa e sinjalizimit adekuat lidhur me vendkalimet e njohura për shtazët e egra.

Prioritetet - Veprimet Strategjike:

- Ndërtimi i rrugëve me standarde të larta duke respektuar procedurat mjedisore;
- Të ndërtohen mbikalimet për të anashkaluar fragmentimi i vendbanimeve për kafshët e egra;
- Instalimi i shenjave të përshtatshme në vendkalimet të cilat shpesh shfrytëzohen nga kafshët e egra.

6.4.3 Minierat

Kosova është një vend me pasuri të konsiderueshme në minerale dhe kjo paraqet një presion tjetër për ruajtjen e biodiversitetit dhe larmisë peizazhore. Në Kosovë më së shumti ka minerale nga të cilat prodhohet energjia elektrike (linjit) ndërsa ka edhe sasi të konsiderueshme të mineraleve nga të cilat fitohen metalet si Nikeli, Zinku, Plumbi, Ari, Argjendi, Kromi etj. Pastaj mineralet që përdoren në ndërtimtari gurët gëlqeror, zalli i lumenjve, deltina etj. që shfrytëzimi i tyre paraqet presion në mjedis.

Si rezultat i eksploatimit të mëhershëm të mineraleve shumë miniera të shterura kanë mbetur pa u ri kultivuar dhe njëkohësisht kanë ndikim të dukshëm në peizazhe, kështu veprimesh ka edhe në brendi të territorit të zonave të mbrojtura. Aktivitetet minerare kanë ndikim të madh në biodiversitet, të cilat shkaktojnë ndotjen dhe shkatërrimin e vendbanimeve natyrore. Gjerë me tani janë zhvilluar disa projekte si:

- Projekti i spastrimit dhe ri kultivimit të tokës në KEK-u, është një projekt madhor i financuar nga BB-re dhe Qeveria e Kosovës;
- Rehabilitimi i deponive të mbetjeve industriale në minierën e Plumb - Zinkut në Artanë;
- Rehabilitimi i deponive të mbetjeve industriale nga miniera e Plumb - Zinkut në Trepçë në fshatin Kelmend; dhe
- Pilot projekti që është duke u zhvilluar për mbushjen e punimeve minerare (puseve) të pashfrytëzuara në minierën e Plumb - Zinkut në Trepçë lënda mbushëse- „hiri” i KEK-ut.

Problemet kryesore të identifikuara:

- Degradimi i vendbanimeve natyrore në Zonat e Mbrojtura nga një numër i madh i aktiviteteve të kompanive të gurthyesve;
- Minierat e shterura të cilat kanë mbetur pa u ri kultivuar dhe paraqesin rrezik të përhershëm si për erozion ashtu edhe për kafshët e egra;

- Mungesë e mjeteve financiare për ri kultivimin e minierave të braktisura;
- Mungon bashkëpunimi i industrisë dhe autoriteteve përgjegjëse mjedisore.

Prioritetet – Veprimet Strategjike:

- Të sigurohet kadastra e të gjitha minierave (legale dhe ilegale) në territorin e zonave të mbrojtura;
- Të shtohet bashkëpunimi i inspektorateve të xehetarisë dhe atyre të mbrojtjes së natyrës si dhe ndërmjet niveleve (lokal dhe qendror);
- Përcaktimi i kushteve për mbrojtjen e natyrës në Planet dhe programet për shfrytëzimin e burimeve minerare;
- Mbështetja e pilot projekteve për ri kultivimin e minierave të shterura në përgjithësi si dhe brenda zonave të mbrojtura në veçanti.

6.4.4 Energjia

Sektori i energjetikës paraqet njërin ndër sektorët i cili ka ndikim të dukshëm në ruajtjen e biodiversitetit dhe larmisë peizazhore. Prodhimi i tanishëm kryesisht bazohet në termocentrale (97%), shumë pak nga hidrocentralet (3%) ndërsa nga burimet tjera alternative prodhohet një sasi e vogël që në krahasim me sasinë e përgjithshme të energjisë elektrike për momentin mund të konsiderohet e papërfillshme. Bazuar në Strategjinë e sektorit të energjisë do të ngritën edhe kapacitete të cilat do të shfrytëzojnë burimet e ri përsëritshme si uji, dielli, era dhe biomasa. Gjithashtu është shumë i rëndësishëm synimi që energjia të kursehet dhe përdoret me efikasitet duke zhvilluar sisteme të cilat kursejnë energjinë. Duhet pas parasysh që ndikimet negative gjatë ndërtimit të objekteve si dhe gjatë operimit të minimizohen duke respektuar procedurat e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis si dhe plotësimin e standardeve mjedisore bazuar në legjislacionin vendor.

Historikisht, energjia dhe minierat kanë qenë shtyllat e ekonomisë kosovare, duke ofruar punësim dhe gjenerim i të ardhurave, fitim nga eksporti dhe kontribute për industrinë e tjera. Prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë sot varet nga Termocentralet Kosova “A” dhe “B”, të cilat përdorin linjitet. Janë kryer disa studime në lidhje me efektet negative mjedisore nga mihjet sipërfaqësore të linjitetit si dhe nga Termocentralet Kosova A dhe B të cilat shfrytëzojnë linjitetin.

Një studim i bërë me 11-15 prill 2007 që shtjellon problemin e faunës dhe florës në zonën e mihjeve dhe të Termocentraleve, është identifikuar flora dhe fauna, si dhe shumica e llojeve të bimëve (drunjtë, shkurret dhe bimët barishtore) në zonat respektive janë shumë të ndikuara. Gjithashtu lloje të mbrojtura dhe të kërcënuara në nivel kombëtar siç është Lejleku, *Ciconia ciconia*, *Anas querquedula*, *Tringa totanus* janë ndikuar negativisht. Duhet përmendur se janë gjithashtu dy lloje veçanërisht të kërcënuara: *Crex crex* dhe *Ixobrychus minutus* të listuar në Shtojcën I të Direktivës së BE-së për Zogjtë e egër.

Strategjia e Energjisë për Kosovën parasheh hapjen e Fushës së Re të Mihjes në Siboc, në fillim pjesa jugperëndimore e saj si dhe ndërtimin e termocentralit të ri. Një sipërfaqe e konsiderueshme është e zënë nga ish Industria kimike „Gazifikimi” dhe miniera e rihapur 2008 - 2009 e Sitnicës. Realizimi i këtyre projekteve të mëdha në sektorin energjetik në të ardhmen e afërt do të rezultojë me zënie të sipërfaqeve të shumta tokësore me çka do të vijë gjer te degradimi i sipërfaqes, humbja e biodiversitetit. Vetëm Miniera e linjitetit Siboci jugperëndimor dhe TC – Kosova e Re do të zënë një sipërfaqe diku afër 800 hektar shtesë deri në vitin 2033.

Për shkak të nxjerrjes së lignitit në të kaluaren është krijuar një gropë e madhe prej rreth 500 ha në pjesën veriore të fushës së Sibocit, e cila në këndvështrim afat gjatë (40 - 50 vite) do të mund të bëhet një liqen atraktiv, rekreativ, i përshkruar me një brez të gjelbër për rreth.

Ministria e Energjisë dhe Minierave (MEM) përkrah zhvillimin e sektorit të energjisë duke promovuar edhe prodhimin energjisë elektrike nga burimet e ri përsëritshme të energjisë bazuar edhe në kërkesat dhe detyrimet që ka ky sektor karshi Traktatit për themelimin e Komunitetit të Energjisë (TKE) dhe *Aqcuis mbi Mjedisin*.

Në Kosovë ka përfunduar studimi i fizibilitetit mbi kapacitetet e mundshme hidropotenciale në Kosovë i cili për momentin ka identifikuar 18 lokacione për prodhimin e energjisë elektrike nga hidro - centralet me kapacitet të vogël të prodhimit (më të vogla se 10 MW). Ky studim përshkruan edhe efektet që mund të kenë këto hidropotenciale të vogla në mjedis e veçanërisht për biodiversitetin. Në krahasim me Termocentralet ndikimi i këtyre hidropotencialeve do të jetë dukshëm më i vogël ose fare i pa rëndësishëm për mjedisin – biodiversitetin. Mënyra e gjenerimit të energjisë elektrike nga këto hidropotenciale nuk do të jetë përmes krijimit të liqeneve akumuluese por do të jetë e tipit të kanaleve rrjedhëse, gjë që dukshëm zvogëlon ndikimin në mjedis.

Gjithashtu ka përfunduar studimi i financuar nga Banka Botërore (BB) për Hidrocentralin (HC) - Zhuri, me fuqi prej 305 MW dhe prodhim mesatar vjetor prej 397,59 GWH. Hidropotencialet e reja të tipit të këtyre me kapacitet të lartë dhe me ujë akumulues sigurisht se do të kenë edhe efektet e tyre në mjedis, duke zënë sipërfaqe të konsiderueshme të tokave pjellore, sipërfaqeve pyjore, duke bërë rrezikimin e florës dhe faunës në këto zona.

Problemet kryesore të identifikuara:

- Ndotja e tokës nga e kaluara, zënia e sipërfaqeve të mëdha me deponi dhe djerrina;
- Ndotja e ujërave nga industria kanë qenë dhe mbeten burim i përhershëm i ndotjes së mjedisit dhe degradimit të ekosistemeve ujore;
- Peizazhe shumë të shkatërruara me degradime të mëdha të sipërfaqes nga deponit e hirit dhe objektet përcjellëse industriale;
- Prodhimi i energjisë për momentin kryesisht i bazuar në burime të linjtit krijon presion në burimet e ri përsëritshme për të arrit standardet e kërkuara për llojshmërinë e energjisë i cili është shumë i ultë.

Prioritetet - Veprimet Strategjike:

- Të ri vitalizohen peizazhet dhe deponitë me qëllim të zvogëlimit të ndikimeve negative në ujëra dhe ekosisteme;
- Për projekte zhvillimore të sektorit të energjisë të aplikohen procedurat e VSM dhe VNM;
- Të nxirren planet hapësinore për minierat e reja ku do të përfshihen kushtet dhe masat për mbrojtjen e natyrës;
- Të mbështeten iniciativat për energji të ri përsëritshme;
- Gjatë vendosjes së mullinjve të erës për prodhimin e energjisë të përjashtohen zonat e rëndësishme të zogjve dhe korridoret migruese të tyre;
- Gjatë ndërtimit të largpërçuesve të bëhen zgjidhje teknike të cilat e zvogëlojnë në minimum ngordhjen e zogjve nga goditja e rrymës.

6.5 Planifikimi Hapësinor dhe Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

6.5.1 Planifikimi Hapësinor

Ligji për planifikim hapësinor Nr. 04/L-174, ka për qëllim të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e Kosovës si vlerë e përgjithshme kombëtare, përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Ky ligj ka për qëllim të sigurojë qeverisje të qëndrueshme, shfrytëzim efikas të fondeve publike, parakushte për zhvillim social dhe ekonomik të baraspeshuar, rregullim të qëndrueshëm të hapësirës, duke siguruar trajtim të barabartë, lëvizje të lirë dhe qasje adekuate në shërbimet publike për qytetarët.

Ky Ligj përcakton parimet bazë të planifikimit hapësinor, kushtet dhe mënyrën e zhvillimit dhe rregullimit hapësinor, llojet, ecuritë dhe përmbajtjen e planeve, përgjegjësitë e subjekteve administrative të nivelit qendror dhe lokal për hartimin dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor, mbikëqyrjen administrative për zbatimin e këtij ligji, si dhe aktivitetet të cilat ndërmerren në planifikim hapësinor dhe rregullim territorial në Republikën e Kosovës.

Në Republikën e Kosovës janë dy nivele të planifikimit hapësinor:

- A) Planifikimi në nivel qendror për krejt territorin e Kosovës përmes dokumenteve të planifikimit hapësinorë:
 - Plani Hapësinor i Kosovës
 - Harta Zonale e Kosovës
 - Planet Hapësinore për Zona të Veçanta
- B) Planifikimi në nivel lokal për krejt territorin e komunave përmes dokumenteve të planifikimit hapësinor:
 - Plani Zhvillimor i Komunës - plan strategjik shumë sektorial që përcakton synimet afatgjata për zhvillim ekonomik, social dhe hapësinor;
 - Harta Zonale e Komunës - dokument shumë sektorial i nivelit lokal në pajtim me dispozitat e nenit 16 të ligjit Nr. 04/L-174;
 - Planet Detale Rregulluese.

Plani Hapësinor i Kosovës i përcakton parimet dhe qëllimet afatgjata të planifikimit hapësinor për territorin e Kosovës për një periudhë më së paku dhjetë vjeçare dhe bazohet në vizionin, caqet strategjike, parimet ndërkombëtare të planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Ligji për Planifikim Hapësinor dhe Ligji për Mbrojtjen e Natyrës sigurojnë kushtet për zhvillimin e planeve hapësinore për zonat e veçanta. Mbrojtja e natyrës do të zbatohet në veçanti, nëpërmjet: vendosjes së kushteve dhe masave për mbrojtjen e natyrës në dokumentet e planifikimit hapësinor dhe planet e menaxhimit të resurseve natyrore në aktivitetet e minierave, bujqësisë, pylltarisë, gjuetisë, peshkimit, hidro-ekonomisë, si dhe aktiviteteteve tjera me ndikim në natyrë.

Planet hapësinore për zonat e veçanta miratohen për zonat me karakteristika të veçanta natyrore të identifikuara në Planin Hapësinor të Kosovës të cilat kërkojnë regjim të veçantë të mbrojtjes, ruajtjes, zhvillimit dhe shfrytëzimit të tyre. Këtu përfshihen: parqet nacionale, si dhe zonat me vlera të veçanta natyrore, kulturo – historike, ekonomike etj.

Plani hapësinor për Parqet Kombëtare parasheh strategjinë me të cilën arrihen synimet dhe objektivat për parkun që konsiston në mbrojtjen dhe ruajtjen e të gjitha elementeve mjedisore (ajrit, ujit dhe tokës), biodiversitetit, peizazheve dhe vlerave tjera të natyrës e pastaj shfrytëzimin racional të tyre për shkaqe të hulumtimit shkencor, rekreacionit, turizmit.

Megjithatë me tepër se kurrë paraqitet nevoja për të mbrojtur natyrën, biodiversitetin, llojet e rrezikuara dhe vendbanimet e tyre, planet hapësinore janë të orientuara për të mbrojtur mjedisin brenda zonave që duhet të ruhen duke u përqendruar kryesisht në: infrastrukturë, turizëm, ndërtim dhe zhvillim ekonomik.

Siç përcaktohet në Ligjin për Planifikim Hapësinor, qëllimi i zonës së mbrojtur është që të kufizojë ndërtimet apo aktivitetet tjera të cilat mund të dëmtojnë karakteristikat natyrore dhe trashëgiminë kulturore. Aktivitetet e mëposhtme nuk janë të lejuara në zonat e mbrojtura:

- ndërtimi i auto udhëve dhe rrugëve regjionale;
- ndërtimi i ndërtesave të larta dhe ato që nuk janë në harmoni me ndërtesat ekzistuese fqinje;
- zhvillimin e aktivitetit të industrisë së rëndë;
- instalimeve mbitokësore për furnizim me energji elektrike, telekomunikacionit, transmetuesve digjital, etj. ;
- aktivitetet ndërtimore të cilat ndikojnë në shpyllëzimin, asgjësimin ose ndotjen e mjedisit; dhe
- planifikimi hapësinor urban dhe rural nga niveli lokal.

Planet hapësinore në nivel lokal dhe llojet e tjera të planeve duhet të jenë të harmonizuara me Planin Hapësinor të Kosovës në nivel qendror.

Problemet kryesore të identifikuara:

- Mungesë e planeve hapësinore për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe zonat tjera të mëdha të mbrojtura;
- Aktivitetet rreth procesit të shpalljes së Natura 2000 është në fazën fillestare;
- Mbrojtja e natyrës nuk është ende mjaftë e futur në dokumentet e planifikimit hapësinor.

Prioritetet – Veprimet Strategjike:

- Të nxirren planet hapësinore për Parkun Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna” dhe zonat tjera të mëdha të mbrojtura;
- Të përfundohet përcaktimi i regjioneve biogeografike në Kosovë nën kornizën e hartave për Natura 2000;
- Integrimi i kushteve dhe kërkesave të mbrojtjes së natyrës në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor (në nivel horizontal dhe vertikal).

6.5.2 Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

Procedurat e vlerësimit të ndikimit në mjedis janë përcaktuar me Ligjin e VNM Nr. 03/L – 214). Qëllimi i këtij ligji është që të bëjë parandalimin ose zvogëlimin e ndikimeve negative në mjedis të

projekteve publike dhe private të propozuara nga operatori me çka kontribuohet në sigurinë dhe përmirësimin e mjedisit, mbrojtjen e shëndetit të popullatës dhe kualitetit të jetesës.

Ky Ligj përcakton procedurat për identifikimin, vlerësimin, raportimin dhe administrimin e ndikimeve mjedisore të një projekti të propozuar, me qëllim që gjatë marrjes së vendimit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor për lëshimin e Pëlqimit Mjedisor¹⁶ të sigurohen të gjitha informatat relevante për ndikimet që projekti do të ketë në mjedis janë marrë në konsideratë.

Shumë veprimtari janë kryer pa pëlqim mjedisor dhe leje valide dhe në këtë mënyrë janë shkaktuar dëmtime serioze negative në mjedis, siç janë dëmtimi i shtretërve të lumenjve, mandej shkatërrimi i peizazheve dhe biodiversitetit, degradimi i ekosistemeve pyjore, kullosave dhe ligatinave.

Problemet kryesore të identifikuara:

- Shumë kompani ushtrojnë bizneset e tyre pa pëlqime mjedisore;
- Minierat e shterura janë braktisur pa kryer ri kultivimin e tyre.

Prioritetet - Veprimet strategjike:

- Fuqizimi i ligjit dhe bashkëpunimi ndërmjet niveleve të qeverisjes;
- Zbatimi në vazhdimësi i procedurave të VNM dhe VSM;
- Ndërtim i kapaciteteve për zbatimin e Pranueshmerisë për Natyrën sipas Nenit 6.3 dhe 6.4 të Direktivës për Vendbanimet.

6.6 Korniza ligjore dhe institucionale

6.6.1 Korniza ligjore

Mbrojtja dhe ruajtja e të gjitha vlerave të natyrës dhe biodiversitetit është përgjegjësi e secilit bazuar në Nenin 52 të Kushtetutës së Republikës të Kosovës, ndërsa kornizën ligjore për mbrojtjen e biodiversitetit dhe larmisë peizazhore e përben Ligji për mbrojtjen e natyrës Nr. 03/L-233 GZRK Nr.85/09. 11. 2010 dhe aktet nënligjore të nxjerra prej tij. Ky ligj përcakton sistemin për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës dhe vlerave të sajë në përgjithësi, natyra në pajtim me këtë ligj paraqet gjithë larminë biologjike dhe peizazhore.

Ky Ligj rregullon mbrojtjen e natyrës, shfrytëzimin e qëndrueshëm të sajë dhe veçanërisht:

- mbrojtjen, ruajtjen, përtëritjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore, në gjendje të baraspeshës natyrore;
- përtëritja e natyrës në zonat e dëmtuara ose pjesëve të tyre dhe kompensimi për dëmet e shkaktuara;
- vendosjen e rrjetit të zonave të mbrojtura, sistemit për planifikim, udhëheqje, inventarizim, monitorim, informim dhe financim me qëllim të mbrojtjes së natyrës;

¹⁶ Sipas ligjit ndërkombëtar "dhënja e pëlqimit nënkupton vendimin e organit kompetent apo autoriteteve tjera të cilat japin të drejtë zhvilluesi të projektit për të vazhduar me projektin".

- pengimin e shfrytëzimit të tepërt, rrezikimit të llojeve të florës dhe faunës e sidomos i atyre me rëndësi të veçantë, të rralla dhe të rrezikuara, si dhe vendbanimeve të tyre;
- sigurimin e të drejtës së publikut për informim për gjendjen e natyrës dhe pjesëmarrje në vendim marrje për mbrojtjen e natyrës;
- sigurimin e ushtrimit e të drejtës së qytetarëve për jetesë të shëndoshë, pushim dhe rekreacion në natyrë;
- parandalimin e veprimeve të dëmshme të personave juridik dhe fizik në natyrë si pasojë e aktiviteteve ekonomike;
- mirëmbajtjen ose sanimin në statusin e favorshëm të ruajtjes të vendbanimeve natyrore dhe llojeve me interes për Kosovën sipas standardeve të BE-së;
- ruajtjen e të gjitha llojeve të zogjve te cilët natyrshëm jetojnë në gjendje të egër (zogjtë, vezët e tyre, çerdhet dhe vendbanimet e tyre).

Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës është përgjegjësi e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe të gjithë personave juridik, fizik dhe asociacionet të cilat janë bartës të drejtave dhe detyrimeve që dalin nga legjislacioni vendor dhe aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit.

Ligji për mbrojtjen e natyrës vazhdimisht harmonizohet me direktivat relevante për natyrën dhe Acquisin mjedisor e posaçërisht me Direktivën e Vendbanimeve natyrore 92/43 EEC, Direktivën e zogjve të egër 79/409 EEC, Konventën mbi Tregtinë Ndërkombëtare të Llojeve të Rrezikuara të Florës dhe Faunës së Egër (CITES). Kosova ende nuk është nënshkruese e Konventave dhe traktateve që kanë të bëjnë me mbrojtjen e natyrës përveç Traktatit për themelimin e Komunitetit të Energjisë i nënshkruar në 2005 ku Kosova obligohet të ndërmarr veprimet lidhur me zbatimin e Nenit 4 pika 2 të Direktivës për zogjtë e egër. Janë ndërmarr hapa fillestar në identifikimin e zonave potenciale për Rrjetin ekologjik NATURA 2000 në Kosovë.

Në përgjithësi korniza kombëtare ligjore ofron një bazë të qëndrueshme për mbrojtjen dhe ruajtjen e natyrës dhe biodioversitetit të Kosovës, por ky legjislacion duhet të zbatohet dhe fuqizohet në mënyrë të efektshme. Shumica e ligjeve ekzistuese është në harmoni me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, harmonizimi i legjislacionit të sektorëve tjerë siç janë: pylltaria, bujqësia, gjuetia, veterinaria, ujërat, mbrojtja e mjedisit etj. Është në progres, duke marrë në konsideratë parimet e Konventës së Biodiversitetit dhe kërkesat e Acquis communautaire të BE-së.

Interesimi për vlerat e trashëgimisë natyrore ka filluar në vitin 1955 si p.sh. me shpalljen e tyre të mbrojtura si Rezervati bimor i Bozhurit (Paenonia decora Anders) mandej 1955 Rezervati shtazor i llojit dhia e egër (Rupicapra rupicapra L.), Rezervat shtazor,i rrëqebullit (Lynx lynx L.) etj. Këto zona janë shpallur në bazë të legjislacionit të asaj kohe dhe vendimeve të niveleve të ndryshme të vendimmarrjes. Tani ekzistojnë 19 Rezervate Strikte të Natyrës.

6.6.1.1 Ligjet të cilat e rregullojnë mbrojtjen e natyrës dhe mjedisit:

Nr.	Ligji	Nr. i Ligjit	Data e miratimit	Acti dhe data e publikimit
1.	Ligji për mbrojtjen e natyres	03/L-233	30.09.2010	DL-054-2010 18.10.2010 GZRK nr. 85 09.11.2010
2.	Ligji për PK "Bjeshkët e Nemuna"	04/L-086	13.12.2012	DL - 60- 2012 26.12.2012; GZRK nr.2/21 .01.2013

2.	Ligji për PK "Mali Sharr"	04/L-087	13.12.2012	DL- 59-2012 26.12.2012; GZRK nr.2/21.01. 2013
3.	Ligji për mbrojtjen e mjedisit	03/L -025	26.02.2009	DL - 007/2009 19.03.2009 GZRK nr.50, 06.04.2009
4.	Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja	Nr. 03/L-160	25 02. 2010	DL-012-2010, 12.03.2010 GZRK nr.67, 29.03.2010
5.	Ligji për ujërat	04/L-147	19.03.2013	DL - 11-2013 05.04.2013; GZRK nr.
6.	Ligji për Planifikimin Hapësinor	04/L-174	31.07.2013	DL- 45-2013 19.08.2013; GZRK nr. 30/23; 23.08.2013
7.	Ligji për vlerësimin strategjik mjedisor	03/L-230	30.09.2010	DL-050 -2010, 18.10.2010 GZRK nr.83 29.10.2010
8.	Ligji për vlerësimin e ndikimit në mjedis	03/L-214	23.09.2010	DL-048 -2010, 14.10.2010 GZRK nr.83, 29.10.2010
9.	Ligji për mbeturina	04/L -060	24.05.2012	DL -027-2012; 29.06.2012, GZRK nr. 17/2012
10.	Ligji për veprimtarinë hidrometeorologjike	02/L - 79	15.06.2006	2007/2, 09.01.2007 GZRK nr. 25, 01.06.2008
11.	Ligji për mbrojtjen nga zhurma	02/L - 102	30.03.2007	2008/15 17.03.2008 GZRK nr.40, 15.10.2008
12.	Ligji për kimikate	04/L-197	27.02.2014	DL - 05-2014 14.03.2014; GZRK nr. 18/2014, 26.03.2014
13.	Ligji për produkte biocide	03/L-119	27.05.2009	DL-014-2009, 10.07.2009, GZRK nr. 55)10.07.2009

6.6.1.2 Ligjet e sektorëve tjerë me ndikim në ruajtjen e biodiversitetit

Ligji	Nr. i Ligjit	Dt. e miratimit	Akti dhe data e publikimit
Ligji për pyjet e Kosovës me ndryshimet dhe plotësimet	2003/3 2004/29 03/L-153	13.02.2003 28.07.2004 29.03.2010	2003/6 20.03.2003 GZRK Nr.34, 01.08.2008 2004/40, 14.01.2004 29.03.2010, GZRK nr. 67/2010
Ligji për tokat bujqësore	02/L - 26	24.06.2005	2006/37 23.06.2006, GZRK Nr.13 01.06.2007
Ligji për farërat	2003/5	20.03.2003	2003/10 15.04.2003
Ligji për plehrat artificiale	2003/10	22.05.2003	2003/22 23.06.2003, (GZRK nr.16), 01.09.2007
Ligji për rrugët me ndryshimet dhe Plotësimet	2003/11 03/L-120	29.05.2003 16.12.2008	2003/24 27.06.2003, GZRK nr.16, 01.09.2007 2008/075, 30.12.2008, GZRK Nr.46, 15.01.2009
Ligji për Energjinë	03/L-184	07.10.2010	DL-058-2010, 25.10.2010
Ligji për materialin fidanor	2004/13	29.04.2004	2004/16, 28.05.2004, GZRK Nr.22, 01.03.2008
Ligji për Veterinarinë	2004/21	16.06.2004	2004/28 30.07.2004
Ligji për blegtorinë	04/L-191	06.06.2013	DL-30-2013, 28.06.2013
Ligji për ujitjen e tokave bujqësore	2005/02/L - 9	23.03.2005	2005/49 25.11.2005, GZRK Nr.11, 01.04.2007
Ligji për kujdesin ndaj kafshëve	02/L - 10	23.03.2005	2005/24, 09.05.2005 GZRK Nr.5, 01.10.2006
Ligji për gjuetinë	02/L - 53	16.12.2005	2006/41, 11.08.2006, GZRK Nr.8, 01.01.2008
Ligji për mbrojtjen nga zjarri	04/L -012	21.07.2011	DL-009-2011, 03.08.2011 GZRK Nr.7/10.08.2011 Nr. 23, 01.04.2008)
Ligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë dhe fatkeqësitë tjera	04/L-027	22.09.2011	DL-037-2011, 07.11.2011; GZRK OGRK 07.10. 2011 GZRK Nr.22/11, 19.10.2011
Ligji për peshkatari dhe Akuakulturë	02/L - 85	10.10.2006	2006/58, 20.12.2006, GZRK Nr.24, 01.05.2008
Ligji për mbrojtjen e bimëve	04/L-120	13.12.2012	DL-064-2012 28.12.2012, GZRK Nr.1/ 17.01.2013
Ligji për mbrojtjen e varieteteve të	02/L - 98	26.01.2007	2008/24 16.05.2008, GZRK Nr.40, 15.10.2008
Ligji për bletari	02/L - 111	30.03.2007	2008/5 08.02.2008 GZRK Nr.15, .08.2008
Ligji për Bujqësinë organike	04/L-085	13.09.2012	GZRK Nr. 28/2012, 16.10.2012
Ligji i produkteve për mbrojtjen e	03/L - 042	07.11.2008	2008/061 27.11.2008 GZRK Nr.44 22.12.2008
Kodi Penal i Kosovës	04/L-082	20.04.2012	GZRK Nr.19/2012; 13.07.2012
Kodi i Procedurës Penale	04/L-123	13.12.2012	GZRK Nr.37/12, 28.12.2012

Aktivitetet kriminale që kanë të bëjnë me biodiversitetin janë sanksionuar me Kodin Penal të Kosovës kapitullin XXVIII VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT, KAFSHËVE, BIMËVE DHE OBJEKTEVE KULTURORE - prej Neni 347 deri të Neni 364).

Udhëzimi Administrativ Nr. 02/2012 mbi procedurat, kriteret dhe metodologjinë për përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve strategjike dhe planeve për zbatimin e tyre është me rëndësi të përmendet.

6.6.1.3 Marrëveshjet dhe Traktatet

Konventat ndërkombëtare, Direktivat dhe Rregulloret relevante për ruajtjen e natyrës janë përshkruar në detaje në kapitullin 2.2. Kosova ka nënshkruar marrëveshjet regjionale në vijim:

- Rezolutën për zhvillimin e qëndrueshëm të rajonit të Harkut Dinarik nënshkruar në Brdo, Slloveni më 09. 03. 2011;
- Marrëveshje për zhvillimin e ekoturizmit në zonën ndërkufitare të mbrojtur të natyrës Sharri-Korab, Tetovë, 11/07/2013;
- Marrëveshja e përbashkët (Big Win 2) midis vendeve të rajonit Dinarik për ruajtjen më të mirë të natyrës brenda rajonit të Harkut Dinarik, Budva, Mali i Zi 2013/10/02;
- Memorandumi i Mirëkuptimit në mes të AKMM / IKMN dhe Qendra e Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Sllovenisë Research - Instituti i Kërkimeve karstike;
- Plani i Veprimit për Partneritet Evropian për bashkëpunim me Këshillin Evropian, edhe një plan i veprimit është miratuar për Partneritet Evropian 2009 - 2011;
- Memorandumi i Bashkëpunimit në mes të MMPH-së, Shoqërisë Civile dhe Organizatave Mjedisore në Kosovë, 05. 06. 2008;
- Memorandumi i Mirëkuptimit për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm me Republikën e Shqipërisë, Prishtinë 04. 07. 2008;
- Traktati për themelimin e Komunitetit të Energjisë, 25. 10. 2005.

Problemet kryesore të identifikuara:

- Zbatimi i ligjeve për mbrojtjen e mjedisit është i dobët gjë që krijon një shqetësim dhe trysni në fushën e mbrojtjes së natyrës, duke qar në humbjen e biodiversitetit dhe ndikim të pa parashikueshëm në mirëqenien e njerëzve;
- Në shumë raste mungon harmonizimi i ligjeve ndërmjet sektorëve;
- Konventat dhe protokollet ende nuk janë nënshkruar (për shkak të statusit);
- Kërkesat specifike të Direktivave për Natyrën të BE-së ende nuk janë zbatuar.

Prioritetet – Veprimet Strategjike:

- Të përmirësohet zbatimi dhe fuqizimi i ligjeve ekzistuese;
- Të plotësohet dhe harmonizohet legjislacioni vendor ndër sektorial në mënyrë që të sigurohet zbatimi i efektshëm i KBD –së dhe Direktivave relevante të BE – së;
- Të bëhen përgatitjet për ratifikimin e konventave ndërkombëtare më të rëndësishme nga lëmi i biodiversitetit dhe mbrojtjes së natyrës;
- Të promovohet legjislacioni tek komunat dhe palët tjera.

6.6.2 Korniza Institucionale

Organi më i lartë legjislativ është **Kuvendi i Republikës së Kosovës** i cili aprovon ligjet dhe Strategjitë. Kuvendi ka krijuar: **Bordin për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Komisionin funksional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor** i cili përbëhet nga 11 anëtar nga subjektet e ndryshme politike parlamentare.

Organet kompetente për administrimin dhe menaxhimin e mbrojtjes së natyrës janë:

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) si autoritet kompetent për mbrojtjen e mjedisit më qëllim të promovimit të politikave koherente zhvillimore për mbrojtjen e mjedisit duke zhvilluar norma dhe standarde dhe përgatitur udhëzues në fushën e mbrojtjes së mjedisit, duke monitoruar zbatimin e atyre standardeve, në mënyrë të përshtatshme duke ushtruar inspektimin dhe shërbimet tjera, pjesëmarrjen në zhvillimin dhe zbatimin e kampanjave informuese për publikun dhe përmes skemave tjera promovuese të ngrisë vetëdijen e publikut në pajtim me standardet e mbrojtjes së mjedisit. Divizioni për mbrojtjen e Natyrës i cili vepron në kuadër të Departamentit Mbrojtja e Mjedisit kryen punë administrative dhe profesionale që ndërlidhen me ruajtjen e biodiversitetit, mbrojtjen e trashëgimisë natyrore, shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore si dhe mbrojtjen e tokës nga ndotja në Republikën e Kosovës.

Agjencioni i Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit (AKMM) është themeluar me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, në 2003/9, neni 39, pika 1 "... si institucion në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për të kryer punë profesionale, administrative, kërkimore, mbështetjen e detyrave në fushën e mbrojtjes së mjedisit, zonave të mbrojtura të natyrës dhe të diversitetit biologjik." Agjencioni është themeluar në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 25, Protokollit Nr. 22/03. Detyrat kryesore të Agjencionit përfshijnë monitorimin e integruar të mjedisit, ngritjen dhe mbajtjen e një sistemi efektiv të informacionit mjedisor, dhe raportimit të vazhdueshëm për gjendjen e mjedisit. AMMK ka për qëllim që të monitorojë cilësinë e ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit; ajo promovon përdorimin e burimeve të ri përsëritshme të energjisë dhe përdorim të qëndrueshëm të burimeve natyrore. AMMK-ja ka tri institute dhe tri Drejtori nën përgjegjësinë e sajë.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (IKMN) kryen punë profesionale në mbrojtjen e natyrës në bazë të detyrave dhe kompetencave në Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës. Në Institutin e Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës janë dy zyrtarë për biodiversitet dhe një zyrtarë për zonat e mbrojtura.

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK) kryen, përveç shumë çështjeve të tjera, kërkime dhe mbledhjen e të dhënave dhe bënë analiza në fushat përkatëse.

Instituti për Planifikim Hapësinor - (IPH) së bashku me departamentin e Planifikimit Hapësinor të MMPH – është institucion kompetent për hartimin e planeve hapësinore për zonat e mbrojtura, në bazë të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04 / L-174.

Drejtoria e Parkut Kombëtar "Sharri" është organ kompetent për administrimin e drejtpërdrejtë të Parkut Kombëtar "Sharri" në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë ligjore. Parku menaxhohet në bazë të Ligjit për Parkun Kombëtar Sharri, Nr. 04/L - 087 (13 Dhjetor 2012). Menaxhimi i parkut është e rregulluar me Planin Hapësinor dhe Planin e Menaxhimit të Parkut.

Drejtoria e Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" është organ kompetent për administrimin e drejtpërdrejtë të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë ligjore. Parku menaxhohet në bazë të Ligjit për Parkun Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna", Nr. 04/L - 086 (13 dhjetor 2012) - Plani hapësinor dhe plani i menaxhimit për parkun nuk janë ende në dispozicion.

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) është përgjegjëse ndër të tjera për hartimin dhe zhvillimin e politikave pyjore, ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë fushën e pylltarisë, kafshëve të egra dhe eko turizmit në Republikën e Kosovës. Agjencia Pyjore e Kosovës është përgjegjëse për rregullimin e çështjeve që ndërlidhen me pyjet dhe tokat pyjore, zbatimin e legjislacionit pyjor, dhënien e lejeve për përdorimin e drunjëve dhe produkteve pyjore jo-drusore në Republikën e Kosovës. Instituti Kosovar i Pyjeve ofron mbështetje teknike dhe shkencore për Departamentin e Pylltarisë dhe Agjencisë Pyjore të Kosovës.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) - ka kompetencë në krijimin e kushteve sistemore për tregti dhe industri dhe për zhvillimin e politikave të turizmit. Divizioni i Turizmit në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë ka filluar punën në identifikimin e pakos turistike të Kosovës. Duke u nisur nga fakti se ky është një sektor i ri, duhet të planifikohet me kujdes dhe çështjet e mbrojtjes së natyrës duhet të merren parasysh.

Ministria e Integritimit Evropian (MIE) - kompetencat e Ministrisë së Integritimit Evropian janë në koordinimin e procesit të integritimit të Kosovës në Bashkimin Evropian dhe për të kontrolluar të gjitha instrumentet ligjore dhe politike janë në përputhje me legjislacionin Evropian.

Ministria e Infrastrukturës (MI) - kjo ministri ka kompetenca për të zhvilluar politikat, hartimin dhe zbatimin e legjislacionit për sigurimin e shërbimeve dhe objekteve në sektorin e infrastrukturës.

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) - Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka kompetencë për hartimin e politikave dhe strategjive për zhvillimin gjithëpërfshirës ekonomik të Kosovës.

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) - kjo ministri ka kompetencë për të zhvilluar politika dhe zbatuar legjislacionin për zhvillimin e arsimit, duke përfshirë arsimin e lartë dhe shkencën në Kosovë, si dhe për të siguruar edukimin joformal dhe arsimin për të rritur në të gjitha nivelet, duke përfshirë zonat e largëta, dhe promovimin e mundësisë e të mësuarit gjatë gjithë jetës për të gjithë.

Ministria e Financave (MF) - Ministria e Financave ka kompetenca në mes tjerash për koordinimin dhe zhvillimin dhe për të siguruar realizimin e balancuar të buxhetit vjetor për administratën publike dhe ajo duhet të miratojë buxhetin përcaktuar në Strategji.

Zyra për Planifikim Strategjik (ZPS) - Zyra për Planifikim Strategjik i përgjigjet drejtpërdrejt Kryeministrit ndërsa për çështje administrative Sekretarit të Përgjithshëm të Zyrës së Kryeministrit (ZKM) dhe kryen këto detyra dhe përgjegjësi:

- Mbështet Kryeministrin që të sigurohet se të gjitha Ministrinë veprojnë në pajtim me politikat strategjike të qeverisë;
- Ofron këshilla Kryeministrit dhe Qeverisë për ti identifikuar dhe shqyrtuar prioritetet strategjike të qeverisë;

- Ofron këshilla Kryeministrit për çështje të rëndësishme të politikave që do të miratohen nga Qeveria dhe që janë të lidhura drejtpërdrejt me prioritetet e qeverisë;
- Siguron që dokumentet strategjike dhe planifikuese të zhvilluara nga Qeveria janë në përputhje me prioritetet e qeverisjes së përgjithshme, përfshirë edhe obligimet që dalin nga procesi i integritimit evropian dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare, si dhe të sigurojnë konsistencën mes tyre;
- Siguron që dokumentet strategjike dhe planifikuese janë hartuar në përputhje me standardet dhe procedurat e përcaktuara nga Qeveria.

Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sportit (MKRS) - me disa departamente. Në kuadër të Departamentit të Trashëgimisë, funksionon, Divizioni i Muzeut Natyrës i Kosovës i themeluar në vitin 1952 dhe i cili u shkatërrua në vitin 2001. Në mungesë të hapësirës, në objektet muzeore eksponatet janë transferuar në muzeun etnografik dhe janë të vendosura tashmë në bodrumin e Muzeut të Kosovës. Ky muze ka pasur një total prej 1.812 eksponateve pas luftës së fundit në Kosovë. Eksponatet po mbahen në bodrum i cili është krejtësisht i pamjaftueshëm për shkak të mungesës së hapësirës adekuate. Lagështia dhe jo ajrosja janë dy faktorët kryesorë që më së shumti i ka dëmtuar këto eksponate, koleksione muzeore të paraqitura në këtë seksion, paraqesin një material shumë të vlefshëm, sepse ato bëjnë dokumentimin larmisë së formave të jetës nga botanikës dhe zoologjisë në aspektet ekologjike dhe biogeografike të këtyre hapësirave. Shumë nga koleksionet e zogjve dhe kafshëve të tjera në pronësi të muzeut janë sot në rrezik të zhduken, dhe janë shumë të rralla, jo vetëm për Ballkanin, por edhe për Evropën.

Në nivelin lokal, **komunat** janë të obliguara që të kujdesen për ruajtjen e larmisë biologjike dhe peizazhore në territorin e tyre, në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e Natyrës, Strategjinë dhe Planin e Veprimit dhe dokumentet e planifikimit hapësinor. Komunat janë të obliguara të nxjerrin programe për mbrojtjen e natyrës në territorin e tyre.

Si Institucione shkencore në Kosovë **Akademia Shkencës dhe Universiteti i Prishtinës** duhet të përmenden, të dyja merren me zbulime dhe hulumtime shkencore në fushën e natyrës dhe biodiversitetit. Në Bankën e Gjeneve ruhet materiali biologjik, i popullacioneve të mbarështuara dhe kontrolluara të një pjesë të kafshëve, kërpudhave ose bimëve, sidomos farat, sporet, micielat dhe materialet tjera biologjike të mbajtura për qëllime të ruajtjes së llojeve ose burimeve gjenetike të tyre. Kushtet për veprimtarinë e bankës së gjeneve do të përcaktohen nga kreu i organit qendror të administratës shtetërore kompetent për shkencë, pas miratimit të Ministrisë përkatëse. Një institucion i tillë vepron në kuadër të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës.

Organizatat Jo Qeveritare (OJQ) - janë pjesë e shoqërisë civile dhe përbejnë element të rëndësishëm të bashkëpunimit për çështjet mjedisore. Këto organizata shpesh ofrojnë qasje inovative për zgjidhjen e problemeve të ndryshme mjedisore. Pjesëmarrja e OJQ - ve gjatë hartimit të dokumenteve strategjike, këtyre ja u rrit legjitimitetin. Numri i përgjithshëm i OJQ- ve mjedisore në Kosovë është rreth 70 (shtatëdhjetë). Nga ky numër janë disa që merren me çështjet e biodiversitetit. Për tu përmend janë: OJQ "Finch" Prizren, OJQ "ERA" Pejë, OJQ "ECO 99" Prizren, OJQ "Ekologet e Kosovës" Prishtinë, të cilat zhvillojnë aktivitete në ruajtjen e natyrës. Një mbështetje institucionale dhe financiare e këtyre aktiviteteve është zyra vendore e REC - ut me seli në Prishtinë.

Problemet kryesore të identifikuara:

- Kompetencat e ngatërruara institucionale në nivelin horizontal dhe vertikal;
- Mungesë e kapaciteteve njerëzore në institucionet relevante në të gjitha nivelet;
- Menaxhim i dobët i zonave të mbrojtura;
- Mungesa e bashkëpunimit të mirëfilltë në mes universiteteve, OJQ-ve dhe sektorëve tjerë relevant.

Prioritetet - Veprimet Strategjike:

- Të sqarohen kompetencat dhe përmirësohet bashkëpunimi ndërmjet institucioneve relevante;
- Të ndërtohen kapacitete dhe trajnime profesionale për të gjitha autoritetet relevante veçanërisht për shërbimet e inspektimit dhe mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit;
- Të përmirësohet kualiteti i menaxhimit të Zonave të Mbrojtura;
- Të nxitet bashkëpunimi me Universitetet dhe kolegjet universitare të Kosovës si dhe OJQ-të në projektet hulumtuese: Inventarizimi, Lista e Kuqe etj.

7. PLANI I VEPRIMIT PËR BIODIVERSITET 2016 - 2020

7.1 Objektivat strategjike dhe masatë përkatëse

SPVB identifikon problemet kryesore dhe numëron zgjidhjet përkatëse (veprimet strategjike) duke siguruar kahjet e Objektivave Strategjike, të cilat duhet të adresohen në Planin e Veprimit. Objektivat Strategjike janë përshkruar në mënyrë shumë të përgjithshme dhe arritjet e tyre kërkojnë periudha të gjata kohore për zbatimin e tyre. Në kuadër të secilës Objektivë Strategjik, disa Masa janë përcaktuar (disa prej tyre gjithashtu kërkojnë periudha më të gjata kohore për zbatim) dhe aktivitetet apo projektet e përshkruara në kreun 7.2 që i referohet këtyre Masave.

Objektivat Strategjike (OS) dhe Masat (M)
OS 1. Deri me 2020, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka ndërmarrë masat të zhvillojë dhe zbatojë kornizë ligjore dhe institucionale në harmoni me standardet e BE-së.
M. 1. Harmonizimi i plotë dhe fuqizimi i legjislacionit për mbrojtjen e natyrës në përputhje me Acquis-in e BE-së, si dhe arritja e progresit drejt nënshkrimit të konventave kryesore; M. 2. Rritja e kapaciteteve të organeve kompetente për zbatimin dhe fuqizimin e masave dhe veprimeve që ndërlidhen me ruajtjen e biodiversitetit.
OS 2. Deri me 2020, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të iniciojë dhe mbështesë projekte të cilat kontribuojnë në mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e gjendjes së llojeve të bimëve dhe shtazëve, vendbanimeve natyrore dhe peizazheve reprezentative.
M. 1. Shtimi i sipërfaqes së përgjithshme të zonave të mbrojtura në territorin e Republikës së Kosovës duke siguruar mbulimin përfaqësues e të gjitha llojeve dhe vendbanimeve si dhe menaxhimin efektiv të tyre; M. 2. Hulumtimi dhe inventarizimi i llojeve dhe vendbanimeve natyrore; M. 3. Mbrojtja Ex - situ e burimeve gjenetike bimore dhe shtazore; M. 4. Punët përgatitore për krijimin e rrjetit ekologjik "NATURA 2000".
OS 3. Deri më 2020, mbrojtja e natyrës është inkorporuar në politikat sektoriale përmes bashkëpunimit të MMPH-së me palët e rëndësishme të interesit duke siguruar politika të integruara sektoriale, menaxhim efektiv dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të biodiversitetit.
M.1. Promovimi i vlerave ekonomike të biodiversitetit dhe ruajtjes së tij si dhe integrimi i biodiversitetit në politikat sektoriale të bujqësisë, pylltarisë; M. 2. Nxjerrja e Planeve hapësinore dhe Planeve menaxhuese për gjitha zonat e mbrojtura; M. 3. Rritja e ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit midis të gjithë sektorëve për biodiversitetin.
OS 4. Deri me 2020, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të mbështesë dhe bashkëpunojë ngushtë me komunat, OJQ-të dhe universitetin në zbatimin e projekteve në sektorin e edukimit dhe komunikimit si dhe do të ndërmarrë hapa për promovimin e biodiversitetit dhe mbrojtjes së natyrës në shoqëri përmes aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes.
M. 1. Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me rëndësinë e natyrës, biodiversitetit, peizazheve dhe vlerat e tyre ekonomike dhe financiare; M. 2. Fuqizimi i shkencave taksonomike dhe zbatimi i programeve në universitet për hartografinë, menaxhimin dhe mbrojtjen e biodiversitetit.

7.2 Veprimet - Projektet për zbatimin e Strategjisë së Biodiversitetit 2016 – 2020

Ligji për Mbrojtjen e Natyrës në mënyrë të qartë përcakton formatin e Planit të Veprimit, të nevojshëm për qëllime praktike të planifikimit dhe financimit. Plani i Veprimit identifikon aktivitetet specifike, institucionet përgjegjëse dhe mbështetëse, burimet e financimit të siguruara ose të mundshme dhe kornizën kohore.

Jo të gjitha veprimet e përshkruara në Planin e Veprimit do të zbatohen dhe finalizohen deri në vitin 2020, është e qartë se një listë e plotë e veprimeve do të kërkojë një periudhë më të gjatë kohore, ndoshta 10 ose më shumë vite, për zbatim. Gjatë procesit për përditësimin e Planit të Veprimit, janë bërë përpjekje për të përcaktuar veprimet prioritare, duke e konsideruar emergjencën, kërcënimin, prioritetet e renditura në PKZMSA (Mars 2016) dhe mbështetjen e mundshme për financim.

Plani i Veprimit do tu përmbahet kriterëve në vijim:

- Të gjitha aktivitetet e planifikuara duhet të kenë objektiva të cilat ndërlidhen me ruajtjen e biodiversitetit dhe duhet të jenë në përputhje me Strategjinë botërore të Biodiversitetit 2011 - 2020 dhe Synimet e Aichi (Aichi Targets) si dhe me Strategjinë e Biodiversitetit të BE-së 2011 - 2020;
- Aktivitetet duhet të identifikohen në bazë të analizave të kërcënimeve për biodiversitetin;
- Projektet duhet të mbështesin institucionet për arritjen e synimeve;
- Ruajtja e biodiversitetit dhe aktivitetet që çojnë në këtë synim duhet të monitorohen;
- Plani i Veprimit nuk duhet të jetë një "listë e dëshirave", por duhet të ofrojë një kornizë reale për arritjen e synimeve të biodiversitetit;
- Programet dhe projektet që nuk janë të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me biodiversitetin duhet të përjashtohen nga prioritetet;
- Qasja për zbatimin e SPVB vetëm me fondet dhe projektet që vijnë nga burimet ndërkombëtare nuk është e qëndrueshme - ekziston nevojë e qartë për buxhet shtesë të shtetit që mbulon shpenzimet tjera përveç pagave dhe shërbimeve.

Një financim adekuat konsiderohet i rëndësishëm për arritjen e objektivave strategjike. Përveç buxhetit të rregullt të shtetit, nevojiten fonde që vijnë nga burimet ndërkombëtare. Qasja në mekanizmat e financimit nuk është gjithmonë e lehtë, veçanërisht për sa i përket projekteve të dorëzuara në kuadrin e programeve të BE-së. Prandaj, kapacitetet për të aplikuar për fonde ndërkombëtare duhet të ndërtohen në MMPH. Për më tepër, në kohën e resurseve të kufizuara, në mënyrë të veçantë në lidhje me ruajtjen e biodiversitetit dhe mbrojtjen e natyrës, ekziston nevoja për gjenerimin e financave përmes qasjeve inovative, p.sh. sponsorizimet nga aktorët e mundshëm komercial, për shembull, kompanitë e telekomunikacionit apo bashkëpunimi me bankat. Për shkak të fushëveprimit të gjërë të ndërhyrjeve të nevojshme për të ndalur humbjen e biodiversitetit dhe buxhetit të kufizuar në dispozicion, një prioritizim është i nevojshëm. Kriteret për prioritizimin e veprimeve janë:

- Veprimet, për të cilat financimi është siguruar, ose ka një mundësi të madhe që do të financohen;
- Veprimet që do të kryhen si detyrim kombëtar - ndoshta projekte ose iniciativa të vogla për shkak të buxhetit të kufizuar të shtetit;
- Veprime emergjente për shkak të fenomeneve natyrore dhe kërcënimeve të ngjashme.

Duke ditur faktin se kërcënimet kryesore për biodiversitetin janë aktivitetet njerëzore, kjo Strategji ngritë në pah rëndësinë e pjesëmarrjes së njerëzve dhe menaxhimin e përbashkët i të gjitha aspekteve të ruajtjes së biodiversitetit. Prandaj, bashkëpunimi efektiv ndërmjet sektorëve dhe partnerëve të ndryshëm është jetik kurse qartësimi i roleve dhe përgjegjësi i të gjitha palëve të përfshira është i nevojshëm. Faktorët, të cilët pozitivisht kontribuojnë në zbatimin e suksesshëm, janë mobilizimi i të gjitha kapaciteteve të sektorit në nivelet qeveritare dhe jo-qeveritare, duke përfshirë shkencën dhe biznesin, si dhe shkëmbimin e informacionit dhe transparencën. Koordinimi i përgjithshëm do të bjerë mbi Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor kurse Plani i Veprimit do të ofrojë udhëzime për shpalljen e zonave të reja të mbrojtura dhe do të rrisë efektivitetin e menaxhimit si brenda ashtu dhe jashtë zonave të mbrojtura.

PLANI I VEPRIMIT PËR BIODIVERSITET 2016 - 2020

Veprimi	Indikatorët e suksesit	Institucioni përgjegjës	Institucionet përkrahëse	Afati kohor për realizim	Kostoja financiare dhe burimi i financimit	Komentet
Objektivi Strategjik: 1. Deri me 2020, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka ndërmarrë masat të zhvillojë dhe zbatojë kornizë ligjore dhe institucionale në harmoni me standardet e BE-së						
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 1.1. Harmonizimi i plotë dhe fuqizimi i legjislacionit për mbrojtjen e natyrës në përputhje me Acquis-in e BE-së, si dhe arritja e progresit drejt nënshkrimit të konventave kryesore						
1.1.1. Hartimi dhe miratimi i akteve nënligjore që rrjedhin nga Ligji për Mbrojtjen Natyrës	Aktet nënligjore të miratuara	MMPH	Qeveria	Q1 2017 - Q4 2018	Gj. 50,000 EUR BK. 50,000	Gj.= Gjithsejtë BK.= Buxhet i Kosovës
1.1.2. Të vazhdohet me promovimin e legjislacionit për mbrojtjen e natyrës tek komuniteti	Legjislacioni ju ka prezantua komunitetit	MMPH	Komunat	Q1 2017 – Q4 2018	Gj. 40,000 EUR BK. 10,000 SIDA 30,000	SIDA = Programi mjedisor për Kosovën
1.1.3. Miratimi i programeve për mbrojtjen e natyrës për secilën komunë	Programet e miratuara	Komunat	MMPH	Q1 – Q4 2020	Gj. 180,000EUR BK. 180,000	
1.1.4. Lobimi për ratifikimin e Konventave dhe traktateve relevante	Konventat relevante të nënshkruara	MPJ	MMPH, Kuvendi i Kosovës	Q1 2017 – Q4 2020	Gj. 50,000 EUR BK. 50,000	
1.1.5. Harmonizimi dhe fuqizimi i legjislacionit dhe qartësimi i kompetencave për menaxhimin e Parqeve Kombëtare	Kompetenca të sqaruara	MMPH	MBPZHR, Qeveria	Q1 – Q4 2017	Gj. 10,000 EUR BK. 10,000	

Masa/Nënobjekti Strategjik: 1.2. Rritja e kapaciteteve të organeve kompetente për zbatimin dhe fuqizimin e masave dhe veprimeve që ndërlidhen me ruajtjen e biodiversitetit

1.2.1. Fuqizimi i institucioneve kompetente dhe organeve për mbrojtjen dhe ruajtjen e biodiversitetit	Organe dhe institucione kompetente	MMPH	Donatorët	Q1 – 2017 Q4 - 2018	Gj.100,000EUR BK. 50,000 SIDA 50,000	
1.2.2. Ngritja e kapaciteteve për qasje në fondet ndërkombëtare	Stafi i trajnuar për qasje në fonde	MMPH	IKAP, Donatorët	Q1 – 2017 Q4 - 2018	Gj. 10,000 EUR SIDA. 10,000	

Objekti Strategjik: 2. Deri me 2020, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të iniciojë dhe mbështesë projekte të cilat kontribuojnë në mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e gjendjes së llojeve të bimëve dhe shtazëve, vendbanimeve natyrore dhe peizazheve reprezentative

Masa/Nënobjekti Strategjik: 2.1. Shtimi i sipërfaqes së përgjithshme të zonave të mbrojtura në territorin e Republikës së Kosovës duke siguruar mbulimin përfaqësues të të gjitha llojeve dhe vendbanimeve si dhe menaxhimin efektivë të tyre

2.1.1. Shpallja e Pashtrikut zonë e mbrojtur nderkufitare	Zona e shpallur	MMPH	Qeveria	Q1 – 2017 Q4 - 2018	Gj. 50,000EUR BK. 20,000 GIZ 30,000	GIZ= Fondi Regjional për Biodiversitet
2.1.2. Identifikimi dhe Shpallja e Zonave të Rëndësishme të Zogjëve	Zonat e identifkuara dhe të shpallura	MMPH	Qeveria	Q1 – 2019 Q4 - 2020	Gj.50,000 EUR BK. 50,000	

Masa/Nënobjekti Strategjik: 2.2. Hulumtimi dhe inventarizimi i llojeve dhe vendbanimeve natyrore

2.2.1. Inventarizimi dhe paraqitja në hartë e llojeve të rralla të florës dhe faunës në "Bjeshkët e Nemuna"	Inventarizimi i kompletuar	MMPH	Donatorët	Q1 – 2017 Q4 - 2018	Gj. 60,000 EUR SIDA 60,000	
2.2.2. Përditësimi i inventarizimit të zogjve në "Bjeshkët e Nemuna"	Përditësimi i inventarit i kryer	MMPH	Donatorët, OJQ	Q3 – 2017 Q3 - 2018	Gj.50,000 EUR SIDA 50,000	
2.2.3. Inventarizimi dhe paraqitja në hartë e llojeve të rralla të florës dhe faunës në "Sharri"	Inventarizimi i kompletuar	MMPH	Donatorët	Q1 – 2017 Q4 - 2018	Gj.60,000 EUR SIDA 60,000	
2.2.4. Përditësimi i inventarizimit të zogjve në "Sharri"	Përditësimi i inventarit i kryer	MMPH	OJQ, Donatorët	Q1 – 2017 Q2 - 2018	Gj.50,000 EUR SIDA 50,000	
2.2.5. Inventarizimi i llojeve bimore pushtuese (invazive)	Inventarizimi i llojeve pushtuese i kompletuar	MMPH	MBPZHR	Q1 – 2017 Q4 - 2018	Gj.10,000 EUR BK. 10,000	
2.2.6. Përgatitja dhe publikimi i Librit të Kuq të Faunës	Libri i kuq i faunes i publikuar	MMPH	Donatorët	Q1 – 2017 Q4 - 2018	Gj.60,000 EUR SIDA 60,000	
2.2.7. Sigurimi i pajisjeve për hulumtime dhe monitorimin e burimeve natyrore	Pajisjet e siguruara	MMPH		Q3 - 2018	Gj.20,000 EUR BK. 20,000	
Masa/Nënobjektivi Strategjik: 2.3. Mbrojtja Ex - situ e burimeve gjenetike bimore dhe shtazore						
2.3.1. Fuqizimi i Bankës së Burimeve Gjenetike për bimët dhe Themelimi i Bankës së Burimeve Gjenetike për kafshët	Banka gjenetike për bimët e fizuar ndërsa për shtazet e themeluar	MASHT, Universiteti i Prishtines	MMPH	Q1 – 2017 Q4 - 2020	Gj.40,000 EUR BK. 40,000	

Masa/Nënobjektivi Strategjik: 2.4. Punët përgatitore për krijimin e rrjetit ekologjik "NATURA 2000"

2.4.1. Përgatitja e Doracakut për Interpretimin e llojeve të vendbanimeve në Kosovë në përputhje me Direktivën e Vendbanimeve	Doracaku i përgatitur	MMPH	Donatorët, Universiteti i Prishtinës	Q1 – 2019 Q4 - 2020	Gj. 20,000 EUR IPA 20,000	IPA = Projekti IPA
2.4.2. Zhvillimi i Sistemit Qendor Informativ (SQI) për biodiversitetin	SQI i themeluar	MMPH	Donatorët	Q1 – 2017 Q4 - 2018	Gj.40,000 EUR BK. 20,000 GIZ 20,000	
2.4.3. Ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike për paraqitjen hartografike të vendbanimeve dhe inventarizimin e llojeve (trajnimet)	Kapacitete njerzore dhe teknike të përmirsuara	MMPH	Donatorët	Q1 – 2019 Q4 - 2020	Gj.270,000 EUR BK. 30,000 IPA 240,000	
2.4.4. Mbledhja e të dhënave për tipat e vendbanimeve dhe llojet (përfshirë shpërndarjen, përfaqësimin, etj) duke përfshirë punën në terren	Të dhënat për tipat e vendbanimeve dhe llojeve të siguruara	MMPH	Donatorët	Q1 – 2019 Q4 - 2020	Gj.180,000 EUR BK. 20,000 IPA 160,000	
2.4.5. Prodhami i hartave të shpërndarjes për të gjitha tipat e vendbanimeve dhe llojet e pranishme në Kosovë, bazuar në të dhënat ekzistuese	Hartat e prodhuara	MMPH	Donatoret	Q1 – 2019 Q4 - 2020	Gj.140,000 EUR BK. 20,000 IPA 120,000	

Objektivi Strategjik: 3. Deri më 2020, mbrojtja e natyrës është inkorporuar në politikat sektoriale përmes bashkëpunimit të MMPH-së me palët e rëndësishme të interesit duke siguruar politika të integruara sektoriale, menaxhim efektiv dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të biodiversitetit

Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.1. Promovimi i vlerave ekonomike të biodiversitetit dhe ruajtjes së tij si dhe integrimi i biodiversitetit në politikat sektoriale të bujqësisë, pylltarisë

3.1.1. Vazhdimi i zbatimit efektiv të procedurave të VSM dhe VNM	Procedurat VSM dhe VNM të zbatuara	MMPH	Bizneset	Q1 – 2017 Q4 - 2020	Nuk kërkoet buxhet shtesë,	
3.1.2. Ndërtimi i kapaciteteve për zbatimin e “Vlerësimit të Pranueshmerisë” (VP), në përputhje me Direktivën e Vendbanimeve	Kapacitete njerzore dhe teknike të përmirsuara	MMPH	Donatoret	Q1 – 2017 Q4 - 2018	Gj.40,000 EUR SIDA 20,000 GIZ 20,000	
3.1.3. Vazhdimi i përcaktimit të kushteve për mbrojtjen e natyrës gjatë përgatitjes së legjislacionit, strategjive, programeve dhe planeve të sektorëve tjerë relevant	Kushtet për mbrojtjen e natyrës janë futur në sektoret tjerë relevant	MMPH	MZhe, MTI, MI, MBPZhR	Q1 – 2017 Q4 - 2020	Nuk kërkoet buxhet shtesë,	

Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.2. Nxjerrja e Planeve hapësinore dhe Planeve menaxhuese për gjitha zonat e mbrojtura

3.2.1. Përgatitja dhe miratimi i planeve rregulluese- dhe Planit menaxhues për "Bjeshkët e Nemuna"	Plani hapësinor dhe Plani menaxhues i miratuar	MMPH	Donatorët, Kuvendi i Kosovës	Q1 – 2017 Q4 - 2018	Gj.180,000 EUR BK. 60,000 SIDA 80,000 GIZ 40,000	
--	--	------	------------------------------	------------------------	---	--

3.2.2. Përgatitja dhe miratimi i planeve të menaxhimit për zonat e tjera të mëdha të mbrojtura (mbi 500 ha)	Planet e menaxhimit për zonat tjera mbi 500 ha të miratuara	MMPH	MBPZHR, Donatorët	Q1 – 2019 Q4 - 2020	Gj. 80,000 EUR BK. 20,000 IPA 60,000	
3.2.3. Përgatitja e Planeve të menaxhimit për llojet e gjitarëve të mëdhenj	Planet e menaxhimit për gjitarët e mëdhenj të miratuara	MMPH	Donatoret, OJQ	Q1 – 2019 Q4 - 2020	Gj. 50,000 EUR BK. 20,000 IPA 30,000	
3.2.4. Mbështetje për zhvillimin dhe zbatimin e Planit të Menaxhimit të Pellgut të Lumit Drini i Bardhë	Plani i menaxhimit i miratuar	MMPH	Donatorët	Q1 – 2019 Q4 - 2020	Gj.770,000 EUR BK. 70,000 SIDA 700,000	

Masa/Nënobjektivi Strategjik: 3.3. Rritja e ndërgjegjësimit dhe bashkëpunimit midis të gjithë sektorëve për biodiversitetin

3.3.1. Zhvillimi i masave nxitëse për promovimin e ruajtjes së biodiversitetit tek sektorët tjerë, të vazhdohet me zbatimin e masave në sektorin e pylltarisë - bujqësisë	Masat nxitëse të zbatuara	MMPH	MZHE, MTI, MI, MBPZHR	Q1 – 2017 Q4 - 2020	Gj. 50,000 EUR BK. 50,000	
3.3.2. Të vazhdohet me politikën e shqyrtimit të legjislacionit të sektorëve tjerë relevant në lidhje me objektivat, praktikën dhe rregulloret, që potencialisht kanë ndikim negativ në biodiversitet	Politikat dhe legjislacioni e sektorëve tjerë në harmoni me qëllimet e ruajtjes së biodiversitetit	MMPH	MZHE, MTI, MI, MBPZHR	Q1 – 2017 Q4 - 2020	Gj. 50,000 EUR BK. 50,000	

Objektivi Strategjik: 4. Deri me 2020, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të mbështesë dhe bashkëpunojë ngushtë me komunat, OJQ-të dhe universitetin në

zbatimin e projekteve në sektorin e edukimit dhe komunikimit si dhe do të ndër marrë hapa për promovimin e biodiversitetit dhe mbrojtjes së natyrës në shoqëri përmes aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes

Masa/Nënobjektivi Strategjik: 4.1. Zhvillimi dhe zbatimin e projekteve për rritjen e ndërgjegjësimit në lidhje me rëndësinë e natyrës, biodiversitetit, peizazheve dhe vlerat e tyre ekonomike dhe financiare

4.1.1. Zbatimin e programeve shtesë të trajnimit për mësuesit në lidhje me mbrojtjen e natyrës dhe zbatimin e kurrikulës në të gjitha nivelet	Programet shtesë të trajnimeve të mbajtura	MMPH	MASHT, DAK	Q1 – 2017 Q4 - 2020	Gj. 50,000 EUR BK. 50,000	
4.1.2. Vazhdimi i Projektit Pako e Gjellbër Junior, trajnimi i mësimeve të ciklit të ultë	Projekti i trajnimit i zbatuar	MMPH	MASHT, DAK, REC	Q1 – 2017 Q4 – 2018	Gj. 40,000 EUR BK. 40,000	
4.1.3. Rritjen e ndërgjegjësimit të banorëve lokalë që jetojnë brenda ose në afërsi të zonave të mbrojtura	Ndërgjegjësia e banoëve e ngritur	MMPH	Komunat, Donatorët	Q1 – 2017 Q4 – 2018	Gj. 50,000 EU BK. 30,000 SIDA 20,00R	
4.1.4. Fuqizimi i bashkëpunimit në mes MMPH-së dhe OJQ-të për aktivitete të edukimit jo-formal	Bashkëpunimi me OJQ-të i fuqizuar	MMPH	Donatorët, OJQ	Q1 – 2019 Q4 – 2020	Gj. 40,000 EUR BK. 20,000 SIDA 20,00	
4.1.5. Zhvillimi i Projektit të Eko shtegut në Parkun Regional “Gërmia” si dhe planit të menaxhimit me fokus në edukim	Projekti i zbatuar	MMPH	Komuna, UP	Q1 – 2019 Q4 – 2020	Gj.100,000 EUR BK. 100,000	

4.1.6. Zhvillimi dhe Zbatimi i Projektit Kopshti Botanik	Projekti i zbatuar	MMPH	UP, MASHT, Donatorët	Q1 – 2017 Q4 – 2020	Gj.100,000 EUR BK. 100,000	
4.1.7. Zhvillimi dhe zbatimi i fushatave të ndërgjegjësimit në nivel kombëtar	Fushatat e zbatuara	MMPH	MBPZhR, MZhE, MTI, MI, Medijet	Q1 – 2017 Q4 - 2020	Gj.50,000 EUR BK. 50,000	
Masa/Nënobjekti Strategjik: 4.2. Fuqizimi i shkencave taksonomike dhe zbatimi i programeve në universitet për hartografinë, menaxhimin dhe mbrojtjen e biodiversitetit						
4.2.1. Shtimi i stafit Universitar për taksonomi, hartografi, menaxhimin dhe mbrojtjen e biodiversitetit	Shtimi i stafit për disiplinat taksonomike	MASHT	UP	Q1 – 2017 Q4 - 2020	Gj.50,000 EUR BK. 50,0000	
4.2.2. Mbështetja e hulumtimeve shkencore dhe projekteve në fushën e mbrojtjes së biodiversitetit	Hulumtime shkencore për biodiversitetin të zbatuara	MASHT	UP, MMPH	Q1 – 2017 Q4 - 2020	Gj.50,000 EUR BK. 50,000	

8 MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Institucioni përgjegjës për zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë së Biodiversitetit dhe Planit i Veprimit 2016 - 2020 është Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Sipas Ligjit, monitorimi është i ndarë në tri faza:

- Rishikimi dhjetë vjeçar i Strategjisë së Biodiversitetit (relevante në 2021);
- Shqyrtim dhe përditësimi pesë vjeçar i Planit të Veprimit (bërë në vitin 2016);
- Rishikimi vjetor i zbatimit të projekteve.

Monitorimi duhet të jetë i thjeshtë, por duke siguruar kushtet për vlerësimet dhe përmirësimet përmes përdorimit të indikatorëve të përzgjedhur. Gjatë procesit të përditësimit të SPVB, një grup i indikatorëve është zhvilluar dhe diskutuar, të cilët do të jenë pjesë e planit të monitorimit për vlerësimin e suksesit të kësaj strategjie.

Meqenë SPVB duhet të miratohet nga Kuvendi i Kosovës, përgjegjësitë për monitorimin e Planit të Veprimit i janë lënë MMPH. Informacioni në bazë vjetore duhet të sigurohet për organet përkatëse/departamenteve në Kuvend dhe MMPH, ku vendime mbi veprimet dhe financat janë marrë. Përgjegjësitë dhe linjat e raportimit duhet të komunikohen në mënyrë të qartë për ministrinë dhe agjencitë e tjera të ndërlidhura me zbatimin e këtij plani të monitorimit dhe përdorimin e tij.

Indikatorët për arritjen e Objektivave Strategjike


Objektivat Strategjike	Indikatorët
OS 1 Deri me 2020, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka ndër marrë masat të zhvillojë dhe zbatojë kornizë ligjore dhe institucionale në harmoni me standardet e BE-së.	Niveli i harmonizimit të legjislacionit kombëtar dhe sektorial me acquis mjedisore të BE-së është rritur
	Ndarja e qartë e përgjegjësive në lidhje me menaxhimin e Parqeve Kombëtare
	10 (dhjetë) aktivitete për ngritjen e kapaciteteve për autoritetet përkatëse për zbatimin në mënyrë efektive të veprimeve/masave dhe fuçizimin e ligjit
OS 2 Deri me 2020, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të inicojë dhe mbështesë projekte të cilat kontribuojnë në mbrojtjen dhe mirëmbajtjen e gjednjës së llojeve të bimëve dhe shtazëve, vendbanimeve natyrore dhe peizazheve reprezentative.	Baza e të dhënave qendrore për biodiversitetin – të dhëna e ndërlidhura
	Ekspertët e biodiversitetit nga fusha të ndryshme janë të trajnuar në hartografi të vendbanimeve dhe inventarizim të llojeve
	Palët e interesuara relevante janë të vetëdijshëm për kërkesat e Direktivave të Vendbanimeve dhe Zogjëve
	Përqindja territorit të zonave të mbrojtura të propozuara është rritur dhe mbulon të paktën 10% të çdo lloj vendbanimi që gjendet në Kosovë (si pjesë e procesit të shpalljes NATURA 2000)
	Memorandum i Mirëkuptimit (MM) në mes të MMPH-së dhe Universitetit të Prishtinës për të mbështetur ruajtjen ex-situ të biodiversitetit

OS 3 Deri më 2020, mbrojtja e natyrës është inkorporuar në politikat sektoriale përmes bashkëpunimit të Ministrisë me palët e rëndësishme të interesit duke siguruar politika të integruara sektoriale, menaxhim efektiv dhe shfrytëzim të qëndrueshëm të biodiversitetit.	Cilësia e menaxhimit të zonave të mbrojtura ekzistuese është rritur
	30% e të gjitha llojeve të rrezikuara janë nën ndonjë formë të mbrojtjes që kontribuon në uljen e humbjes së biodiversitetit
	Numri i Vlerësimeve të Ndikimit në Mjedis është rritur dhe palët relevante janë të trajnuara për aplikimin e "Vlerësimit të Pranueshmerisë"
OS 4 Deri me 2020, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të mbështesë dhe bashkëpunojë ngushtë me komunat, OJQ-të dhe universitetin të zbatojnë projekte në sektorin e edukimit dhe komunikimit dhe do të ndërmerrë hapa për promovimin e biodiversitetit dhe mbrojtjes së natyrës në shoqëri përmes aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes.	MMPH ka nënshkruar 8 (tetë) Memorandume Mirëkuptimi me grupe të zgjedhura të palëve të interesit
	Fushata Kombëtare për ngritjen e vetëdijes janë zbatuar
	Rritja e interesit të publikut për pjesëmarrjen në projektet e ndërlidhura me biodiversitetin dhe kuptimi i rolit të biodiversitetit në shoqëri

9 SHTOJCAT

- SHTOJCA I** **Harta e zonave të mbrojtura në Kosovë**
- SHTOJCA II** **Lista e Zonave të Mbrojtura (gjendja 2014)**
- SHTOJCA III** **Vendimi i Sekretarit të Përgjithshëm MMPH – Anëtarët e Grupit Punues**

SHTOJCA I Harta e zonave të mbrojtura në Kosovë



Burimi: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, AMMK

SHTOJCA II Lista e Zonave të Mbrojtura (gjendja 2014)

Kodi	Emërtimi i Zonës! objektit	Komuna	Sip! ha	Kat. sipas IUCN	Viti i mbrojt.	Përshkrimi i shkurtër i vlerave
REZERVAT STRIKT I NATYRES (847 ha)						
RN_001	Gazimestani	Prishtinë	12	Ib	1953	Rezervat bimor i Bozhures (<i>Paeonia decora</i> Anders)
RN_002	Maja e Ropsit	Deçan	20	Ia	1955	Rezervat bimor i llojeve të molikës, bredhit, pishës dhe ahut
RN_003	Kozhnjeri	Deçan	150	Ia	1955	Rezervat shtazor i llojit dhia e egër (<i>Rupicapra rupicapra</i> L.)
RN_004	Rusenica	Suharekë	300	Ia	1955	Rezervat shtazor i rrëqebullit (<i>Lynx lynx</i> L.)
RN_005	Gubavci	Pejë	38	Ia	1959	Rezervat bimor i llojit endemo-relikt boshtra (<i>Forsythia Europeae</i>)
RN_006	Maja e Armenit	Prizren	30	Ia	1960	Rezervat bimor me përbërje të pastër të munikes- armenit (<i>Pinus heldreichii</i>)
RN_007	Oshlaku	Prizren	20	Ia	1960	Rezervat natyror i armenit (<i>Pinus heldreichii</i>), dhe i disa bimëve endemike
RN_008	Pisha e Madhe	Prizren	35	Ia	1960	Rezervat bimor i llojit të molikës dhe i disa shpendëve këngëtarë
RN_009	Malet e Prilepit	Deçan	1	Ia	1963	Rezervat bimor me përbërje të pastër të panjës malore (<i>Acer heildreichii</i>)
RN_010	Bifurkacioni i Lumit Nerodime	Ferizaj	13	Ib	1979	Rezervat special natyror. Fenomen unikat në Evropë dhe i dyti në botë me rëndësi arsimore, shkencore e turistike.
RN_011	Kamilja	Leposaviq	228	Ib	1988	Kamilja është Rezervat i veçantë natyror me veçori paleontologjie.
PARK KOMBETAR (115.957 ha)						
PK_001	Parku Kombëtar "Sharri"	Prizren Suharekë Kaçanik Shtërpçë, Dragash	53.469	II	(1986), 2012	Karakterizohet me lloje të shumta relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit dhe faunës. Me vlera të trashëgimisë gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike, speleologjike, kulturore, edukativo-arsimore dhe turistike.
PK_002	Parku Kombëtar "Bjeshkët Nemuna"	Pejë, Deçan, Istog, Junik, Gjakovë	62.488	II	2012	Karakterizohet me lloje të shumta relikte dhe endemike të florës, vegjetacionit dhe faunës. Me vlera gjeomorfologjike, gjeologjike, hidrologjike, speleologjike, kulturore, edukativo-arsimore dhe turistike.
MONUMENTE NATYRORE (5972 ha)						
MN_001	Mani Sham (<i>Morus</i> sp.)	Pejë	0.03	III	1957	Monument natyror me karakter botanik
MN_002	Rrapi (<i>Platanus orientalis</i>) në Marash	Prizren	0.05	III	1959	Monument natyror me karakter botanik
MN_003	Plepi (<i>Populus tremula</i>) në Bajçinë	Podujevë	0.05	III	1959	Monument natyror me karakter botanik
MN_004	Bliri (<i>Tilia argentea</i>) në Isniq	Deçan	0.02	III	1968	Monument natyror me karakter botanik
MN_005	Trungjet e Blirit (<i>Tilia argentea</i>) në Isniq	Deçan	0.05	III	1968	Monument natyror me karakter botanik
MN_006	Shpella e Gadimes	Lypjan	39	III	1969	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_007	Mineralet - Kristalet	Mitrovicë	0.05	III	1970	Monument natyror me karakter gjeologjik dhe gjeomorfologjik

MN_008	Rrjedha e lumit Mirusha	Suharekë Klinë Malishevë	12	III	1983	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_009	Gryka e lumit Lumbardhi	Prizren	200	III	1976	Monument natyror me karakter hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik dhe botanik
MN_010	Burimi i Drinit të Bardhë dhe Shpella e Radavcit	Pejë	90	III	1983	Monument natyror me karakter hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik dhe botanik
MN_011	Gryka e Rugovës	Pejë	4301	III	1985	Monument natyror me karakter hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik dhe botanik
MN_012	Burimi i ujit mineral në Dresnik	Klinë	0.07	III	1985	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_013	Gryka e lumit Klina	Klinë	205	III	1985	Monument natyror me karakter hidrologjik, gjeomorfologjik, speleologjik dhe botanik
MN_014	Trungjet e bungut (Quercus sp.) në Lozice	Malishevë	0.05	III	1985	Monument natyror me karakter botanik
MN_015	Trungu i qarrit (Quercus cerris) në Zllakucan	Klinë	0.05	III	1985	Monument natyror me karakter botanik
MN_016	Kanioni i Drinit të Bardhë te Ura e Fshajtë	Gjakovë Rahovec	198	III	1986	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe hidrologjik
MN_017	Shpella e Baicës	Drenas	0.11	III	1987	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_018	Shpella e Gllanasellës	Drenas	0.5	III	1987	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_019	Burimi termomineral në Vuqë	Leposaviq	16.6	III	1988	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_020	Burimi i ujit mineral në Sallabajë	Podujevë	0.31	III	1988	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_021	Burimi i ujit në Shajkovc	Podujevë	1.41	III	1988	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_022	Trungu i qarrit (Quercus cerris) në Pollatë	Podujevë	0.44	III	1988	Monument natyror me karakter botanik
MN_023	Trungu i qarrit (Quercus cerris) në Dobratin	Podujevë	0.07	III	1988	Monument natyror me karakter botanik
MN_024	Trungjet e rrënjës (Quercus robër) Nekovc	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_025	Kompleksi i trungjeve të rrënjës (Quercus robur) në Negroc	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_026	Trungjet e shpërdhit në Negroc	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_027	Shpella e Kishnarekës	Drenas	2	III	2006	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_028	Trungu i qarrit (Quercus cerris) në Krajkovë	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_029	Guri i Gradinës në Llapushnik	Drenas	2	III	2006	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik
MN_030	Burimi i ujit mineral në Poklek	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_031	Trungjet e dushkut - Gjashtë lisat (Quercus sp.) në Likoshan	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_032	Trungjet e dushkut (Quercus sp.) Tërstenik	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_033	Trungu i dushkut (Quercus sp.) Likoshan	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter botanik
MN_034	Guri i plakës në Dobroshec	Drenas	0.05	III	2006	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik

MN_035	Trungu i bungëbutës (Quercus pubescens Willd.) në Aqarevë	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_036	Trungjet e dushkut (Quercus sp.) në Polac	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_037	Trungu i dushkut (Quercus sp.) në Likoc	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_038	Burimi i ujit termal në Banjë	Skenderaj	0.1	III	2007	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_039	Trungu i dushkut (Quercus sp.) në Prellovc	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_040	Kompleksi i trugjeve të dushkut (Quercus sp.) në Rrezallë	Skenderaj	0.02	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_041	Kompleksi i trugjeve të bungbutës (Quercus pubescens Willd.) në Klladernicë	Skenderaj	0.1	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_042	Trungu i qarrit (Quercus cerris L.) në Kotorr	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_043	Trungu i qarrit (Quercus cerris L.) në Padalishtë	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_044	Trungu i bungëbutës (Quercus pubescens Willd.) në Çitak	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_045	Trungu i qarrit (Quercus cerris L.) në Runik	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_046	Burimi i ujit të njelmët në Leqinë	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_047	Trungu i bungut (Quercus sp.) në Lubovec	Skenderaj	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_048	Trungu i rrënjës (Quercus robur) në Deiq	Klinë	0.03	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_049	Kompleksi i trugjeve të rrënjës (Quercus robur) në Gllarevë	Klinë	0.28	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_050	Trungu i qarrit (Quercus cerris) në Nagllavkë	Klinë	0.12	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_051	Burimi i ujit mineral në Rudicë	Klinë	0.07	III	2007	Monument natyror me karakter Hidrologjik
MN_052	Trungu i bungut (Quercus pubescens) në Ujëmir	Klinë	0.2	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_053	Trungjet e dushkut (Quercus sp.) Breshanc	Suharekë	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_054	Kompleksi i trugjeve të dushkut (Quercus sp.) në Savrovë	Suharekë	0.15	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_055	Trungu i pishes (Pinus sp.) në Delloc	Suharekë	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_056	Trungjet e dushkut (Quercus sp.) në Grejkoc	Suharekë	0.15	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_057	Trungu i plepit (Populus sp.) në Reçan	Suharekë	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_058	Burimi i ujit mineral në Reçan	Suharekë	0.1	III	2007	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_059	Kompleksi i trugjeve të dushkut (Quercus sp.) në Muhlan	Suharekë	0.15	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_060	Trungu i vodhes (Sorbus domestica L.) në Budakovë	Suharekë	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik

MN_061	Kompleksi i trungjeve të dushkut (<i>Quercus sp.</i>) në Papaz	Suharekë	0.15	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_062	Dy trungjet e bungut (<i>Quercus sp.</i>) në Bllacë	Suharekë	0.1	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_063	Trungu i qarrit (<i>Quercus sp.</i>) Vraniq	Suharekë	0.05	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_064	Lokaliteti i bujgerit (<i>Quercus trojana</i>) në Biraqë	Suharekë	0.1	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_065	Kompleksi i trungjeve të bungut (<i>Quercus sp.</i>) në Luzhnicë	Suharekë	0.15	III	2007	Monument natyror me karakter botanik
MN_066	Guri i Xhamisë në Luzhnicë	Suharekë	0.15	III	2007	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik
MN_067	Dy trungjet e manit të zi (<i>Morus nigra L.</i>) në Cërcë	Istog	0.11	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_068	Trungu i blirit të argjendtë (<i>Tilia tomentosa Moench</i>) në Lubozhdë	Istog	0.1	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_069	Trungu i blirit të kuq (<i>Tilia sp.</i>) në Istog të Poshtëm	Istog	0.05	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_070	Trungjet e bungbutës (<i>Quercus pubescens Willd.</i>) në Sinai	Istog	0.17	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_071	Trungu i blirit të argjendtë (<i>Tilia tomentosa Moench.</i>) në Shushicë të Epërme	Istog	0.05	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_072	Burimi i ujit natyral në Istog	Istog	3.88	III	2008	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_073	Trugu i vodhës (<i>Sorbus domestica L.</i>) në Uçë	Istog	0.07	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_074	Trungu i blirit të argjendtë (<i>Tilia tomentosa Moench</i>) në Kaliqan	Istog	0.05	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_075	Burimi i ujit termal në Banjë	Istog	0.85	III	2008	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_076	Trungu i blirit të kuq (<i>Tilia sp.</i>) në Lubovë	Istog	0.07	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_077	Trungu rrënjës (<i>Quercus robur L.</i>) Zallq - Zabllaq	Istog	0.11	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_078	Trungu rrënjës (<i>Quercus robur L.</i>) në Trubuhovc	Istog	0.07	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_079	Trungu rrënjës (<i>Quercus L.</i>) në Saradran	Istog	0.05	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_080	Trungu i qarrit (<i>Quercus robur</i>) në Gurrakoc	Istog	0.01	III	2008	Monument natyror me karakter botanik
MN_081	Burimi i ujit në Vrellë	Istog	0.26	III	2008	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_082	Mirusha	Malishevë Klinë Rahovec	598.4	III	2012	Kanioni me ujëvara e njëpasnjëshme dhe peizazhet specifike, paraqet fenomen të rrallë që ka rëndësi natyrore, shkencore dhe turistike
MN_083	Trungu i Qarrit (<i>Quercus ceris L.</i>) në Lladrovç	Malishevë	0.08	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
MN_84	Shpella e Temeqinës	Malishevë	0.69	III	2014	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_85	Trungu i Qarrit (<i>Quercus ceris L.</i>) në Carravranë	Malishevë	0.08	III	2014	Monument natyror me karakter botanik

MN_86	Trungu i Bungëbutës (Quercus pubescens Willd) në LLozicë	Malishevë	0.08	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
MN_87	Trungu i Bungëbutës (Quercus pubescens Willd) në LLozicë	Malishevë	0.07	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
MN_88	Shpella e Bozhurit në Damanek	Malishevë	2 ha	III	2014	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_89	Shpella e Lladrovit	Malishevë	2ha	III	2014	Monument natyror me karakter gjeomorfologjik dhe speleologjik
MN_90	Trungu i Bungëbutës (Quercus pubescens Willd)	Malishevë	0.05	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
MN_91	Trungu i Qarrit (Quercus cerris L.) ne Drenovc	Malishevë	1.25	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
MN_92	Trungu i Qarrit (Quercus cerris L.) ne Bubël	Malishevë	0.8	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
MN_93	Trungu i Qarrit (Quercus cerris L.) ne Bubël	Malishevë	0.8	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
MN_94	Trungu i Qarrit (Quercus cerris L.) ne Bellanicë	Malishevë	0.8	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
MN_95	Trungu i frashrit gjethengushtë (Fraxinus angustifolia Vahl) në Javiq	Malishevë	0.8	III	2014	Monument natyror me karakter botanik
MN_96	Vakëfi i Vermicës	Malishevë	0.7	III	2014	Monument natyror me karakter botani
MN_97	Zabeli dhe vrella ne Javiq	Malishevë	0.51	III	2014	Monument natyror me karakter botani dhe hidrologjik
MN_98	Burimi i ujit ne Carravranë	Malishevë	9.76	III	2014	Monument natyror me karakter hidrologjik
MN_99	Shpella e Ponorcit	Malishevë	279	III	2014	Monument natyror me karakter speleologjik
ZONE E VEÇANTË E MBROJTUR E ZOGJËVE (109 ha)						
ZVM_001	Ligatina e Hencit-Radeves	F. Kosove, Graçanice, Lipjan	109	V	2014	Zone me vlera dhe karakteristika të veçanta natyrore si: ornitologjike, ihtiologjike, hidrogjeologjike, botanike dhe peizazhore.
PARK REGJIONAL I NATYRES (1126 ha)						
PN_001	Gërmia	Prishtinë	1126	V	1987	Park më rëndësi shkencore, edukative, kulturore dhe turistike
PEIZAZH I MBROJTUR (85 ha)						
PM_001	Shkugza	Gjakovë	70	V	2011	Lokalitet me vlera floristike, edukativo-arsimore dhe turistike
PM_002	Pishat e Deçanit	Deçan	15	V	1969	Lokalitet me vlera floristike, edukativo-arsimore dhe turistike

Burimi:Raporti për Gjendjen e Natyrës 2010 - 2014 MMPH/AMMK/IKMN, 2015

- | | |
|----------------------------|---------------------|
| 16. Z. Venhar Nushi, | ZPS e ZKM, anëtar |
| 17. Z. Remzi Sylejmani, | MF, anëtar |
| 18. Znj. Erëza Abrashi, | MIE, anëtare |
| 19. Z. Kemajl Kadria, | MBPZHR, anëtar |
| 20. Z. Lumturije Geci, | MTI, anëtare |
| 21. Z. Naser Zhjeqi, | MI, anëtar |
| 22. Znj. Ryve Prekorogja, | MASHT |
| 23. Z. Elez Krasniqi, | UP, anëtar |
| 24. Z. Avni Hajdari, | UP, anëtar |
| 25. Z. Ferim Gashi, | UP, anëtar |
| 26. Z. Nexhmedin Ramadani, | OJQ "Finch", anëtar |
| 27. Z. Fatos Lajçi, | OJQ "ERA", anëtar |
| 28. Një përfaqësues, | MZHE |

II. Grupi punues e ka për detyrë përgatitjen e Planit të Veprimit për Biodiverzitetet 2016 - 2020 dhe rishikimin e Strategjisë për Biodiverzitetet 2011-2020 nëse vlerësohet e nevojshme.

III. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Anëtarëve të Grupit Punues,
- Kabinetit të Ministrit,
- Zyres së Sekretarëve të Përgjithshëm: ZKM, MF, MIE, MBPZHR, MTI, MI, MZHE dhe MASHT,
- Arkivës së MMPH-së.



Sekretar i Përgjithshëm i MMPH-së